

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • PRILL 2016

Liahona

**Si Përkthehen
Shkrimet e
Shenjta? f. 20**

**Njohja e Apostullit
Tonë të Ri, Plakut
Ronald A. Rasband, f. 12**

**Çiftet në Moshë: Të Thirrur
për të Shërbyer, f. 26**

**Kur Bashkëshortët
Ndeshen me Pornografinë,
Edhe Bashkëshortet Kanë
Nevojë për Shërim, f. 34**

**Mësoni të Luani një
Himn për 10 Minuta, f. 54**





“Kështu thotë Zoti, unë do të të krahasoj ty, O shtëpi e Izraelit, me një pemë ulliri të butë të cilën një njeri e mori dhe e ushqeua në vreshtin e tij; Dhe të bekuar jeni ju; pasi, sepse keni qenë të zellshëm në të punuarin me mua në vreshtin tim dhe keni zbatuar urdhërimet e mia dhe më keni sjellë mua përsëri frutin natyral, që vreshti im nuk është më i prishur dhe e keqja është flakur tutje; shiko, ju do të keni gëzim me mua për shkak të frutit të vreshtit tim.”

Jakobi [LiM] 5:3, 75

Ullinjtë, të kultivuar gjerësisht nëpër të gjitha vendet e Mesdheut, kanë një histori të gjatë në shkrimet e shenjta, nga pëllumbi që i sollti një gjethe ulliri Noeut, të Shpëtimtari që dha mësim në Malin e Ullinjve, deri tek alegoria e Jakobit për pemët e ullirit.



MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: Profecia dhe Zbulesa Vetjake**
Nga Presidenti Henri B. Ajring
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Bija të Atit Tonë të Përrjetshëm**

ARTIKUJT KRYESORË

- 12 Idër Ronald A. Rasband: Udhëheqës i Talentuar, Baba i Përkushtuar**
Nga Plaku M. Rasëll Ballard
Një bashkëshort dhe baba i dashur, Plaku Rasband zhvilloi aftësi drejtuese gjatë viteve të drejtimit të punëve të pashlyera dhe të udhëheqësve të priftërisë.
- 18 Ai Është Peshkopi?**
Nga Patrik J. Kronin III
E kuptova se përse ajo nuk mund ta besonte se unë tani po shërbeja si peshkop. Tridhjetë vjet më parë unë isha një person shumë i ndryshëm.

NË KOPERTINË

Kapaku i përparmë dhe brenda kapakut të pasmë: Fotografitë nga Les Nilsson. Brenda kapakut të përparmë: Fotografi © RayTango/Thinkstock.

- 20 Përkthimi i Shkrimeve të Shenjta: Në Gjuhën e Zembrës Sonë**
Nga R. Val Xhonsion
Leximi i shkrimeve të shenjta në vetë gjuhën tënde është si të vish në shtëpi shpirtërisht.

- 26 Çaste të Misionarëve në Moshë**
Nga Presidenti Rasëll M. Nelson
Ju lutem, lutuni rreth kësaj mundësie për të krijuar së bashku çaste të madhërishme të misionarëve në moshë.

- 28 Misionarët në Moshë: Të Nevojshëm, të Bekuar dhe të Dashur**
Nga Riçard M. Romni
Çiftet zbulojnë se shërbimi në një mision është më i kollajshëm, më pak i shtrenjtë dhe më shumë i gëzueshëm sesa menduan.

- 34 Kur Pornografia Godet Shtëpinë – Bashkëshortet edhe Bashkëshortët që të Dyja Palët Kanë Nevojë për t'u Shëruar**
Nuk jepet emri
Një peshkop tregon se si ai i ndihmon jo vetëm bashkëshortët që ndeshen me pornografinë por edhe bashkëshortet e tyre, të cilat kanë nevojë për shërimin e Shpëtimtarit në të njëjtën masë.

- 38 Rojat në Kullë**
Pasurojeni kuptimin tuaj për profetët duke mësuar se si ata janë si rojat në kullë.

RUBRIKAT

- 8 Reflektime: A Kanë Kuptim Udhëzimet?**
Nga Ruth Silver
- 9 Shërbimi në Kishë: Faleminderit për Shërbimin Tënd**
Nuk jepet emri
- 10 Klasikët e Ungjillit: Priftëria: Një Spirancë e Sigurt**
Nga Plaku L. Tom Peri
- 40 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 80 Kur Prapë të Takohemi: Kërkimi i Dhuratave Shpirtërore**
Nga Presidenti Xhorxh Q. Kenon

48



44 Dallimi i Falsifikimeve të Satanit

Nga Denis C. Gaunt

Duke kërkuar ndryshimet midis gënjeshtreve të Satanit dhe mësimëve të Krishtit në vend të ngjashmërive, ne do të jemi në gjendje t'i njohim falsifikimet e Satanit.

48 Profile të Të Rinjve në Moshë Madhore: Matja e Bekimeve në Madagaskar

Nga Mindi Eni Selu

Pavarësisht nga të jetuarit në një vend me shumë vështirësi, Solofo Ravelojaona ndien se jeta e tij është plot me bekime.



Shihni nëse mund ta gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: Për ta gjetur këtë të dhënë, ndiqeni profetin.

50 Qëndrueshmëria Shpirtërore: Ndërtimi i një Anijeje që nuk Fundoset

Nga Plaku Dejll G. Renland

Ashtu si një anije duhet ndërtuar me kujdes që të jetë e qëndrueshme, secili nga ne duhet të fitojë qëndrueshmëri në jetën e vet me këto katër parime.

54 Mësoni të Luani një Himn për 10 Minuta!

Nga Daniel Karter

Nëse nuk keni luajtur në piano kurrë më parë por gjithmonë keni dashur të mësoni, ja se si të filloni.

57 E Zotuar për të Hequr Dorë

Nga Gretçen Blekbërn

Do bëja gjithçka që të hiqja dorë nga të luajturit në piano, kështu që, kur prindërit e mi më thanë se mund të hiqja dorë nëse mësoja 50 himne, unë ia nisa.

58 Tronditja, Hidhërimi dhe Plani i Perëndisë

Nga Paola Çajupi

Duke rikujtuar përvojën më shkatërruese të jetës sime, unë tani e di se Ati Qiellor ishte me mua gjatë gjithë kohës.

60 Edhe Nëse Je i Ndrojtur

Nga Plaku Zhosë A. Teisheira

Mirëbesojini Zotit, dhe Ai do t'ju bekojë gjatë përpjekjeve tuaja për ta ndarë ungjillin.

62 Hapësira Jonë

63 Afishe: A Duket e Mirë?

64 Pyetje & Përgjigje

Në shkollë më tallin ngaqë jam shdm. E di se duhet t'i mbroj bindjet e mia, por është kaq e vështirë! Si mund të bëhem mjaft i guximshëm?



76

66 Përgjigje nga një Apostull: Çfarë bëjnë Apostujt?

Nga Plaku Dejvid A. Bednar

67 Paqe në Zemrën Time

Nga Karol F. Mek-Konki

Kur e pashë profetin dhe e dëgjova të fliste, ndjeva paqe.

68 Dëshmia e Ithënit

Nga Leri Hillër

Dukej sikur të gjithë përveç Ithënit kishin një dëshmi.

70 Pezot për Atin Qiellor

Nga Anhela Peña Deihl

Pa para të mbetura, Ana pyeti veten: "Çfarë do të hamë nesër?"

72 Ndjekja e Profetëve dhe e Apostujve

Nga Xhena Koford

Si mund ta ndiqni profetin këtë muaj?

74 Heronj të Librit të Mormonit: Alma u Pendua

75 Unë Mund ta Lexoj Librin e Mormonit

76 Tregime nga Libri i Mormonit: Alma Pagëzon Shumë Njerëz

79 Faqe për Ngjyrosje: Shabati Është një Ditë e Veçantë

Ide për Mbrëmje Familjare

Ky numër përmban artikuj dhe veprimtari që mund të përdoren për mbrëmje familjare. Në vijim është një shembull.



"Edhe Nëse Je i Ndrojtur", faqe 60: Ju mund të përdorni mbrëmjen tuaj familjare për të ndarë ungjillin! Diskutoni si familje se çfarë frike jua bën të vështirë që ta ndani ungjillin. Ju mund të luteni si familje që Zoti t'ju ndihmojë të ndiheni të sigurt për ta ndarë ungjillin dhe më pas lutuni për atë që mund të ftoni në mbrëmjen familjare të shtëpisë. Merreni parasysh ta ftoni secilin pjesëtar të familjes të japë dëshmi gjatë mësimi. Ju mund të zgjidhni të jepni një mësim rreth Rivendosjes ose planit të shpëtimit. Merreni parasysh t'i shkruani përvojën dhe ndjenjat tuaja në ditarët tuaj.

MË SHUMË GJENDEN NË INTERNET

Liahona dhe materiale të tjera të Kishës gjenden në shumë gjuhë në languages.lds.org. Vizitoni [facebook.com/liahona.magazine](https://www.facebook.com/liahona.magazine) (të gjindshme në anglisht, portugalisht dhe spanjisht) për të gjetur mesazhe, ide frymëzuese për mbrëmjet familjare dhe materiale që mund t'i ndani me miqtë dhe familjen tuaj.

TEMAT NË KËTË BOTIM

Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.

Aktivizimi, 18
Besimi, 34, 48, 58, 60
Bindja, 8, 34, 62, 72
Dashuria, 40
Dëshmia, 64, 68
Dhuratat shpirtërore, 80
Dishepullimi, 12, 26
Dita e Shabatit, 79
E dhjeta, 62, 70
Falja, 34
Falsifikimet, 44, 63
Fryma e Shenjtë, 44, 50
Guximi, 48, 64
Jezu Krishti, 20, 34, 43, 58

Karakteri hyjnor, 7
Kthimi në besim, 43, 58, 75, 76
Libri i Mormonit, 43, 44
Lutja, 41, 64
Mësimdhënia, 75
Muzika, 54, 57
Ndershmëria, 62
Pagëzimi, 75, 76
Paqja, 50, 67
Pendimi, 18, 74
Pikëllimi, 58
Pornografia, 34

Profetët dhe Apostujt, 10, 12, 66, 67, 72
Puna misionare, 26, 28, 60
Shërbimi, 9, 26, 28, 41
Shkrimet e shenja, 20
Shlyerja, 34
Talentet, 40, 54
Thirrjet, 18
Urdhërimet, 8, 72
Vizitat mësimore, 9
Zbulesa, 4, 10, 20, 41, 42, 50, 70, 72



**Nga Presidenti
Henri B. Ajring,**

Këshilltar i Parë në
Presidencën e Parë

Profecia DHE ZBULESA VETJAKE

Kisha e vërtetë e Jezu Krishtit është rivendosur dhe është në tokë sot. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është drejtuar gjithmonë nga profetë dhe apostuj të gjallë, të cilët marrin udhërrëfim të vazhdueshëm nga qielli.

Ai model hyjnor ishte i vërtetë edhe në lashtësi. Ne mësojmë në Bibël: “Sepse Zoti, Zoti, nuk bën asgjë, pa ua treguar sekretin e tij shërbëtorëve të tij, profetëve” (Amos 3:7).

Perëndia sërish ka folur në kohën tonë nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Ai zbuloi nëpërmjet Profetit Jozef ungjillin e Jezu Krishtit në plotësinë e tij. Ai rivendosi priftërinë e Tij të shenjtë me çelësat e saj dhe të gjitha të drejtat, fuqitë dhe funksionet e fuqisë së shenjtë të priftërisë.

Në kohën tonë, profetët dhe apostujt e gjallë janë autorizuar të flasin, të japin mësim dhe të drejtojnë me autoritet nga Perëndia, Ati, dhe Zoti Jezu Krisht. Shpëtimtari i tha Profetit: “Atë që unë, Zoti, kam thënë, e kam thënë dhe nuk justifikohem; dhe ndonëse qiejt dhe toka do të kalojnë, fjala ime nuk do të kalojë, por do të përmbushet e gjitha, qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj” (DeB 1:38).

Në konferencën e përgjithshme dy herë në vit, ne bekohemi me mundësinë për të dëgjuar fjalën e Zotit për ne nga shërbëtorët e Tij. Ky është një privilegj pa çmim. Por vlera e asaj mundësie varet nëse ne i marrim

fjalët nën ndikimin e të njëjtit Shpirt nëpërmjet të cilit iu dhanë atyre shërbëtorëve (shih DeB 50:19–22). Ashtu sikurse ata marrin udhërrëfim nga qielli, edhe ne duhet të marrim. Dhe kjo kërkon nga ne të njëjtën përpjekje shpirtërore.

“Bëj Përpjekjen Tënde Vetjake”

Vite më parë, një nga anëtarët e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve më kërkoi të lexoja një bisedë të konferencës që ai po përgatiste për konferencën e përgjithshme. Unë isha një anëtar i ri i kuorumit. Unë u nderova nga mirëbesimi i tij që të mund ta ndihmoja atë të gjente fjalët që Zoti do të donte që ai të thoshte. Ai më tha me buzëqeshje: “Oh, ky është varianti i 22-të i bisedës”.

M’u kujtua këshilla që Presidenti i dashur dhe i mirë Harold B. Li (1899–1973) më dha më parë me theks të veçantë: “Hal, nëse dëshiron të marrësh zbulësë, bëj përpjekjen tënde vetjake”.

E lexova, përsiata dhe u luta për variantin e 22-të të bisedës. Studiova sa më mirë që munda nën ndikimin e Frymës së Shenjtë. Në kohën që anëtari i atij kuorumi dha bisedën e tij, unë e kisha bërë përpjekjen time vetjake. Nuk jam i sigurt në ndihmova, por e di se kisha ndryshuar kur dëgjova të jepej biseda. Mesazhet erdhën tek unë përtej fjalëve që kisha lexuar dhe që ai foli. Fjalët kishin



domethënie më të madhe se ato që kisha lexuar në variantin e bisedës. Dhe mesazhi dukej të ishte posaçërisht për mua, i përshtatshëm për nevojat e mia.

Shërbëtorët e Perëndisë agjërojnë dhe lutën për të marrë mesazhin që Ai ka për ta, që t'ua japin atyre që kanë nevojë për zbuluesë dhe frymëzim. Ajo çka mësova nga ajo përvojë, dhe shumë të tjera si ajo, është se për të marrë përfitime të mëdha që janë në dispozicion nga të dëgjuarit e profetëve dhe apostujve të gjallë, ne

duhet t'i bëjmë vetë përpjekjet tona për të marrë zbuluesë.

Zoti e do çdo person që mund ta dëgjojë mesazhin e Tij, dhe Ai e njuh zemrën dhe rrethanat e secilit. Ai e di se çfarë korrigjimi, çfarë zemërdhënieje dhe çfarë e vërtete e ungjillit do ta ndihmojë më mirë çdo person që të zgjedhë rrugëdaljen e tij apo të saj përjetatë shtegut drejt jetës së përjetshme.

Ne që i dëgjojmë dhe i shohim mesazhet e konferencës së përgjithshme, ndonjëherë mendojmë më vonë: "Çfarë mbaj mend më mirë?" Shpresa

e Zotit për çdonjërin prej nesh është që përgjigjja jonë të jetë: "Nuk do t'i harroj asnjëherë çastet kur e ndjeva zërin e Shpirtit në mendjen dhe zemrën time të më tregonte se çfarë mund të bëja për ta kënaqur Atin tim Qielor dhe Shpëtimtarin".

Ne mund ta marrim atë zbuluesë vetjake kur i dëgjojmë profetët dhe apostujt dhe kur punojmë me besim për ta marrë atë, ashtu sikurse Presidenti Li tha që ne mundemi. Unë e di se është e vërtetë nga përvoja dhe nga dëshmimi i Shpirtit. ■

MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

Merreni parasysh ta lexoni me zë të lartë historinë e Presidentit Ajring rreth studimit të variantit të bisedës së konferencës të anëtarit të kuorumit të tij. Ju mund të bëni pyetjen: "Cili është çmimi për marrjen e zbuluesës?" Pas diskutimit tuaj,


ju mund t'i ftoni ata që vizitoni, të përsiatin dhe të zbatojnë një plan për t'i marrë mesazhet e konferencës së përgjithshme të ardhshme "nën ndikimin e të njëjtit Shpirt nëpërmjet të cilit iu dha . . . shërbëtorëve [të Perëndisë]".

Ati Qiellor më Foli Nëpërmjet një Bisede të Konferencës

Nga Ana Laleska Alves de Souza

Kisha dyshime rreth asaj që duhet të studioja në universitet. Shumë njerëz nuk më folën mirë për degën që doja të merrja, ndaj iu luta Zotit për të kuptuar nëse Ai ishte dakord me vendimin tim.

Përgjigjja ime erdhi ditën pasuese ndërsa po lexoja një bisedë të konferencës së përgjithshme të *Liahona*. Ndjeva sikur Ati Qiellor po më thoshte se Ai nuk mund të zgjidhte për mua – ky ishte një vendim që do të duhej ta merrja vetë. E dija se pavarësisht nga ajo që zgjodha, do të duhej të punoja fort për të qenë e suksesshme.




E di se lutja ime mori përgjigje. Konfirmimi i Frymës së Shenjtë më ndihmoi që të merrja një vendim. Kam mësuar të bëj përpjekjet e mia më të mira dhe të di se Ati Qiellor do të më ndihmojë.

Autorja jeton në Serxhipi të Brazilit.

FËMIJËT

Ndiqe Profetin

Profetët dhe apostujt flasin për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin. Ata na mësojnë se si ta ndjekim Jezusin. Ndiqi shtigjet për të shkuar te disa nga gjërat që profeti dhe apostujt na kanë kërkuar të bëjmë.



Studiojeni këtë material me lutje dhe kërkoni të dini se çfarë të thoni prej tij. Si do ta rritë besimin tuaj në Perëndi dhe si do t'i bekojë ato për të cilat kujdeseni nëpërmjet vizitave mësimore, të kuptuarit e dokumentit "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës"? Për më tepër informacion, shkoni te reliefsociety.lds.org.

Bija të Atit Tonë të Përrjetshëm

Shkrimet e shenjta na mësojnë se "ne jemi pasardhës[e] të Perëndisë" (Veprat e Apostujve 17:29). Perëndia i drejtohet Ema Smithit, bashkëshortes së Profetit Jozef Smith, si "bija ime" (DeB 25:1). Proklamata mbi familjen na mëson se ne secila jemi "një . . . bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë"¹.

"Në . . . mbretëri[në para lindjes], ne mësuam rreth identitetit tonë të përrjetshëm si femra", tha Karol M. Stivens, këshilltare e parë në presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës.

"Udhëtimi ynë në tokë nëpër vdekshmëri nuk i ndryshoi ato të vërteta."²

"Ati juaj në Qiell i di emrat tuaj dhe i di rrethanat tuaja", tha Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. "Ai i dëgjon lutjet tuaja. Ai i di shpresat dhe ëndrrat tuaja, përfshirë frikën dhe zhgënjimet tuaja."³

"Secila prej nesh bën pjesë në një familje të Perëndisë dhe është e nevojshme në atë familje", tha Motra



Stivens. "Të gjitha familjet tokësore duken të ndryshme. Dhe ndërsa bëjmë gjithçka mundemi që të krijojmë familje të forta tradicionale, anëtarësia në familjen e Perëndisë nuk është nën varësinë e ndonjë lloji të gjendjes – gjendjes martesore, gjendjes prindërore, gjendjes financiare, gjendjes shoqërore apo madje të llojit të gjendjes që e publikojmë në mediat shoqërore."⁴

Shkrime të Shenjta Shtesë

Jeremia 1:5; Romakëve 8:16; Doktrina e Besëlidhjet 76:23–24

SHËNIME

1. "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
2. Karol M. Stivens, "Familja Vjen nga Perëndia", *Liahona*, maj 2015, f. 11.
3. Jeffrey R. Holland, "To Young Women", *Liahona*, nëntor 2005, f. 28.
4. Karol M. Stivens, "Familja Vjen nga Perëndia", f. 11.
5. Shih Gospel Topics, "First Vision Accounts", topics.lds.org.



Besim, Familje, Ndihmë

Nga Historia Jonë

Në rrëfimin e tij të Vegimit të Parë⁵, Profeti Jozef Smith vërteton shumë të vërteta – duke përfshirë të vërtetën që Ati ynë Qiellor e di emrin tonë.

I riu Jozef u mundua për ta ditur se me cilën kishë të bashkohej dhe gjeti udhërrëfim te Jakobi [Bibël] 1:5. Jozefi vendosi se duhej t'i kërkonte Perëndisë.

Një mëngjes pranvere në vitin 1820, ai shkoi në pyll për t'u lutur por menjëherë u mbërthe nga një fuqi e errët. Për këtë ai shkroi:

"Në këtë çast paniku të madh, unë pashë një shtyllë drite tamam mbi kokën time, më e shkëlqyeshme se dielli, e cila zbriti gradualisht derisa ra mbi mua.

Sapo u shfaq ajo, unë e gjeta veten time të çliruar nga armiku që më mbante të mbërthyer. Kur drita pushoi mbi mua, unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve i kapërcejnë të gjitha përshkrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin – *Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!*" (Joseph Smith – Historia 1:16–17).

Merreni Parasysh Këtë

Si ndikon njohuria se ju jeni një bijë e Perëndisë në vendimet tuaja?

A KANË KUPTIM UDHËZIMET?

Nga Ruth Silver

Një udhëtim me biçikletë më bindi mbi nevojën për ta kontrolluar vazhdimisht hartën e rrugës së jetës të Zotit.

Disa vite më parë, unë shkova në Francë me një udhëtim me biçikletë me motrën time, kunatën dhe vajzën e saj. Çdo mëngjes na u dhanë tri faqe me udhëzime të hollësishme që, nëse ndiqeshin me përpikëri, do të na drejtonin në vendmbërritjen e ditës. Ndërsa po e ngisnim biçikletën nëpër vreshta, orientimet mund të na udhëzonin të “shkonim 50 m në veri, më pas të ktheheshim majtas dhe të ecnim 100 m”. Shumë shpesh, udhëzimet na treguan shenjat rrugore dhe emrat e rrugëve.

Një mëngjes e ngamë biçikletën poshtë një rruge tërheqëse, por shpejt e kuptuam se udhëzimet tona nuk përputheshin më me territorin. Duke qenë se humbëm shumë shpejt, ne vendosëm të ktheheshim atje ku për herë të fundit e dinim se ishim në shtegun e duhur, për të parë nëse mund ta gjenim se nga të shkonim.

Ashtu siç e pritëm, kur arritëm atje, gjetëm një shenjë të vogël rrugore, të shënuar tek udhëzimet tona, që nuk kishim arritur ta shihnim. Shpejt ishim në rrugën tonë përsëri, duke

e përputhur përparimin tonë me udhëzimet, që sërish kishin kuptim të përsosur.

Përvoja shërbeu si një metaforë që iu përgjigj një pyetjeje të mistershme që kisha: “Përse, kur dikush ka pasur një dëshmi për ungjillin, do të largohej vallë nga drejtimi i duhur?” M’u bë e qartë se, kur marrim kthesën e gabuar (mëkatën) ose nuk arrijmë t’i ndjekim urdhërimet e Perëndisë, udhëzimet (fjalët e Perëndisë) nuk kanë më kuptim. Harta, ashtu siç ishte, nuk i përshtatet më territorit në të cilin jemi. Nëse nuk jemi larguar shumë nga udha, ne mund ta kuptojmë se faji është i yni dhe se kemi nevojë të kthehemi (pendohemi) ose të zotohemi sërish për të jetuar siç ka urdhëruar Perëndia atje ku e dinim se po ndiqnim itinerarin me saktësi.

Shumë shpesh, kur udhëzimet nuk i përshtaten më vendit ku jemi, ne i vëmë në dyshim udhëzimet. Në vend që të kthehemi pas, ne i fajësojmë udhëzimet dhe më pas u shmangemi atyre tërësisht. Përfundimisht, duke hequr dorë nga largpamësia për vendmbërritjen tonë, ne humbasim, duke u

endur nëpër udhë që mund të duken, përkohësisht, shumë tërheqëse, por nuk do të na çojnë atje ku kemi nevojë të shkojmë.

Çdo ditë kemi mundësinë për t’i studiuar shkrimet e shenjta. Dhe çdo gjashtë muaj, kemi mundësinë të shohim apo të dëgjojmë konferencën e përgjithshme të Kishës. A nuk janë këto rastet kur mund ta kontrollojmë hartën tonë të rrugës dhe të sigurohemi se jemi atje ku kemi nevojë të jemi? Një herë, kur dëgjoja konferencën, ndjeva se, sado të papërkryer të jemi, ne mund ta dimë se jemi në rrugën e drejtë nëse këto udhëzime kanë kuptim të përkryer për ne.

Ashtu si ndjekja e udhëzimeve të drejta do të na çojë në vendmbërritjet e kësaj jete, studimi i shkrimeve të shenjta dhe të dëgjuarit e këshillës së profetëve të gjallë na lejojnë ta kontrollojmë drejtimin tonë dhe ta përshtatim atë nëse duhet përshtatur që, përfundimisht, të arrijmë në shtëpinë tonë çelestiale. ■

Autorja, e cila jetonte në Kolorado, SHBA, ndërroi jetë vitin e kaluar.



FALEMINDERIT PËR SHËRBIMIN TËND

Nuk jepet emri

Ti mëshiron ato gra të cilat, që nga koha e Navusë, i kanë shërbyer njëra-tjetrës nëpërmjet vizitave mësimore të dashura dhe frymëzuese.

Nuk e di emrin tënd, sa vjeç je. Një ose ndonjë gjë tjetër për ty. Gjithçka që di është se ti je mësuesja vizitore e Joanës, dhe unë e vlerësoj me gjithë zemër shërbimin tënd të ndërjegjshëm.

Unë e di se të vizitosh një motër pak aktive si Joana (emri ka ndryshuar), nusja ime, nuk është e lehtë, sidomos kur ka mundësi që ajo të mos jetë shumë mikpritëse. Unë madje dyshoj se ajo as që donte që ti të shkoje në fillim. Por Joana më ka thënë që ke qenë shoqe e vërtetë për të, duke kaluar nga shtëpia e saj për ta parë se si po ia kalon dhe duke e pranuar ashtu siç është.

Në 19 vjet që kur Joana u martua me tim bir, kjo është hera e parë që ajo e ka përmendur ndonjëherë se ka pasur një mësuese vizitore. Kohët e fundit ajo më tregoi se sa shpesh e viziton dhe sa e kujdesshme dhe dashamirëse je përherë. Më tha se e ke ndihmuar disa herë kur ishte e sëmurë dhe madje ke ofruar që ta çosh mbesën time tek Të Rejat.

Për 10 vitet e fundit, ajo, djali im dhe familja e tyre kanë jetuar qindra kilometra larg nesh. Jam lutur që njerëz të tjerë do t'i duan dhe do të kujdesen



për ta si unë dhe i jam lutur duke qarë Atit Qiellor që njerëz të tjerë t'u vinin në ndihmë atyre siç do të bëja unë nëse do të jetonin afër. Nga ajo që thotë Joana, ti je përgjigjja e lutjeve të mia.

Edhe nëse Joana dhe im bir nuk i binden Fjalës së Urtësisë dhe nuk marrin pjesë në kishë, ata prapëseprapë janë njerëz të mirë dhe i duan fëmijët e tyre. Në njëfarë mënyre sytë e tu nuk ishin të mjegulluara nga tymi i cigares së Joanës. Ti nuk e përkufizove atë nga fakti a shkonte në Kishë apo jo. Ti arrite ta njohësh atë dhe mësove se ajo është një nënë e dashur, e cila do që vajza e saj të shkojë në kishë dhe të fitojë një dëshmi. Dhe

kur Joana bëri një ndërhyrje kirurgjikale, ti i solle darrkën në vend që të pyesje veten nëse ajo i kishte shkaktuar vetë disa nga problemet e saj shëndetësore.

Sa mirënjohëse jam që je një shembull për mbesën time. Ajo mund të të shohë ty si dikush që kujdeset për këdo dhe bën përpjekje të mëdha për të treguar interes me dashuri. Ajo më tha se një ditë kur nuk kishe makinë, ti ece më tepër se një kilometër e gjysmë për në shtëpinë e saj bashkë me fëmijët e tu të vegjël, për t'iu çuar biskota.

“Po mendoja për ty dhe nënën tënde dhe dëshiroja të bëja diçka të kënaqshme për ju – thjesht doja”, i the asaj.

Sa do të doja të të thoja se sa shumë e vlerësoj përkushtimin tënd në thirrjen tënde si mësuese vizitore. Ti mëshiron ato gra të cilat, që nga koha e Navusë, i kanë shërbyer njëra-tjetrës nëpërmjet vizitave mësimore të dashura dhe frymëzuese. Ti e ke treguar atë shërbim dhe dashuri nëpërmjet mënyrës se si e ke vizituar dhembshurisht nusen time pak aktive.

Faleminderit. ■



**Nga Plaku
L. Tom Peri
(1922–2015),**

i Kuorumit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

PRIFTËRIA: NJË SPIRANCË E SIGURT

Ky artikull u përgatit nga Plaku L. Tom Peri më 28 maj 2015, dy ditë përpara se ai të ndërronte jetë, për t'u ndarë me mbajtësit e rinj të priftërisë.

Forca më e madhe në jetën time ka qenë priftëria e Perëndisë. Besoj se ajo do të jetë një spirancë e sigurt edhe për ju të rinjtë. Por që ajo të ketë fuqi në jetën tuaj, ju keni nevojë ta kuptoni dhe ta përdorni atë.

Përvojat e Hershme me Priftërinë

Unë u rrita në një mjedis të rehatshëm në Logan të Jutës. Nuk kisha shqetësime në fëmijëri rreth ushqimit, strehimit apo arsimimit. Por ndoshta ngaqë jeta ishte e kollajshme, unë kisha nevojë për diçka ku të mbështetesh, e cila do të më shërbente si spirancë.

Për mua ajo spirancë ishte priftëria e Perëndisë. Isha në një gjendje të pazakontë kur po rritesha. Babai im u thirr të ishte peshkopi kur unë isha një vjeç dhe ai ishte peshkopi im për 19 vjet. Udhëzimi i tij atëror dhe shpirtëror ishin një ndihmë e jashtëzakonshme për mua.

Mendoj se kjo ishte kryesisht arsyeja përse mezi prisja të merrja Priftërinë Aarone në ditëlindjen time të 12-të. Më kujtohet dita e veçantë kur i ndjeva duart e babait tim mbi kokë teksa

më shuguronte. Pas kësaj, unë përpara në detyrat e Priftërisë Aarone dhe mora thirrje që më pëlqyen shumë.

Shpërndarja e sakramentit ishte tepër e veçantë për mua. Mund t'i shihja njerëzit të zotoheshin për t'iu bindur Zotit dhe për t'iu zbatuar urdhërimet e Tij, ndërkohë që merrnin emblemat e trupit dhe të gjakut të Tij.

Rritja në Kuptueshmërinë e Priftërisë

Ndërsa koha kalonte, unë u diplomova nga shkolla e mesme dhe më vonë, pas një viti në kolegji, u thirra në një mision. Më pëlqeu çdo minutë e tij dhe i doja shokët e mi. Njëri në mënyrë të veçantë ishte forcë për mua. Mësova shumë prej tij ndërsa i përmbushnim përgjegjësitë tona.

Ngaqë atdheu ishte në luftë, kur u ktheva nga misioni u bashkova me Korpusin e Marinave të Shteteve të Bashkuara. Kur lufta mbaroi, u ktheva në kolegji, u martova dhe krijova një familje. Lëvizjet e suksesshme profesionale më çuan në shumë vende anembanë Shteteve të Bashkuara, ku mësova shumë teksa shërbeja në thirrje të shumta të priftërisë. Më së fundi u vendosa në Boston të Masaçusetsit, ku shërbeva si president kunji. Nga atje u thirra të isha

një ndihmës i Të Dymbëdhjetëve dhe më vonë, pas 17 muajsh, në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve.

Mësime të Mësuar si Apostull

Çfarë kam mësuar si anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve?

Kam mësuar se gjendet një udhërrëfyes, një spirancë dhe një mbrojtje te priftëria.

Priftëria ka ekzistuar gjithmonë. Përpara se Adami të vinte në tokë, ai e kishte priftërinë. Ndërkohë që pasardhësit e Adamit u shpërndanë me priftërinë, u bë e nevojshme të organizohej se si do të administrohej priftëria. Zoti e bëri atë duke thirrur Abrahamin që të kryesonte mbi





familjen e tij të mbajtësve të priftërisë. Ky organizim vazhdoi nën drejtimin e Isakut dhe Jakobit, emri i të cilit më vonë u ndryshua në Izrael.

Shekuj më vonë, fëmijët e Izraelit e gjetën veten në robëri. Zoti dërgoi Moisiun për t'i çliruar ata, por, kur ai e bëri këtë, ata e provuan vetveten që, si popull, nuk ishin gati për Priftërinë Melkizedeke. Prandaj u lanë me Priftërinë Aarone deri në kohën e Shpëtimtarit.

Më duket shumë interesante ajo që Shpëtimtari bëri fillimisht kur Ai e filloi shërbesën e Tij. Ai organizoi Priftërinë Melkizedeke. Ai thirri dy mbëdhjetë Apostuj dhe u mësoi atyre ligjet dhe urdhrin e priftërisë. Ai thirri Pjetrin që të ishte Apostulli kryesues, duke themeluar linjën e autoritetit në

Kishën e Tij. Në atë kohë dhe në këtë kohë, është Jezu Krishti i cili e zgjedh Apostullin e Tij kryesues për të kryesuar mbi Kishën dhe është Shpëtimtari i cili e drejton atë në detyrat e tij të priftërisë.

Prandaj priftëria ka një linjë të drejtpërdrejtë nga Zoti dhe Shpëtimtari ynë nëpërmjet Apostullit kryesues tek Apostujt e tjerë dhe te mbajtësit e tjerë të priftërisë në Kishë. Çelësat e autoritetit u jepen Apostujve dhe, për aq kohë sa ato çelësa janë mbi tokë, ne vërtet do të udhëhiqemi nga Zoti Vetë. Ky drejtim hyjnor na mbron dhe na siguron që Kisha nuk do të largohet nga e vërteta. Ai do të mbetet i palëkundshëm ngaqë nuk drejtohet nga ndonjë qenie tokësore. Ai drejtohet nga Zoti.

Mësojini Doktrinat e Priftërisë

Këshilla më e madhe që kam për ju të rinj, është t'i studioni doktrinat e priftërisë, ta kuptoni fuqinë që keni në ushtrimin e priftërisë suaj dhe të mësoni se si ajo mund ta bekojë jetën tuaj dhe jetën e njerëzve të tjerë.

Ju premtoj që, nëse do t'i mësoni doktrinat e priftërisë dhe do t'i përmbushni detyrat tuaja të priftërisë, priftëria do të jetë një spirancë e sigurt që do t'ju mbajë të sigurt shpirtërisht dhe do t'ju sjellë gëzim të madh. Jini një kuorum i vërtetë i priftërisë. Ndhimojini shokët tuaj dhe sillini në kuorumin tuaj. Krijoni një vëllazëri në kuorumin tuaj që do të jetë një themel i përhershëm për jetën tuaj. ■

Plaku Ronald A. Rasband

UDHËHEQËS PLOT
DHUNTI, ATË PLOT
PËRKUSHTIM

Nga Plaku M. Rasëll Ballard,

i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ron Rasbandi kurrë nuk dyshoi se ai do të shërbente në një mision kohëplotë. E vetmja pyetje që kishte 19-vjeçari teksa hapte thirrjen e tij të misionit, ishte se *ku* do të shërbente.

“Babai im shkoi në një mision në Gjermani. Vëllai im më i madh shkoi në një mision në Gjermani. Kunati im i ardhshëm shkoi në një mision në Gjermani”, kujton ai. “Mendova se do të shkoja në Gjermani.”

Por Zoti kishte plane të tjera. Në vend të kësaj, Roni ishte thirrur në Misionin e Shteteve Lindore, me zyrat qendrore të vendosura në Nju-Jork-Siti të SHBA-së. I zhgënjyer, ai e mori thirrjen e tij në dhomën e gjumit, u ul në gjunjë pranë shtratit, tha një lutje, i hapi rastësisht shkrimet e tij të shenjta dhe filloi të lexonte:

“Vini re dhe shihni, unë kam shumë njerëz në këtë vend, në krahinat përreth; dhe një derë frytdhënëse do të hapet në krahinat përreth në këtë *tokë të lindjes*.”

Si rrjedhim, unë, Zoti, ju kam lejuar të vini në këtë vend; sepse kështu është e dobishme për mua për shpëtimin e shpirtave” (DeB 100:3–4; theksimi i shtuar).

Menjëherë, Fryma e Shenjtë i pohoi Ronit se thirrja e tij për në Misionin e Shteteve Lindore nuk ishte një gabim.

“Shkova nga të qenit i zhgënjyer në të pasurin e mbresës sime të parë nga shumë mbresa të shkrimeve të shenjta, se atje



ishte vendi ku Zoti donte që unë të shkoja”, kujton ai. “Ajo ishte një përvojë shpirtërore jetike për mua.”

Misioni i tij për në Shtetet Lindore ishte thirrja e parë nga shumë thirrje të Kishës që do ta çonin atë në vende ku kurrë nuk e prishte se do të shkonte. Dhe me çdo thirrje – si mësues, peshkop, këshilltar i lartë, president misioni, anëtar i Të Shtatëdhjetëve, Presidenti Kryesues i Të Shtatëdhjetëve dhe Apostull i Zotit Jezu Krisht – Plaku Ronald A. Rasband e ka pranuar vullnetin e Zotit dhe ka vazhduar të mbështetet te Shpirti i Tij, ndërkohë që u ka shërbyer fëmijëve të Perëndisë.

Lart djathtas: Plaku Ronald A. Rasband si president misioni në Nju-Jork-Siti në vitin 1998. Më e largëta djathtas: Plaku Rasband me motrën e tij, Nensi Shindlerin; nëna; dhe vëllezërit, Rasëlli dhe Nilli. Djathtas: Me prindërit e tij kur ishte djalë shtatëvjeçar.



Roni ishte në përgjithësi një djalë i mirë, por ai e pranon se kishte një prirje mistreçe. “Mjaft herë, mësueset e mia [të Fillores] shkuan te nëna ime, presidentja e Fillores së kunjtit, dhe i thanë: ‘Ai Roni Rasbandi është një fëmijë i vogël, i vështirë’”, thotë ai. “Por ato kurrë nuk hoqën dorë nga unë. Ato më

treguan dashuri të madhe dhe gjithmonë më ftuan të vija përsëri në klasë.”²

Fëmijëria e Ronit u përqendrua te Kisha – mbledhjet e lagjes, festimet e lagjes, darkat e lagjes dhe skuadrat sportive të lagjes. Kur nuk ishte i zënë me punë në shtëpinë e mbledhjeve të Lagjes së Parë të Kotëndutit, ai bënte punë të ndryshme, kryente veprimtaritë e skautizmit dhe kalonte kohë me shokët e tij. Në shtëpi, koha familjare përqendrohej te shkrimet e shenjta, lojërat dhe punët e shtëpisë.

“Babai im më mësoi se çfarë është puna nëpërmjet shembullit të tij”, thotë ai. “Nëna ime më mësoi rreth punës duke më bërë që ta bëja atë.”

Babai i Ronit ngiste një kamion që shpërndante bukë, duke u ngritur çdo ditë në orën 4:00 të mëngjesit dhe duke u kthyer në shtëpi vonë çdo natë. Nëna e tij qëndronte në shtëpi për të rritur fëmijët, duke i shtuar të ardhurat e familjes nëpërmjet bërjes dhe shitjes së kukullave prej porcelani me veshje me dantella.

Aftësia e brendshme e Ronit për të udhëhequr, për të caktuar detyra dhe për t'i bërë gjërat – aftësi e cila do t'i

I Lindur nga Prindër të Mirë

Në bisedën e tij të parë si Apostull i Jezu Krishtit, Plaku Rasband shprehu mirënjohje të përzemërt për paraardhësit e tij. “Unë u lindi në ungjill nga prindër të mirë”, tha ai, “dhe ata nga prindër të mirë duke shkuar pas gjashtë breza.”¹

Nëna e tij, Verda Anderson Rasbandi, ishte një udhëheqëse e dashur, e cila e ushqeu dashurinë e Ronit të ri për shkrimet e shenjta. Babai i tij, Ralon Hokins Rasbandi, ishte një mbajtës besnik i priftërisë, i cili ishte një shembull i virtytit të punës së shumtë.

I lindur më 6 shkurt 1951 në Solt-Lejks-Siti të Jutës në SHBA, Ronald A. (Anderson) Rasbandi ishte i vetmi fëmijë i martesës së prindërve të tij. Që të dy ishin martuar e divorcuar dhe Roni u rrit nën kujdesin e shtuar të dy vëllezërve më të mëdhenj dhe të një motre më të madhe.

“Ai ishte një ndërthurje e prindërve tanë, kështu që ne të gjithë e donim atë”, thotë motra e tij, Nensi Shindleri. “Roni kurrë nuk i lejoi mamën dhe babin të qëndronin pranë njëri-tjetrit ose të uleshin së bashku pa qëndruar vetë në mes të tyre.”





shërbente atij mirë në përgjegjësitë e tij profesionale dhe kishtarë – u provua të ishte e dobishme që herët.

“Roni u caktua të priste barin e oborrit”, kujton motra e tij. Por Roni, sikurse Tom Sojeri i Mark Tuenit, kishte një mënyrë për t’i bindur shokët e tij që ta ndihmonin.

“Do të shihja jashtë dhe atje do të ishte shoku i tij i ngushtë duke prerë barin për të”, thotë Nensi. “Javën pasuese një tjetër nga shokët e tij po priste barin. Ai thjesht ulej në hajatin përpara shtëpisë dhe qeshte e bënte shaka me ta, ndërkohë që ata bënin punën e tij.”

Prindërit e Ronit kishin vështirësi financiare, por familja kishte ungjillin. “Ne kurrë nuk kishim shumë para”, kujton Roni, “por kjo gjë nuk e ndikoi kurrë lumturinë time.”

Miqtë dhe Udhëheqësit e Mirëbesuar

Teksa rritej, Roni u bekua me miq të mirë dhe mësues të mirëbesuar të priftërisë, duke përfshirë presidentin e kunjit të djalërisë së tij për 14 vjet – Xhejms E. Faustin (1920–2007), i cili më pas shërbeu në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve dhe në Presidencën e Parë. Familja e Ronit gëzonte një lidhje të ngushtë me Presidentin Faust dhe familjen e tij. “Ai gjithmonë m’u drejtua mua si njëri prej djemve të tij nga Kotënudi, sepse më ndihmoi të rritesha”, thotë ai.

Roni nuk kishte kohë për sporte shkollore kur arriti në shkollën e mesme ngaqë gjithmonë kishte një punë, por ai gjente kohë për miq besnikë që kanë mbetur të tillë gjatë gjithë jetës.



“Gjithmonë e kam admiruar Ronin për atë që është, por ai nuk ishte i përsosur”, thotë shoku i fëmijërisë Kreig Mek-Kliri. Me buzëqeshje, ai shton: “I kam thënë që, nëse ai shkon në qiell, edhe unë do të shkoj atje ngaqë ne bënim të njëjtat gjëra ndërkohë që rriteshim”.

Roi u nis për në misionin e tij në fillim të vitit 1970, por Kreigu po mendonte ta shtynte shërbimin misionar deri pas sezonit të gjuetisë atë vjeshtë. Ajo ishte koha kur Roni e mori në telefon nga misioni i tij.

“Nuk e di se si mori leje që të mernte në telefon, por ai më qortoi që nuk isha më i gëzuar për të vajtur menjëherë në misionin tim”, thotë Vëllai Mek-Kliri. “Sigurisht që nuk e vonova më atë.”

Roni e quan misionin e tij një përvojë “fantastike”. “Zoti më bekoji me shumë përvoja të mrekullueshme dhe besimforcu-ese”, thotë ai. “Misioni im ishte shumë i rëndësishëm për jetën time shpirtërore.”

Roni e kaloi një pjesë të misionit të tij në ishujt e Bermudës. Presidenti i tij i misionit, Harold Nefi Uillkinsoni, dërgonte atje vetëm “misionarët e patundshëm” ngaqë ai mund t’i vizitonte ata vetëm me raste.

“Ishim tërësisht të vetëm, por presidenti nuk kishte

Që nga fillimi i martesës së tyre, Plaku dhe Motra Rasband e kanë vënë Zotin të parin. Të martuar më 4 shtator 1973 (poshtë), ata u bekuan më pas me katër bija dhe një bir (sipër). Faqja ngjitur: Xhon Hantsman Plaku, ish-bashkëpunëtori dhe ish-mësimdhënësi në biznes i Plakut Rasband, e quan Plakun Rasband një “udhëheqës plot dhunti me një besnikëri të fuqishme”.



përse të shqetësohej rreth nesh”, kujton Roni. “Ne e kryenim punën.”

“Vajza Ideale” nga Delta Fi-ja

Pasi e përfundoi misionin e tij në vitin 1972, Roni gjeti një punë, u regjistrua në Universitetin e Jutës atë vjeshtë dhe u bashkua me Delta Fi Kapën, një klub studentor për misionarët e kthyer nga misioni. Në veprimtaritë shoqërore të klubit studentor, nuk mundi të mos vinte re një vajzë të re tërheqëse, të quajtur Melani Tuiçëll. Melania ishte një nga “vajzat ideale”, të zgjedhura nga Delta Fija, e cila ndihmonte për veprimtaritë e shërbimit të klubit studentor.

Sikurse Roni, Melania vinte nga një familje aktive e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme. Babai i saj, me një karrierë si oficer ushtarak, dhe nëna e saj nuk i lejuan kurrë transferimet e shpeshta të familjes që të bëheshin një justifikim për të mos shkuar në kishë.

Melanisë i bëri përshtypje mirësia, mirësjellja dhe njohuria e Ronit për ungjillin. “Thashë me vete: ‘Ai është një djalë kaq i mahnitshëm sa s’ka rëndësi nëse kurrë nuk shkoj në një takim me të. Unë thjesht dua të jem shoqja e tij më e ngushtë.’”

Ndërkohë që marrëdhënia e tyre u rrit, Shpirti ia pohoi mbresat e saj për Ronin dhe për zotimin e tij ndaj Zotit. Shpejt miqësia e tyre lulëzoi në atë që Melania e quajti një “romancë përrallore, si nëpër libra”.

Plaku Rasband thotë se ajo ishte një përputhje e përsosur. “Melania ishte tërësisht e barabarta ime në përkushtimin ndaj ungjillit dhe në prejardhje shoqërore. Ne fillimisht u bëmë miqtë më të mirë dhe ishte atëherë që i kërkova të martohej me mua.”

Ata u martuan më 4 shtator 1973 në Tempullin e Solt-Lejkut. Që nga ajo kohë, thotë ai, bashkëshortja ime vetëmohuese, e përjetshme . . . më “ka ndihmuar për të më dhënë formë, sikurse argjilës së poçarit, në një dishepull më të përpunuar të Jezu Krishtit. Dashuria dhe përkrahja e saj, dhe ajo e 5 fëmijëve tanë, e bashkëshortëve të tyre dhe e 24 nipërve e mbesave tona, më mbështetën mua.”³

“Le të Shkojmë”

Ndërsa shërbente si president i kuorumit të pleqve në lagjen e tij të studentëve të martuar, Roni u njoh me Xhon Hantsman Plakun, këshilluesin nga këshilli i lartë për lagjen. Xhonit i bëri përshtypje menjëherë mënyra se si Roni e drejtonte kuorumin.

“Ai kishte aftësi udhëheqëse dhe organizuese të pabesueshme”, kujton Plaku Hantsman, i cili shërbeu si një I Shtatëdhjetë Zonal nga viti 1996 deri në 2011. “E mendova të pazakontë që një i ri, i cili ishte ende në kolegji, mund ta drejtonte një kuorum në një mënyrë të tillë.”

Për disa muaj, Xhoni e vëzhgoi Ronin t’i kthente idetë në veprime teksa përmbushte detyrat e priftërisë. Kur një pozitë marketingu e nivelit të lartë u hap në kompaninë e Xhonit – që do të bëhej Korporata Hunstman Chemical – ai arriti në përfundimin që Roni i kishte aftësitë që ai dëshironte, dhe ia ofroi atij punën. Pozita fillonte javën pasuese në Ohajo të SHBA-së.

“I thashë Melanisë: ‘Nuk do ta lë shkollën dhe të transferohem’”, kujton Roni. “Kam punuar tërë jetën time që të diplomohem nga kolegji dhe më së fundi jam pranë arritjes së synimit tim.”

Melania ia kujtoi Ronit se gjetja e një pune të mirë ishte arsyeja përse ishte në shkollë.

“Për çfarë shqetësohesh?” pyeti ajo. “Unë di se si të paketoj dhe të transferohem. E kam bërë atë tërë jetën time. Do të të lë ta marrësh nënën tënde në telefon çdo natë. Le të shkojmë.”

Vetëbesimi i Xhonit te Roni u provua të ishte i drejtë. Nën kujdestarinë e Xhonit, Roni përparoi me të shpejtë brenda një kompanie në rritje, duke u bërë presidenti dhe drejtori kryesues operativ i saj në vitin 1986. Ai udhëtoi gjerësisht për kompaninë – si brenda edhe jashtë Shteteve të Bashkuara. Pavarësisht nga programi i tij i ngjeshur, Roni përpiquej të ishte në shtëpi në fundjavat. Dhe kur udhëtonte, me raste ai do të merrte me vete pjesëtarë të familjes.

“Kur ishte në shtëpi, ai me të vërtetë i bënte fëmijët të ndiheshin të veçantë dhe të dëshiruar”, thotë Melania. Ai i frekuentonte aktivitetet dhe veprimtaritë e tyre sportive kurdoherë që mundej. Xhenesa Mek-Firsoni, një nga katër bijat e çiftit Rasband, thotë që detyrat kishtarë të së dielës shpesh e bënë babanë e saj që të mos ulej me familjen gjatë mbledhjeve të Kishës.





“Ne do të ziheshim se kush do të ulej pranë tij në kishë, sepse ishte një gjë e rrallë ta kishim atë atje”, thotë ajo. “Më kujtohet ta vija dorën time mbi dorën e tij dhe të mendoja me vete: ‘Nëse thjesht mund të mësoja që të isha si ai, unë do të jem në udhën e duhur dhe do të bëhem më shumë si Shpëtimtari’. Ai ishte gjithmonë heroi im.”

Biri i çiftit Rasband, Kristiani, tregon kujtime të përzemërta të “kohës babë-bir”. Miqtë vinin e shkonin për shkak të transferimeve të shpeshta të familjes, thotë ai, “por babai im ishte gjithmonë miku im më i mirë” – edhe pse ai ishte një mik konkurrues.

Qoftë kur luante basketboll me Kristianin, kur luante një lojë tavoline me bijat e tij apo peshkonte me familjen e shoqërinë, Roni dëshironte të fitonte.

“Teksa rriteshim, ai nuk do ta *linte* askënd të fitonte”, thotë Kristiani. “Ne duhej ta fitonim vetë atë, por ajo na bëri më të mirë. Dhe tradita vazhdon me nipërit e mbesat e tij të dashura.”

Përgjatë viteve, familja e Ronit nuk mund të mos vinte re se si shërbesa në udhëheqjen e Kishës e lartësoi aftësinë e tij për të treguar dashuri e dhembshuri, për të shprehur ndjenja të Shpirtit dhe për t’i frymëzuar të tjerët të bënin më të mirën që mundeshin. Pas lindjes së nipit të Ronit dhe Melanisë, Pakstonit, familja u mbështet fuqishëm te forca dhe mbështetja shpirtërore e Ronit.

Pakstoni, i lindur me një çrregullim të rrallë gjenetik, vuan nga një mori problemesh

shëndetësore, të cilat e vunë në provë familjen fizikisht, emocionalisht e shpirtërisht. Plaku Rasband e ka quajtur udhëtimin që e pasoi lindjen e Pakstonit, “një provë [të] vështirë për marrjen e mësimave të veçanta lidhur me të ardhmen e tyre në përjetësi[të]”⁴.

Gjatë tri viteve të shkurttra të Pakstonit në tokë – kur pyetjet ishin të shumta dhe përgjigjet të pakta – Plaku Rasband qëndroi si një shtyllë shpirtërore, duke e udhëhequr familjen e tij që të mbështetej te fuqia e Shlyerjes së Jezu Krishtit.

Me shpalljen e thirrjes së tij të re, mjaft anëtarë të familjes dhe miq nuk u habitën. “Ata prej nesh që e njohin atë më mirë”, thotë Kristiani, “i ngritëm duart tona më lart nga të gjithë kur ai u mbështet si një Apostull”.

“Do të Shkoj të Shërbej”

Në vitin 1996, në moshën 45-vjeçare, Roni ishte në mes të një karriere të suksesshme kur thirrja erdhi për të shërbyer si president misioni në Misionin e Nju-Jorkut Verior në shtetin e Nju-Jorkut. Si Apostujt e lashtë, ai “i la menjëherë rrjetat [e tij]” (Mateu 4:20).

“Pranimi i thirrjes zgjati më pak se një sekondë”, thotë Plaku Rasband. Ai i tha Zotit: “Në qoftë se Ti dëshiron që unë të shkoj për të shërbyer, unë do të shkoj të shërbej”.



Majtas lart: Plaku dhe Motra Rasband me anëtarë të Kishës në Nju-Delhi të Indisë në nëntor të vitit 2015. Lart: Plaku dhe Motra Rasband gjatë shërbimit të tij si president misioni në Nju-Jork-Siti, vitet 1996–1999; me nipin e tyre, Pakstonin, i cili e ndihmoi familjen të mësonte “mësime të veçanta lidhur me të ardhmen e tyre në përjetësi[të]”; dhe në ceremoninë e gurit të qoshes së Tempullit të Sakramentos në Kaliforni.

Roni mori me vete një mësim të madhërishtëm që e kishte mësuar nga përvoja e tij profesionale: “Njerëzit janë më të rëndësishëm sesa çdo gjë tjetër”⁵. Me atë dituri dhe aftësitë e tij të mprehtësuara të udhëheqjes, ai ishte gati të fillonte shërbimin e tij kohëplotë në mbretërinë e Zotit.

Roni dhe Melania mësuan se puna misionare në Nju-Jork-Siti ishte sfiduese, si edhe gjallëruese. Roni ishte i shpejtë në caktimin e përgjegjësisë misionarëve – duke frymëzuar besnikërinë e tyre dhe duke u dhënë mësim, duke i forcuar e lartësuar ata në atë proces.

Në vitin 2000, vetëm tetë muaj pasi Roni dhe Melania e kishin përmbushur misionin e tyre, Roni u thirr në Të Shtatëdhjetët, ku përgatitja, përvoja dhe talentet e tij të shumta e kanë bekuar Kishën. Në rolin e një anëtarit të Të Shtatëdhjetëve, ai shërbeu si këshilltar në Presidencën e Zonës së Europës Qendrore, duke ndihmuar në mbikëqyrjen e punës në 39 kombe. Edhe pse ai u largua nga kolegji më shumë se 40 vjet më parë, ai mbetet një student i vërtetë, duke e mirëpritur mësimdhënien e vazhdueshme nga Vëllezërit e tij më me përvojë, ndërkohë që mbikëqyrte Zonat Perëndimore dhe Veriperëndimore të Amerikës Veriore dhe tri Zona në Jutë; ndërkohë që shërbente si Drejtor Ekzekutiv në Departamentin e Tempullit; dhe shërbente në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve, duke punuar ngushtësisht me Të Dymbëdhjetët.

Kohët e fundit, Plaku Rasband vërejt: “Çfarë nder dhe privilegj i madh është për mua të jem më i vogli mes Të Dymbëdhjetëve dhe të mësoj prej tyre në çdo mënyrë dhe në çdo rast”⁶.

“Çfarë Ata e Dinin, Unë e Di”

Dy piktura i zbukurojnë muret e zyrës së Plakut Rasband. Njëra është ajo e misionarëve mormonë duke i dhënë mësim një familjeje në Danimarkë në vitet 1850. E dyta është e një misionari të hershëm, Den Xhonsit, duke predikuar nga parmaku i një pusi në Ishujt Britanikë. Pikturat (lart djathtas) i kujtojnë Plakut Rasband paraardhësit e vet.

“Këta pionierë të hershëm dhanë gjithçka që kishin për ungjillin e Jezu Krishtit dhe për të lënë një trashëgimi që ta ndiqnin pasardhësit e tyre”, ka dëshmuar ai.⁷ Gjëja që i shtyu paraardhësit e Plakut Rasband të ecnin përpara mes kundërshtisë dhe përndjekjes, është gjëja që e kualifikon atë më shumë për thirrjen e tij të re: një dituri dhe një dëshmi e sigurt për Zotin dhe punën e Tij.



“Kam kaq shumë për të mësuar në thirrjen time të re”, ka thënë ai. “Ndihem shumë i përlurur rreth kësaj gjëje. Por ka një aspekt të thirrjes sime që mund ta bëj. Unë mund të jap dëshmi për ‘emri[n] e Krishtit në gjithë botën’ (DeB 107:23). Ai jeton!”⁸

Si një stërnip i pionierëve, ai shton: “Atë që ata e ndien, unë e ndiej. Atë që ata e dinin, unë e di.”⁹

Dhe ajo për të cilën shpresuan për pasardhësit e tyre, mishërohet në jetën, mësimet dhe shërbimin e Plakut Ronald A. Rasband, i cili po e ndjek shembullin e tyre dhe po e nderon trashëgiminë e tyre teksa ecën përpara si një dëshmitar i veçantë i Zotit. ■

SHËNIME

1. Ronald A. Rasband, “Qëndroj plot Habi”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 89.
2. Ronald A. Rasband, “Friend to Friend: Golden Nuggets”, *Friend*, tetor 2002, f. 8.
3. Ronald A. Rasband, “Qëndroj plot Habi”, f. 89.
4. Ronald A. Rasband, “Mësime të Veçanta”, *Liahona*, maj 2012, f. 80.
5. Ronald A. Rasband, konferencë shtypi, 3 tetor 2015.
6. Ronald A. Rasband, dëshmi, takim shpirtëror i Departamentit të Pritërisë dhe Familjes, 1 dhjetor 2015.
7. Ronald A. Rasband, “Qëndroj plot Habi”, f. 89.
8. Ronald A. Rasband, dëshmi.
9. Roland A. Rasband, bisedë për Ditën e Pionierëve, në Tabernakullin në Solt-Lejk-Siti, 24 korrik 2007.

Ngaqë kisha qenë më pak aktiv vite më parë, një anëtare që më njihje në atë kohë, nuk mund ta besonte se u thirra të isha një peshkop.

Nga Patrik J. Kronin III

Gjatë një mbledhjeje të komitetit ekzekutiv të priftërisë, misionarët tanë kohëplotë raportuan se ishin takuar me një anëtare dokumentet e të cilës nuk ishin në lagje. E njoha emrin menjëherë dhe përmenda se ajo dhe unë kishim qenë në të njëjtën lagje shumë vite më parë.

Një nga misionarët tha: “Po, peshkop, ajo e përmendi atë dhe u duk mjaft e habitur që ju ishit peshkopi”.

I pyeta: “Çfarë tha ajo?”

Thanë se ajo u duk mjaft e habitur dhe tha: “Ai është peshkopi?”

M'u desh të qeshja dhe shpjegova se kjo motër më njihje si një njeri krejt të ndryshëm 30 vjet më parë.

Ndërsa e solla ndërmend këtë ngjarje më vonë, mendova se sa shumë kishte ndryshuar jeta ime gjatë 30 e ca viteve që familja ime dhe unë kemi qenë anëtarë. Kam njohur shumë anëtarë të lagjes sonë për 20 vjet dhe kam shërbyer si president dege dhe si peshkop, por askush nga këta anëtarë nuk më njihje 30 vjet më parë. Edhe pse me raste kisha treguar ngjarje nga e kaluara ime për të dhënë mësim rreth pendimit dhe Shlyerjes së Jezu Krishtit, shumica e lagjes nuk e di se çfarë udhëtimi i pabesueshëm ka qenë jeta ime në Kishë.

Familja ime dhe unë u njohëm me Kishën në maj të vitit 1979 dhe menjëherë e dija që kjo ishte Kisha së cilës i përkisnim. U pagëzuam në qershor dhe fillimisht ne të gjithë

ishim aktivë, por nuk kaloi shumë kohë përpara se unë të mos e frekuentoja më Kishën dhe të kthehesha te zakonet e vjetra. Në të vërtetë asnjëherë nuk pata ndonjë dyshim rreth vërtetësisë së ungjillit dhe Rivendosjes, por nuk mendoja se e kisha atë që kërkohej për të qenë një anëtar i mirë i Kishës.

Në vitin 1982, për shkak të abuzimit tim të vazhdueshëm me alkoolin, bashkëshortja ime, e cila nuk e kishte braktisur kurrë besimin e saj, bëri dokumentet e divorcit. Në atë kohë familja ime po jetonte në Oklahoma, SHBA, por unë isha kthyer në Illinois, SHBA, ku isha rritur. Kisha arritur pikën ku isha gati duke humbur të vetmen gjë që kishte me të vërtetë rëndësi për mua: familjen time.

Fillova t'i lutem në gjuhë çdo mëngjes e mbrëmje një Perëndie, për të cilin nuk isha më i sigurt se ekzistonte ose, nëse ekzistonte, mendoja që Ai më kishte harruar prej shumë kohësh. Prapëseprapë për tre muaj u luta besnikërisht. Herët një mëngjes, teksa isha i zhytur thellë në lutje, më erdhi një ndjenjë lehtësimi të madh dhe e dija se Perëndia jetonte, se Ai më njihje mua dhe se Ai më donte mua. Gjithashtu e dija se kurrë nuk do të prekja më me dorë asnjë pikë tjetër alkooli.

Pikërisht atë mbrëmje mora një telefonatë nga bashkëshortja ime për të më thënë se ajo do të dërgonte me postë dokumentet e divorcit për t'u nënshkruar. Gjatë asaj bisede, ajo papritur tha: “Ka diçka shumë ndryshe rreth teje. Nuk besoj se do të pish më ndonjëherë dhe unë do

Ai

ËSHTE PESHKOPI?

t'i gris këto dokumente". Ne u ribashkuam dhe dy vjet më vonë ajo lindi djalin tonë të tretë.

Dikush do të hamendësonte se unë do të kthehesha në aktivitet të plotë në Kishë, por unë jam një burrë kokëfortë. U ktheva për njëfarë kohe dhe madje mora një thirrje si mësues në kuorumin e pleqve. Por shpejt fillova të ndihem i papërshtatshëm për të dhënë mësim dhe sërish u bëra joaktiv.

Në vitin 1991 ne lëvizëm në një degë të vogël. Disa muaj përpara ditëlindjes së tetë të djalit tonë më të vogël, bashkëshortja ime, presidentja e Fillores, e pyeti atë se cilin donte ai që ta kryente pagëzimin e tij. Sigurisht ai donte që babai i tij ta kryente ordinancën. Bashkëshortja ime i tha atij se ndoshta ajo nuk do të ndodhte. Ai nuk e pranoi atë përgjigje dhe caktoi detyrën e aktivizimit të babait të tij. Ishte tepër i palëkundshëm dhe pa vonesë unë e gjeta veten duke shërbyer si mësues i skautistëve dhe më vonë e pagëzova dhe e konfirmova birin tim.

Tetë muajt që e pasuan aktivizimin tim, ishin plot ngjarje. Ne u vulosëm si



familje në Tempullin e Çikagos në Illinois dhe përsëri u thirra të shërbeja si mësues në një kuorum të pleqve, veçse këtë herë nuk hoqa dorë. Më pas u thirra si këshilltar në presidencën e degës dhe pesë muaj më vonë u thirra të shërbeja si presidenti i degës. Rreth një muaj pas thirrjes sime, më kujtohet që po mendoja: "Unë jam presidenti i degës?"

Përgjatë viteve u kam thënë shumë shenjtorëve që hasin vështirësi, se, nëse unë mund të përparoj në ungjill, kushdo mund të përparojë. Është veçse një çështje e të kuptuarit të fuqisë së vërtetë të Shpëtimtarit e të Shlyerjes së Tij dhe të ndërmarrjes së hapave për të ardhur tek Ai.

Unë do t'i jem përjetësisht mirënjohës bashkëshortes dhe fëmijëve të mi dhe të gjithë mësuesve besnikë të shtëpisë, udhëheqësve të kuorumeve, peshkopëve dhe shenjtorëve të tjerë besnikë, të cilët dhanë një shembull kaq të mrekullueshëm për mua. Kam pasur privilegjin t'u shërbej Zotit dhe shenjtorëve këta 20 vitet e fundit. Jeta ime është bekuar përtej gjithçkaje që mund ta kisha përfytyruar. ■

Autori jeton në Illinois, SHBA.

PËRKTHIMI I SHKRIMEVE TË SHENJTA:

NË Gjuhën E Zemrës Sonë

Kjo përvojë është e shumënjohur për ata që janë përfshirë në përkthimin e shkrimeve të shenjta nga anglishtja në gjuhë të tjera. Ka ndodhur herë pas here:

Një i ri nga Armenia, duke mbajtur një kopje të Librit të Mormonit që vetëm kohët e fundit u përkthye në gjuhën e tij, i afrohet një anëtari të grupit që ndihmoi me përkthimin: “Faleminderit”, thotë ai. “Unë e kam lexuar Librin e Mormonit në gjuhën angleze. E kam lexuar Librin e Mormonit në gjuhën ruse. E kam lexuar në gjuhën ukrainase. Por derisa isha në gjendje ta lexoja në armenisht, nuk e kuptova vërtet atë. Kur e lexova në gjuhën armene, ai më së fundi pati kuptim. Ishte sikur të kthehesha në shtëpi.”

Kthimi në Shtëpi

Nëse ungjilli i Jezu Krishtit është shtëpia jonë shpirtërore, atëherë është vërtet e drejtë që ai të ndihet i rehatshëm dhe i njohur. Në shtëpi gjejmë prehje. E ushqejmë shpirtërisht veten tonë. Flasin me ata që i duam në gjuhën e mësuar të ulur pranë nënës sonë. Kjo është gjuha e zemrës sonë dhe përderisa zemra është vendi ku ungjilli duhet të arrijë, leximi i shkrimeve të shenjta në gjuhën e zemrës sonë është jetik.

Doktrina e Besëlidhje e sugjeron këtë gjë. Atje Zoti zbulon që, nëpërmjet çelësave të priftërisë, të mbajtura nga Presidenca e Parë, “krahu i Zotit do të zbulohet në fuqi për t’i bindur kombet . . . për ungjillin e shpëtimit të tyre.

Sepse do të ndodhë në atë ditë, që çdo njeri do ta dëgjojë plotësinë e ungjillit në gjuhën e tij dhe në të folurën e tij,

PËRVOJA TË PANUMËRTA TREGOJNË DORËN E ZOTIT NË PUNËN E PËRKTHIMIT TË SHKRIMEVE TË TIJ TË SHENJTA.

Nga R. Val Xhonson
Revistat e Kishës





*Shkrimet e shenjta
e prekin zemrën
më fuqishëm kur
lexohen në gjuhën
tonë amtare - gju-
hën e zemrës sonë.*



Libri i Mormonit i plotë është botuar në 89 gjuhë dhe pjesë të zgjedhura të tij janë përkthyer në 21 gjuhë të tjera.

nëpërmjet atyre që shugurohen në këtë fuqi, me anë të administrimit të Ngu-shëlluesit, të derdhur mbi ta për zbulesën e Jezu Krishtit” (DeB 90:10–11).

Xhim Xhulli, i cili punoi në ekipin e përkthimit të shkrimeve të shenja në zyrat qendrore të Kishës, tregon një histori se sa pranë shtëpisë mund të vijë shkrimet e shenja kur ato përkthehen në gjuhën e zemrës:

“Në përkthimin e Librit të Mormonit në gjuhën sesoto, gjuha e folur nga kombi afrikan i Lesotos, na nevojitej të gjenim dikë për të na ndihmuar që të vlerësohej puna e ekipit të përkthimit. Mbikëqyrësi i projektit, Leri Foli, gjeti një anëtare të Kishës nga Lesoto, e cila ishte një studente pasuniversitare tek Universiteti Shtetëror i Jutës. Në Lesoto, arsimimi kryhet në anglisht, kështu që kjo zonjë dhe fëmijët e saj kishin studiuar në anglisht që nga klasa e parë e në vazhdim, por ata ende bisedonin në shtëpi në gjuhën sesoto.

Ajo ra dakord të punonte me përkthimin. Vlerësimi i saj për kapitujt që i dërguam asaj, ishte me të vërtetë i dobishëm. Në mënyrë të përsëritur, ne i drejtuam pyetje të veçanta lidhur me fjalorin dhe strukturën gjuhësore, për të cilat ajo na dha shpjegime të dobishme. Megjithatë, ne vumë re që ajo kishte shenjuar me ngjyrë të verdhë shumë vargje që nuk kishin lidhje me pyetjet tona. Kur e pyetëm për vargjet e shenjara, ajo tha: ‘O, ato janë vargje që ma prekën zemrën thellësisht, të cilat nuk i kisha kuptuar kurrë tërësisht në anglisht.

I shenjova me qëllim që të mund t’i lexoja ato me fëmijët e mi.”

Një Model për Përkthimin e Shkrimeve të Shenjta

Përkthimi i Biblës ka një histori të gjatë dhe të mahnitshme, duke filluar me përkthimin e pjesëve të Dhiatës së Vjetër nga hebraishtja në greqisht. Më vonë, Bibla u përkthye nga greqishtja në latinisht dhe nga latinishtja, hebraishtja e greqishtja në anglisht dhe në

një mori gjuhësh të tjera.¹ Si rrjedhim, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nuk e përkthen Biblën në gjuhë të ndryshme, por përvetëson variante tashmë të pranuar si variante të autorizuara nga të krishterët që i flasin ato gjuhë.²

Shumica e punës së përkthimit të shkrimeve të shenja që bën Kisha, si rrjedhojë, është për Librin e Mormonit (i pari që përkthehet), Doktrinën e Besëlidhjet dhe Perlën me Vlerë të

“SEPSE DO TË NDODHË . . . QË ÇDO NJERI DO TA DËGJOJË PLOTËSINË E UNGJILLIT NË GJUHËN E TIJ DHE NË TË FOLURËN E TIJ, NËPËRMJET ATYRE QË SHUGUROHEN NË KËTË FUQI” (DEB 90:11).



PROCESI I PËRKTHIMIT TË SHKRIMEVE TË SHENJTA

Miratimi për të Përkthyer

- Përkthimi i shkrimeve të shenjta kërkohet nga Presidenca e Zonës kur numri i anëtarëve të Kishës, të cilët e flasin gjuhën, po rritet dhe kur materialet bazë të Kishës janë përkthyer në atë gjuhë.
- Kërkesa shqyrtohet nga disa komitete në zyrat qendrore të Kishës, duke përfshirë anëtarë të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe Presidencën e Parë.

Fazat e Përkthimit

Faza paraprëse:

- Një përkthim ekzistues i Biblës përzgjidhet për përdorimin e Kishës.
- Së pari përkthehen materialet bazë: *Bazat e Ungjillit* (përfshin doktrina bazë, si edhe emrin e Kishës, lutjet e sakramentit, lutjen e pagëzimit dhe Nenet e Besimit), broshurën *Dëshmia e Profetit Jozef Smith* dhe një faqe interneti në LDS.org.
- Biseda të konferencave të përgjithshme gjithashtu mund të interpretohen në atë gjuhë.

Faza 1:

- Libri i Mormonit, Doktrina e Besëlidhje, Perla me Vlerë të Madhe (gati 10 vjet punë).
- Tekstet themeltare, të tilla si "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës", "Krishti i Gjallë: Dëshmia e Apostujve", himne të përzgjedhura dhe manuali *Predikoni Ungjillin Tim*.



Madhe. Gjuha nga e cila përkthehen këta libra, është anglishtja, gjuha në të cilën Profeti Jozef Smith i zbuloi ato, gjuha e zemrës së tij. Procesi i përdorur për t'i përkthyer shkrimet e shenjta në gjuhët joangleze duhet të jetë i shumënjuhohur për studentët e historisë së Kishës. Është pak a shumë i njëjti proces që Profeti përdori për të përkthyer Librin e Mormonit në anglisht.

Jozef Smithi ishte një djalë ferme, i përlurur dhe kryesisht i paarsimuar. Por ai i kishte cilësitë dhe potencialin që i nevojiteshin Zotit për punën që duhej të bëhej. Në të vërtetë, Jozefi dhe familja e tij u përgatitën dhe u vendosën në atë vend për të bërë pikërisht këtë punë.³

Jozefit gjithashtu iu dha ndihmë – si hyjnore ashtu edhe njerëzore – për përkthimin e analeve nefite. Engjëlli Moroni e vizitoi Jozefin çdo vit për katër vjet përpara se ta lejonte atë që të merrte analin. Ne nuk e dimë gjithçka që Moroni ia mësoi Profetit, por vizitat e tij duket se e përgatitën atë shpirtërisht dhe mendërisht për detyrën që shtrihej përpara.⁴

Zoti gjithashtu përgatiti "interpretues" përpara kohe, si një mjet për të përkthyer një gjuhë të humbur. Të përshkruar si dy gurë të tejudkshëm, të lidhur në skaje metalike, këta dhe një mjet i ngjashëm, i quajtur një gur shikues, e ndihmuan Profetin që ta përkthente analin nefit në gjuhën angleze. Profeti nuk dha hollësi për procesin; ai thjesht dëshmoi se e

përktheu Librin e Mormonit me anë të "dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë"⁵.

Përveç ndihmesës hyjnore që iu dha atij, Jozefi kishte ndihmë njerëzore në formën e shkruarve, të cilët prodhuan kopjen e shkruar që të tjerët më së fundi i radhitën, i shtypën, paguan për to dhe ia shpërndanë botës.

Aspak ndryshe nga përgatitja dhe ndihma që mori Jozefi në punën e tij të përkthimit, ata njerëz, të cilëve iu caktohet detyra e përkthimit të shkrimeve të shenjta sot, përgatiten nga Zoti dhe atyre iu jepet ndihmë në punën e tyre – si hyjnore ashtu edhe njerëzore.

Një Punë Zbulesë

Në procesin e përkthimit të saktë ndikon një energji shpirtërore ndoshta e përshkruar më mirë si "zbulesa me anë të këshillit". Dy ose tre njerëz, të cilët zgjidhen si përkthyes, bashkohen me njerëz të tjerë në kryerjen e punës. Ata kanë mbikëqyrës të zyrave qendrore të Kishës, redaktorët vendorë, një leksikon për referenca⁶, udhëzuesit e përkthimit, programet kompjuterike dhe mbështetjen kishtarë që shtrihet në të gjitha hapat deri te Presidenca e Parë. (Shih tabelën shoqëruese.) Kur Presidenca e Parë jep miratimin përfundimtar të një përkthimi, vepra dërgohet më pas për t'u radhitur, shtypur e shpërndarë. Pasi të jetë përgatitur në një format dixhital, ajo gjithashtu vendoset në LDS.org dhe në programin Biblioteka e Ungjillit.

Kjo përpjekje bashkëpunuese është e madhe si edhe e frymëzuar.



Ajo përfshin vëmendje të përkushtuar te cilësia e përmbajtjes dhe cilësia e formës fizike në të cilën ajo dorëzohet. Përkthimet rishikohen në shumë nivele, veçanërisht në nivelin kishtar që kërkon miratimin e Zotit. Vetëm kur ai miratim jepet, një përkthim vihet në lëvizje. Edhe pse jo pikërisht nëpërmjet zbulësës, si mënyra që Profeti Jozef Smith e përktheu Librin e Mormonit, procesi udhëhiqet në mënyrë të qartë nga Zoti – me anë të dhuratave të Tij dhe me anë të fuqisë së Tij.

Kjo nuk do të thotë që një përkthim është i përsosur kur sapo përfundohet. Shpesh, koha dhe rishikimet e mëtejshme nga ata që i studiojnë shkrimet e shenjta, sugjerojnë përmirësime në gramatikë dhe fjalor apo gjejnë gabime të radhitjes ose të germëzimit. Rrallëherë, bëhen ndryshime në shpjegimin e doktrinës. Kur këto bëhen, ato bëhen nën udhëzimin e Presidencës së Parë.

Zoti Siguron

Zoti e përkrah këtë vepër të përkthimit edhe në mënyra të tjera. Zakonisht raportohet nga grupi i përkthimit në zyrat qendrore të Kishës që, kur del një nevojë, Zoti siguron.

Si një nga shembujt e shumtë, nevojitej një përkthyes për përkthimin dhe regjistrimin e materialeve të Kishës në gjuhën mam (një gjuhë e prejardhur nga gjuha e fiseve maja, e folur në Guatemalë). Mes misionarëve të parë, të thirrur në Guatemalë,

ishite një misionar gjyshi i të cilit e kishte folur gjuhën mam. Misionari ishte rritur në qytet dhe fliste vetëm spanjisht. Por çdo natë gjyshi do t'i dilte atij në ëndërr dhe do t'i mësonte gjuhën mam. Ky misionar i ri u bë përkthyesi kryesor i mamishtes në Kishë.

Shpesh, puna e përkthimit bëhet me sakrificë të mëdha vetjake. Në varësi të situatave financiare, disa përkthyes e dhurojnë shërbimin e tyre dhe të tjerë paguhet që të mund të kenë kohë për t'ia përkushtuar përkthimit.

Burri që u bë një nga përkthyesit në gjuhën urdu, u kthye në besimin në Kishë në Pakistan teksa punonte si mësues. Si rrjedhojë e kthimit të tij në besim, ai e humbi punën e tij; humbi shtëpinë e tij, e cila i ishte siguruar nga shkolla ku jepte mësim; dhe ai e humbi shkollimin për fëmijët e vet. Një mbikëqyrës i përkthimeve të Kishës iu afrua atij rreth shërbimit si përkthyes dhe i ofroi atij një shpërblësë modeste. Pasi punoi si përkthyes për pak muaj, burri u takua me mbikëqyrësin dhe me druajtje pyeti nëse mbikëqyrësi do t'i blinte atij një stilolaps të ri. Stilolapsit që ai kishte qenë duke e përdorur, i ishte mbaruar boja. Vetëm atëherë mbikëqyrësi zbuloi dhe ndreqi një gabim nga zyra, i cili kishte bërë që përkthyesi të merrte shumë më pak nga ajo që duhej të ishte paguar.

Por po ashtu si Zoti e bekoi Jozef Smithin në mënyra që e mundësuan atë ta përfundonte punën e tij, Zoti i

Faza 2:

- Materiale të tjera të shumta mund të kërkohen, të tilla si revista *Liahona*, manualët e seminarit dhe institutit, manuale për mësimet e së dielës, himne dhe këngë të fëmijëve, materiale të tempullit dhe të historisë familjare, si edhe interpretimi i transmetimeve për kunjët dhe krahinat.

Grupe Bashkëpunimi Kyç

Ekipi i përkthimit:

- Dy ose tre anëtarë të Kishës, të denjë për tempullin, me pjekurinë e duhur për ungjillin.
- Të ndihmuar nga një udhëzues përkthimi varg-pas-vargu, një leksikon dhe një mbikëqyrës për përkthimin nga zyrat qendrore të Kishës.

Komiteti i rishikimit kishtar:

- Tre deri në pesë burra e gra që janë udhëheqës të Kishës në atë zonë.
- Të thirrur dhe të veçuar për të ndihmuar në rishikimin e përkthimit për lexueshmëri dhe saktësi doktrinoe.
- Ndryshime të fjalëve nuk bëhen derisa komiteti të bjerë dakord njëzëri dhe ndryshimet të jenë në përputhje me udhëzuesin e përkthimit.

Rishikuesit anëtarë:

- Anëtarë vendorë të Kishës gjithashtu e rishikojnë përkthimin.
- Ata japin përshtypje për qartësinë dhe përshtatshmërinë e fjalëve të përdorura.
- Qartësia e përkthimit siguron që Fryma e Shenjtë mund të japë dëshmi për të vërtetën e mësimëve të dhëna.

Procesi i përkthimit të shkrimeve të shenjta përfshin si kokën ashtu edhe zemrën, si aftësinë mendore ashtu edhe largpamësinë shpirtërore.

bekon përkthyesit e Tij. Për shembull, përkthyesi i shkrimeve të shenjta në letonisht ishte një avokat që kishte studiuar për juridik në Rusi, ku ai ishte kthyer në besim tek ungjilli i rivendosi. I kthyer në Letoni, ai po përpiquej të ngrinte biznesin e tij. Ai gjithashtu po shërbente si president dege. Ai kishte qenë shumë i zënë me punë, por Kisha kishte nevojë për të dhe aftësinë e tij me anglishten.

Ai kërkoi kohë që të lutej rreth kërkesës, sepse po ta pranonte atë, sikurse i tha ai përfaqësuesit të Kishës, do t'ua "hliqte" fëmijëve të [tij] kafshatën nga goja". Pasi u lut, ai vendosi ta pranonte, por i kërkoi Zotit ta bekonte atë me mjetet për të bërë atë që është një punë e vështirë, me përgjegjësi nga ana shpirtërore dhe që kërkon kohë.

Filloi të shkonte në zyrën e tij avokatore një orë më herët çdo ditë dhe

e përdori atë orë për të përkthyer Librin e Mormonit. Ai e përfundoi shumë më përpara pesë vjetëve që procesi kërkon zakonisht. Në fakt, ky ishte një nga përkthimet më të shpejta që nga koha kur Jozefi e përktheu Librin e Mormonit në gati 60 ditë.

Shumë më tepër përvoja mund të tregohen që vënë në dukje dorën e Zotit në punën e përkthimit të shkrimeve të Tij të shenjta. Ato të gjitha shpallin qartësisht që kjo është puna e Tij dhe se Ai përkujdeset thellësisht për të. Ai i përgatit njerëzit për ta kryer punën e Tij. Ai përgatit mjetet që iu nevojiten atyre për ta përshejtuar punën. Dhe Ai i frymëzon dhe i bekon ata përgjatë udhës.

Rezultati është një botë e pasuruar nga fjala e Perëndisë, e dhënë fëmijëve të Tij në gjuhën e zemrës. ■

NË PUNËN E PËRKTHIMIT TË SHKRIMEVE TË SHENJTA TË ZOTIT ËSHTË E QARTË QË KJO ËSHTË PUNA E TIJ. AI I PËRGATIT NJERËZIT ME MJETET QË IU NEVOJITEN PËR TA PËRSHEJTUAR PUNËN DHE AI I FRYMËZON E I BEKON ATA PËRGJATË UDHËS.

SHËNIME

1. Shih serinë me tetë pjesë, "How the Bible Came to Be", nga Lenet H. Read të botuar në *Ensign* midis janarit dhe shtatorit të vitit 1982.
2. Shih, për shembull, "Church Edition of Spanish Bible Now Published", mormon-newsroom.org.
3. Shih Matthew S. Holland, "The Path to Palmyra", *Liahona*, qershor 2015, f. 14–19.
4. Shih Kent P. Jackson, "Moroni's Message to Joseph Smith", *Ensign*, gusht 1990, f. 12–16.
5. Jozef Smith, në parathënien e Librit të Mormonit. Për një përshkrim të zgjeruar të përkthimit prej Jozef Smithit të Librit të Mormonit, shih Gospel Topics, "Book of Mormon Translation", topics.lds.org.
6. Leksikoni përkufizon çdo fjalë në shkrimet e shenjta në anglisht, kështu që përkthyesit mund ta kuptojnë më mirë kuptimin e fjalëve. Shpesh, fjalët kanë më shumë se një kuptim, kështu që përkthyesit duhet të mbështeten te konteksti, frymëzimi dhe puna si ekip për të përcaktuar zgjidhjen e duhur. Me raste, pyetjet rreth kuptimit zgjidhen vetëm nga Presidenca e Parë.





**Nga Presidenti
Rasëll M. Nelson,**
President i Kuorumit
të Dymbëdhjetë
Apostujve

Një nga mënyrat më të mira për çiftet në moshë që të krijojnë kujtime të madhërishme, është që të shërbejnë në një mision së bashku.

ÇASTE TË Misionarëve në Moshë

Kur miqtë tanë që janë 60 ose 70 vjeç, harrojnë diçka, ne shpesh me shaka i drejtohem i ndërprerjes në kujtesë si një “çast pleqërie”. Por do të doja të diskutoja një lloj tjetër të çastit të pleqërisë – një çasti kaq të madhërishëm sa kujtesa për të do të jetë e përhershme. Është çasti kur një çift misionar në moshë e kupton se ata po bëjnë pikërisht atë që Zoti do donte që ata të bënin. Në çaste të tilla të paharrueshme ata kuptojnë që:

- Ata kanë një jetë të tërë përvojë për ta ndarë dhe talente, aftësi e kuptueshmëri të ungjillit që mund t'i përdorin për të bekuar të tjerët.
- Shembulli i tyre është një bekim për fëmijët e tyre dhe për fëmijët e fëmijëve të tyre.
- Teksa shërbejnë, ata po krijojnë miqësi të qëndrueshme.
- Martesa e tyre po bëhet më e fortë çdo ditë.
- Shërbimi në emrin e Tij, është i ëmbël.

Çaste në Krijim

Miqtë e mi që jeni çifte në moshë, çaste të tilla duhet të jenë në krijim e sipër për shumë prej jush. Merrni parasysh ngjarjen e treguar nga Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, rreth asaj që ishte në gjendje të bënte një çift në moshë që po shërbente në Kili. Prindi i njërit prej misionarëve të rinj vdiq. Presidenti i misionit ishte mjaft larg sa nuk mund të arrinte te misionari me të shpejtë.

“Por ndodhej një çift misionar i dashur, [i pjekur], që shërbente në zonë”, thotë Plaku Holland. “Ata erdhën dhe u ulën me atë misionar dhe plot dhembshuri u përkujdesën

për të dhe e ngushëlluan derisa presidenti i misionit mundi të takohej vetë me të. Ne kishim misionarë të rinj shumë të mirë në misionet tona, por asnjë misionar i ri beqar nuk mund të kishte bërë për atë misionar çfarë ishte në gjendje të bënte ai çift.”¹

Aftësia e tyre në atë çast ishte thjesht të përçonin dhembshuri në një kohë nevoje. Ata nuk shqetësoheshin rreth të folurit të ndonjë gjuhe tjetër përveç gjuhës së dashurisë si ajo e Krishtit. Ata nuk shqetësoheshin rreth mungesës në ditëlindjen e një nipi ose mbesë, apo mungesës në bekimin e një foshnjeje, sado të rëndësishme mund të jenë këto ngjarje. Ata shqetësoheshin rreth të qenit atje ku Zoti mund t'i përdorte për ta bekuar jetën e njërit prej fëmijëve të Tij. Dhe ngaqë ata ishin të gatshëm, Ai ishte në gjendje t'i lejonte që ta përfaqësonin Atë.

Shërbimi Është Rrallë i Volitshëm

E vërteta është, asnjë misionar në moshë nuk e sheh të volitshme që të largohet nga shtëpia. As nuk e panë të volitshme Jozef Smithi, Brigam Jangu, Xhon Tejlari apo Uillford Udrafi. Edhe ata kishin fëmijë dhe nipër e mbesa, dhe i donin familjet e tyre po ashtu siç i duam ne. Por gjithashtu e donin Zotin dhe dëshironin t'i shërbenin Atij. Një ditë ne mund t'i takojmë këta njerëz të papërtuar, të cilët ndihmuan në themelimin e kësaj periudhe të kujdestarisë ungjillore. Kur t'i takojmë, ata do të gëzohen që ne nuk kërkuam rehatinë kur do të duhej të kishim shërbyer.

Disa njerëz mund të parapëlqejnë të shërbejnë ndërkohë që ende jetojnë në shtëpi. Pasi një hemorragji cerebrale e la Ejsa Shumejkër Nelsonin (nuk ka lidhje me Presidentin

Nelson) të kufizuar në një karrige invalidi, ajo pati frikë se dëshira e saj e të gjithë jetës për të shkuar në mision me bashkëshortin e saj, Donin, nuk do të përmbushesh. Më pas një fqinj u foli atyre rreth misionit të tij në Kishë të shërbimit të një shtëpi e ruajtjes për peshkopin. Të mbushur me kurajë, ata folën me një mbikëqyrës të shtëpia e ruajtjes, plotësuan formularët e tyre të rekomandimit dhe u thirrën të shërbenin për dy ditë në javë të një shtëpi ruajtjeje pranë shtëpisë së tyre.

“Është e lehtë të shtrihesh e të mendosh: ‘O, unë nuk jam më e nevojshme’”, thotë Ejsa Nelson. “Por tani ndiej që *jam* e nevojshme. Dhe kjo ka qenë një dëshmi për mua.”

Ju Jeni Patjetër të Nevojshëm

Nëse tundoheni të mendoni se nuk jeni të nevojshëm, më lejoni t’ju siguroj sërish se ju jeni të nevojshëm. Nuk ka asnjë president misioni në Kishë që nuk do të donte të kishte çifte shtesë duke shërbyer në misionin e tij. Misionarët në moshë i forcojnë misionarët dhe misionaret e reja. Ata sigurojnë mbështetje që i ndihmon të tjerët për të shërbyer më mirë në vetë përgjegjësitë e tyre. Dhe a mund të përfytyroni se çfarë do të thotë për një udhëheqës, i cili ka qenë anëtar vetëm për disa vjet, që të ketë ndihmën e gatshme të anëtarëve me përvojë të Kishës? Çiftet në moshë shpesh janë një përgjigje e mirëfilltë ndaj lutjeve të peshkopëve dhe presidentëve të degëve.

Ne i nxitim presidentët e misioneve për të kërkuar çifte që përmbushin nevoja, në misionet e tyre. Peshkopët duhet të kërkojnë çifte që mund të shërbejnë. LDS.org rendit faqe të tëra mundësish për çiftet në moshë. Por më e rëndësishmja, çiftet mund të bien në gjunjë dhe t’i kërkojnë Atit Qiellor nëse koha ka ardhur për ta që të shërbejnë në një mision së bashku. Nga të gjitha kualifikimet, *dëshira*



Një çift në Seul të Koresë së Jugut shijon ëmbëlsinë e të shërbyerit së bashku.

për të shërbyer mund të jetë kualifikimi më i rëndësishëm (shih DeB 4:3).

Teksa e lëvdoj punën e misionarëve në moshë, unë e kuptoj se ka shumë njerëz që do të donin të shërbenin, por janë të paafte për ta bërë këtë gjë. Kufizimet e vendosura nga moshja ose shëndeti jo i mirë meritojnë një vlerësim realist, sikurse e meritojnë nevojat e rëndësishme të anëtarëve të familjes. Kur dëshira digjet përbrenda edhe pse ekzistojnë kufizime të tilla, njerëz të tjerë mund të jenë krahët e këmbët tuaja dhe ju mund të jepni fondet e nevojshme.

Çifte në moshë, pavarësisht se cilët jeni apo ku jeni, ju lutem, lutuni rreth kësaj mundësie për të krijuar së bashku çaste të madhërishme të misionarëve në moshë. Ati Qiellor do t’ju ndihmojë të dini se çfarë mund të bëni. ■

SHËNIM

1. Jeffrey R. Holland në Joseph Walker, “Elder Jeffrey Holland: LDS Church Desperately Needs More Senior Missionaries”, *Deseret News*, 14 shtator 2011, f. 3.



Në krye: Çifti Malmroz takohet rregullisht me Presidentin Robison për të diskutuar se si t'i përdorin talentet e tyre ndërsa u shërbejnë të tjerëve. Lart: Misionarë të rinj në qendrën e trajnimit në Akra të Ganës thonë që të kesh mbështetjen e Plakut dhe Motrës Malmroz është si të kesh një nënë dhe baba të dytë duke shërbyer përkrah tyre.



NGA SHTËPIA OSE LARG SHTËPISË

Duke shërbyer nga shtëpia ose larg shtëpisë, çiftet misionare në moshë "vijjnë dhe ndihmojnë" në lagje e degë, në zyrat e misioneve, në qendrat e vizitorëve, tempuj, misione në pjesët e varfra të qyteteve, në detyra mjekësore, qendra të burimeve të punësimit, programe për mbështetjen te vetja, programe për shërimin nga varësitë, qendra të historisë familjare, ruajtjen e anave, Sistemin Arsimor të Kishës, në çështjet publike, shërbimet humanitare dhe më tej. Dhe nevojiten çifte gjithnjë e më shumë.



Misionarët në Moshë:

TË NEVOJSHËM,
TË BEKUAR
DHE
TË DASHUR

*Shërbimi si një çift
misionar mund
të jetë më i kollaj-
shëm, më pak i
shtrenjtë dhe më
i gëzueshëm nga
sa e mendoni.*

Nga Riçard M. Romni
Revistat e Kishës

“A MUND TË VINI DHE TË NDIHMONI?”

Kjo është një pyetje së cilës Xherald dhe Lorna Malmrozi nga Uashingtoni në SHBA, i ishin përgjigjur më parë. Ata thanë “po” kur peshkopi i tyre i dikurshëm, në atë kohë një president misioni, i pyeti nëse mund të shërbenin me të në Inditë Perëndimore. Ata thanë “po” përsëri, kur presidenti i tyre i kunjtit i thirri të përmbushnin një mision shërbimi në zyrat qendrore të Kishës në Solt-Lejk-Siti, në Jutë të SHBA-së, duke punuar me kompjuterët dhe burimet njerëzore.

Kur peshkopi i tyre i mëparshëm dhe presidenti i misionit, Rid Robisoni, i mori në telefon sërish, këtë herë si presidenti i qendrës misionare të trajnimit në Akra të Ganës, ai i pyeti nëse çifti Malmroz mund të ndihmonte edhe njëherë tjetër.

“E dinim se mund t’i mirëbesonim Zotit”, thotë Plaku Malmroz. “Kështu vendosëm t’i mirëbesonim Zotit sërish.” Ata thanë po, i plotësuan formularët e rekomandimit, e morën thirrjen e tyre dhe shpejt ishin në Ganë.

Shërbimi si Çift

Përvojat e çiftit Malmroz tregojnë disa parime rreth misionarëve në moshë që shërbejnë misione, të cilat mund të mos kuptohen gjerësisht:

- *Ka dy lloje misionesh:* 1) Presidenti i Kishës thërret çifte në moshë që të shërbejnë nga shtëpia e tyre ose larg prej shtëpisë. 2) Një president kunjti thërret çifte

misionare për shërbim në Kishë për të përmbushur nevoja me kohë të pjesshme, vendore ose krahinore, nga 8 deri në 32 orë në javë. Ata kryesisht jetojnë e shërbejnë në vende pranë shtëpisë, por nganjëherë mund të thirren për të shërbyer larg shtëpisë.

- *Presidentët e misioneve nxiten të gjejnë çifte që mund të plotësojnë nevojat në misionet e tyre dhe çiftet mund t’i tregojnë parapëlqimet e tyre.* “Nuk po themi që çiftet mund të përcaktojnë e zgjedhin detyrat e tyre misionare”, shpjegoi Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. “Një thirrje është ende një thirrje. . . . [Por] ne u flasim çifteve tona në moshë rreth parapëlqimeve të tyre për shërbim dhe bëhet çdo konsideratë për t’i lejuar ata të shërbejnë atje ku dëshirojnë të shërbejnë dhe sipas mënyrës se si duan të shërbejnë.”¹
- *Presidentët e misioneve këshillohen me çiftet rreth mënyrës se si t’i përdorin sa më mirë aftësitë dhe zotësitë e tyre.* “Që të keni përvojën më domethënëse si një çift në moshë”, thotë Presidenti Robison, “ju nevojitet të keni mundësinë për të punuar që të dy në fusha që i keni pasion dhe ku keni një nivel zotësie që ju bën të ndiheni se keni diçka për të ofruar”.

Për shembull, Presidenti Robison e dinte që Plaku Malmroz flet frëngjisht, e dobishme ngaqë shumë afrikanë



VIHUNI NË DISPOZICION

“Ne kemi nevojë për shumë, shumë më tepër çifte në moshë. . . . Vihuni në dispozicion. . . . Janë pak ato kohë të jetës suaj kur do të shijoni [kaq shumë] shpirtin e ëmbël dhe kënaqësinë që vijnë nga dhënia e shërbimit . . . së bashku në veprën e Mësuesit.”

Presidenti Tomas S. Monson, “Ndërsa Prapë Takohemi së Bashku”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 6.



flasin frëngjisht. “E kisha përfytyruar atë të përfshihej me udhëtimet dhe nxjerrjen e vizave”, tha Presidenti Robison. “Por kur ai mbërriti këtu, e ndjeva se ky nuk ishte interesi i tij i vërtetë. Prandaj e ftova të përdorte aftësitë e tij kompjuterike. Na ka kursyer orë të tëra.” Plaku Malmroz gjithashtu ndihmon misionarët, veçanërisht misionarët frëngjishtfolës, përgatit emra dhe bën punë në tempull për familjet e tyre. Motra Malmroz, një ndihmësmjeko e certifikuar, u caktua të punonte me mjekun dhe infermierin e misionit.

Ai e Përgatit Udhën

Sikurse çifti Malmroz, çifte të tjera kanë mësuar që, kur i mirëbesojnë Zotit, Ai e përgatit udhën. Kjo është çfarë ndodhi për Alvin dhe Korason Rietën nga Kauiti në Kavite të Filipineve.

“Dy vjet përpara vendimit tonë për të shërbyer, ne filluam të bënim plane të qëndrueshme për biznesin tonë familjar”, shpjegon Plaku Rieta. “Biri dhe bija jonë ishin diplomuar nga kolegjet dhe mund ta drejtonin biznesin në vendin tonë, por ne pyetnim veten se kush do t’i zgjidhte problemet e biznesit dhe se si do të reagonin klientët tanë ndaj planeve tona.”

Motra Rieta gjithashtu shqetësohej për largimin nga nëna e saj e plakur. “Kisha frikë se ajo mund të vdiste ndërkohë që ishim larg”, thotë ajo. “Gjithashtu u ndjeva e përshtatshme ndaj sfidës për mësimdhënien e ungjillit.”

Ata u këshilluan me peshkopin e tyre dhe me një çift, i cili kohët e fundit kishte shërbyer në Davao. “Ata të gjithë dhanë dëshmi të fuqishme se Zoti do ta drejtojë secilin çift që të dijë se si të merret me çështjet e tyre në shtëpi, në familjen e tyre dhe me fondet për misionin e tyre”, thotë Motra Rieta.

“Teksa kërkua udhërrëfim”, thotë Plaku Rieta, “frika jonë u largua – biznesi ynë

shkoi mirë pavarësisht nga sfidat, klientët tanë shprehën gëzim e mbështetje dhe familja jonë u afrua më pranë së bashku për t’u përkujdesur për nënën tonë të sëmurë. Ne filluam ta kuptonim që Zoti me të vërtetë do të na ndihmonte.”

Çifti Rieta tani po shërben në mbështetjen e anëtarëve dhe të udhëheqësve në Misionin e Filipineve në Kagajan de Oro.

Shumë Gjëra që Mund të Bëni

Disa çifte pyesin veten rreth paaftësive fizike, por jo çifti Kith dhe Xhenilin Mauërmen nga Juta në SHBA. Vite më parë, katër muaj pasi u martuan në Tempullin e Los Anxhelos në Kaliforni, Kithi u thirr në ushtri dhe u dërgua në luftë. Si komandant i një skuadre të paratrupave, ai po ecte përpara ushtarëve të tjerë kur shpërtheu një minë tokësore. I humbi të dyja këmbët. Kur mbërriti në shtëpi, Xhenilini me nxitim u afrua pranë tij.

“E dija që nuk kisha përse të shqetësohesha”, thotë Kithi, “sepse ne kemi një martesë të përjetshme. Gruaja ime më ka përkrahur gjatë gjithë kohës. Ajo ende më mbështet çdo ditë.”

Kur Motra Mauërmen doli në pension, ata vendosën të shërbenin në një mision. Por a do të shkaktonte problem fakti që Plakut Mauërmen i mungonin të dyja këmbët? “Ka gjithmonë gjëra që *nuk mund* t’i bëj”, thotë ai, “por ka shumë gjëra që *mund* t’i bëj, prandaj e dinim se do të kishte një vend për ne”.

Teksa i mbushnin formularët e rekomandimit të tyre, ai shënoi një kuti ku tregohej se kishte shërbyer në ushtri. Shpejt ata morën një telefonatë nga sektori i Marrëdhënieve Ushtarake të Kishës. “Unë kisha një kartë identiteti që do të na lejonte të hynim në baza ushtarake, prandaj ata na kërkuan lejen tonë që të na rekomandonin për një mision në marrëdhëniet ushtarake.”

Çifti Mauërmen u thirr të shërbente në një bazë ushtarake në Karolinën e Veriut në SHBA. Plaku Mauërmen sjell ndërmend:

“Shenja te porta thoshte ‘Fortesa Brag, Shtëpia e Paratrupave’. Kur roja na përshëndeti me moton e paratrupave ‘Gjer në Fund!’ ishte hera e parë që e kisha dëgjuar atë pas shumë vitesh. U ndjeva si në shtëpi, edhe pse nuk kisha qenë kurrë në Fortesën Brag. E dija që thirrja jonë e misionit ishte një zgjedhje e përsosur dhe që Zoti është i vetëdijshëm për mua.”

“Ne dhamë mësim rreth bërjes të mbështetur te vetja dhe bërjes së patundur dhe rreth forcimit të martesës”, thotë Motra Mauërmen. “Fillimisht nuk donim ta tregonim historinë tonë, por mësuam se të treguarit e saj solli shumë ndryshim. Ushtarët dhe bashkëshortet e tyre na shihnin

Plaku Romrell kishte shërbyer në Brazil kur ishte misionar i ri në moshë, ai e kishte lënë pas dore gjuhën portugeze. Dhe Motra Romrell nuk dinte portugalisht. Megjithatë, studimi dhe përpjekja ndihmuan për t’i rikthyer aftësitë e Plakut Romrell në portugalisht dhe për ta rritur aftësinë e Motrës Romrell në atë gjuhë. Po ashtu i ndihmoi edhe një kitarë e vogël havajane.

“Në të vërtetë s’kisha në plan ta sillja atë”, thotë Motra Romrell, “por Plaku Romrell pati frymëzim që ta sillnim dhe është e mahnitshme kur shohim se çfarë ka bërë ajo. Teksa u japim mësim kërkuesve dhe punojmë për riaktivizimin dhe shoqërimin e anëtarëve, është e hareshme ta përdorim



Pasi i kapërcyen shqetësimet financiare, Plaku dhe Motra Rieta shërbejnë në atdheun e tyre, në Filipine.



Për çiftin Mauërmen, shërbimi në marrëdhëniet ushtarake është një vend i përkryer. “Është sikur të ktheheshim në shtëpi”, thonë ata.



Të frymëzuar për të sjellë me vete një kitarë havajane, çifti Romrell e përdor atë për të ndarë gjuhën mbarëbotërore të muzikës, teksa vizitojnë familjet dhe këndojnë himne.

dhe thoshin: ‘Nëse ju mund t’ia dilni mbanë, ne mund t’ia dalim mbanë gjithashtu’.”

Çifti Mauërmen pati një përvojë kaq të kënaqshme në Karolinën e Veriut sa ata kërkuan të shërbenin sërish. Sot ata udhëtojnë rreth 64 kilometra nga shtëpia e tyre në Orem për në Solt-Lejk-Siti dy herë në javë që të shërbejnë në zyrën e Marrëdhënieve Ushtarake të Kishës. Ata gjithashtu u japin mësim çifteve në moshë në qendrën e trajnimit misionar në Provo, ku shohin se pothuajse çdo grup përfshin dikë që ka kapërcyer pengesa me qëllim që të shërbejë.

Gjuhët Mbarëbotërore

Të thirrur në Misionin e Brazilit në Kuiabá, Rendi dhe Lu Ellën Romrelli nga Juta ishin të shqetësuar. Edhe pse

atë që t’i bëjmë njerëzit të këndojnë himne. Ne mësojmë gjuhën dhe himnet sjellin një shpirt të fortë me vete.”

Edhe pse aftësitë e saj në portugalisht janë ende duke u zhvilluar, ajo tashmë e flet rrjedhshëm gjuhën e muzikës. “Muzika i sjell njerëzit së bashku”, thotë ajo. “Edhe nëse nuk mund të kuptoj gjithçka që thonë gjatë një vizite, kur këndojmë, ne lidhemi së bashku.” Të ftuar të flisnin në shkollë rreth festës amerikane të Ditës së Falënderimeve, çifti Romrell këndoi himne mirënjohjeje – të shoqëruara nga kitara havajane. Dhe Motra Romrell gjithashtu përdor një vegël më tradicionale, pianon, për të shoqëruar himne në kishë.

Dhe portugalishtja? “Edhe nëse nuk e flet rrjedhshëm, të mësuarit e vetëm pak fjalëve ndihmon”, thotë ajo. “Thjesht të thuash ngjatjete dhe t’i përshëndetësh njerëzit luajnë një rol të madh. Bëjuani atyre të ditur se po mësoni. Bëjeni të



“ÇFAR’ TI DO QË TË JEM”

“Kur mendoj për nevojën e madhe për misionarë në moshë, unë gjithmonë mendoj për atë himn të dashur ‘Do Shkoj Ku Ti Do që të Shkoj’ (*Himne*, nr. 173) dhe mesazhin e tij, ‘Do jem çfar’ Ti do që të jem’.”

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.



NEVOJITEN ÇIFTE

“Mesazhi ynë drejtuar të gjitha çifteve tona në moshë është i thjeshtë: na nevojiteni shumë. Ne po bëjmë gjithçka mundemi që ta bëjmë sa më të volitshme që është e mundur për ju që të shkoni. . . . Koha po e kërkon këtë. Ka shumë njerëz që kanë nevojë për ju. Ju lutemi – shkoni.”

Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, *Deseret News*, 14 shtator 2011.

thjeshtë dhe mbështetuni te Shpirti.” Dhe Shpirti, sigurisht, është një gjuhë tjetër që çdo njeri mund ta përdorë.

Shërbimi në Shtëpi

Pol dhe Mar Xhin Ljuisi nga Juta kishin shërbyer tashmë në tri misione së bashku (në Tempullin e Palmirës në Nju-Jork; në Tempullin e Hong-Kongut në Kinë; dhe në Kroaci, Serbi e Slloveni me seminarët dhe institutet). Ata po përgatiteshin të shërbenin në një mision tjetër kur presidenti i tyre i kunjit



Duke shërbyer nga shtëpia, çifti Ljuis gëzohet që arrin të njohë misionarë kohëplotë dhe anëtarë në vetë kunjën e tyre.

janë larguar nga shtegu. T’i shohim ata të kthehen, të marrin ordinancat dhe të shkojnë në tempull është një bekim i mrekullueshëm.”

“Shumë çifte, kur mendojnë rreth shërbimit në një mision, shqetësohen rreth asaj që do të bëjnë me shtëpinë e tyre dhe makinën e tyre, apo rreth asaj që do të humbasin nga familja e tyre”, thotë Plaku Ljuis. “Ne kemi qenë në gjendje të jetojmë në shtëpinë tonë dhe të ngasim makinën tonë. Ne nxitemi që të shkojmë në veprimtari familjare, për aq kohë sa ato nuk ndërhyjnë te përgjegjësitë



Çifti Sorensen u jep fëmijëve të shkollës në Ishujt Kuk gurë të vegjël për t’i kujtuar ata të qëndrojnë “gur të fortë në Krishtin”.

i pyeti: “A do të ishit të gatshëm të shërbenit pikërisht këtu në kunjën tonë, duke mbështetur e përkrahur misionin në të cilin jetojmë?”

“Ishim të rinj këtu, kështu që ajo ishte një mundësi e mrekullueshme”, thotë Motra Ljuis. “Ne shërbejmë me misionarët e rinj dhe misionarët e reja, kemi një bashkëpunim të ngushtë me presidentin e misionit, shkojmë në mbledhjet e distriktit dhe të zonës dhe punojmë me udhëheqësit e misioneve të lagjeve.” Ata gjithashtu vizitojnë kërkuesit dhe ata që janë më pak aktivë.

“Ne kemi takuar njerëz të mrekullueshëm që nuk do t’i kishim njohur ndryshe”, thotë Motra Ljuis, “duke përfshirë disa njerëz që

tona misionare. Dhe madje ishim këtu për lindjen e një nipi.”

Bekimet Familjare

Nga ana tjetër, Xhill dhe Kent Sorenseni, të cilët janë nga i njëjti kunj, thonë se një nga mënyrat më të mira për ta forcuar familjen e tyre ka qenë të shërbejnë larg nga shtëpia. Motra Sorensen thotë: “Njëri nga justifikimet kryesore që japin çiftet për të mos shkuar, është nipërit e mbesat, fëmijët e martuar me probleme, bijat që presin të lindin fëmijë, prindërit e moshuar – e të tjera. Familja është një përparësi dhe ju merr malli çdo ditë. Por të shkuarit në mision dërgon një mesazh të

fuqishëm që edhe puna misionare është e rëndësishme.”

Përveç kësaj, Plaku Sorensen vëren: “Tani ka kaq shumë mënyra për të mbajtur lidhje, saqë mund të lidheni me ta gjatë gjithë kohës”.

Udhëtimi misionar i çiftit Sorensen filloi tre vjet më parë, kur peshkopi i tyre u kërkoi që të mbanin mbrëmje mujore rreth vatrës për çiftet që po mendonin për shërbimin misionar. “Pasi flisnim vazhdimisht rreth tij”, thotë Motra Sorensen, “ne duhej të shkonim vetël!” Ata morën një thirrje për të shërbyer në Ishujt Kuk, ku gjyshërit e Xhillit kishin shërbyer 50 vjet më parë.

Sot, mes detyrave të tjera, atyre iu kërkohet të jenë mësues të klasave të Biblës në shkolla.



Anëmbanë botës, çiftet thonë se përveç dhënies së ndihmës ndaj të tjerëve, shërbimi së bashku e forcon martesën e tyre dhe i sjell ata më pranë Atit Qiellor.

“Ne flasim rreth Krishtit që është shkëmbi”, thotë Plaku Sorensen. “Ne u japim studentëve një gur të vogël dhe i nxitim të qëndrojnë të fortë gur te Krishti. Tani kudo që shkojmë, njerëzit thonë: “Të fortë gur! kur na shohin.”

Ejani dhe Ndhimoni

Nëse po mendoni për një mision kohëplotë ose një mision shërbimi në Kishë, të gjitha këto çifte do t’ju bënin të njëjtën pyetje që Presidenti Robison ia bëri Xherald dhe Lorna Malmrozit: “A mund të vini dhe të ndihmoni?” Dhe ata do t’ju thonë se, pavarësisht nga mënyra se si merrni pjesë, ky premtim është i sigurt: Ju jeni të nevojshëm, ju mund të jepni ndihmesë dhe ju do të bekoheni e do t’ju duan. ■

SHËNIM

1. “Elder Jeffrey Holland: LDS Church Desperately Needs More Senior Missionaries”, *Deseret News*, 14 shtator 2011, deseretnews.com.


SHUMË MËNYRA PËR TË SHËRBYER

Shihni për mundësi të tanishme, dëgjoni prej atyre që po shërbejnë në këtë kohë, dhe gjeni përgjigje për pyetjet te lds.org/callings/missionary.

MË E LEHTË SE ASNJËHERË

Regulloret e ndryshueshme e bëjnë më të lehtë për çiftet që të shërbejnë.

- Çiftet e shërbimit në Kishë mund të jetojnë në shtëpi dhe të shërbejnë në rang vendor.
- Çiftet mund të shërbejnë për 6, 12, 18 ose 23 muaj. Ata mund të shërbejnë jashtë atdheut të tyre për më pak se 18 muaj nëse paguajnë për transportin e tyre.
- Çiftet munden që, me shpenzimet e tyre, të marrin një leje të shkurtër mungese, zakonisht 7 deri në 10 ditë, që të kthehen në shtëpi për një ngjarje të rëndësishme familjare.
- Shpenzimet e banimit kanë një kufi. Çiftet nuk paguajnë më shumë sesa një sasi të caktuar për banim, duke përfshirë qiranë, energjinë, ujin dhe mobilimin e banesës.
- Banimi do të jetë i sigurt dhe i rehatshëm. Zyrat e misioneve ose të zonave sigurojnë banesa që janë të pastra, të mobiluara thjesht dhe ekonomike.
- Oraret janë më pak lodhëse. Çiftet nuk pritët që të ndjekin të njëjtin regjim të orëve të punës dhe veprimtarive sikurse misionarët e rinj beqarë.
- Komunikimi me familjen ndodh më shpesh. Çiftet mund të komunikojnë me familjet e tyre më shpesh nga sa përvijohet për misionarët e rinj beqarë.



KUR
Pornografia
Godet Shtëpinë –
BASHKËSHORTËT DHE
BASHKËSHORTËT QË
të Dyja Palët Kanë
Nevojë për t'u Shëruar

E kam parë vetë se fuqia e Shpëtimtarit për të shëruar mund t'u vijë bashkëshorteve si edhe bashkëshortëve kur bashkëshortët ndeshen me pornografinë.



Nuk jepet emri

Brenda gjashtë muajve të mi të parë si peshkop, pata disa çifte në lagjen time që erdhën tek unë në mirëbesim për të më treguar shqetësimin e bashkëshortit me përdorimin e pornografisë. Në disa raste, bashkëshortja po dridhej nga tronditja që sapo kishte mësuar të fshehtë shkatërruese; bashkëshorte të tjera e kishin ditur prej muajsh ose prej vitesh.

Kam ndier dhembshuri për secilin prej këtyre çifteve dhe e kam ndier fuqinë shëlbuese të Shpëtimtarit teksa

jam këshilluar rregullisht dhe në mënyrë të kujdesshme me secilin prej vëllezërve për t'i ndihmuar ata që të "flak[*in*] zinxhirët . . . që do [t'i] lidh[*in*] shtrëngueshëm" (2 Nefi 9:45).

Ndoshta dhurimet më të mëdha të Shpirtit kanë ardhur, megjithatë, teksa jam takuar me bashkëshortet e tyre. Kam mësuar se, ndërkohë që disa prej plagëve janë të freskëta dhe të tjerat kanë lënë shenja përgjatë viteve të ekspozimit, të gjitha këto motra përballen me një lëndim të thellë shpirtëror, të shkakuar nga pyetje të tilla si: "Çfarë kam bërë për t'i shkakuar atij që të mos tërhiqet fizikisht nga unë?" ose "Përse dëshiron ai ta përfytyrojë veten e tij me dikë tjetër dhe jo me mua?"

Ngaqë është bashkëshorti i cili ka bërë shkelje, është e lehtë për peshkopin që të ndiejë se bashkëshorti ka më shumë nevojë për përdorimin e çelësave që çlirojnë fuqinë shëruese të Shpëtimtarit, por unë kam mësuar se nevoja e bashkëshortes për t'u shëruar nga dhembja dhe tronditja është po aq e madhe sa dhe nevoja e bashkëshortit për t'u shëruar nga mëkati dhe dëshirat e forta, të ngulitura në mendjen e tij.

Në bisedën e tij dhënë nefitëve, profeti Jakob i qortoi burrat për sjelljen e tyre të pabesë ndaj bashkëshorteve të tyre, "shumë nga ndjenjat e të cil[*a*]ve [ishin] jashtëzakonisht të buta dhe të dëlira dhe të brishta para Perëndisë, gjë e cila është e këndshme ndaj Perëndisë" (Jakobi [LiM] 2:7). Ai vazhdoi: "Ju keni thyer zemrat e bashkëshorteve tuaja të buta . . . për shkak të shembujve tuaj të këqij para tyre; dhe ngashërimi i zemrave të tyre ngjitet lart te Perëndia kundër jush" (Jakobi [LiM] 2:35). I kam dëshmuar këto ngashërime vetë. Ato shpesh lindin jo vetëm nga ndjenja e thellë e bashkëshortes për tradhtinë e shkakuar nga përdorimi i pornografisë nga ana e bashkëshortit të saj, por gjithashtu nga fjalët poshtëruese dhe sjellja harbute që shpesh shfaqet si rrjedhojë e ndeshjes së tij të brendshme. Nuk është e pazakontë, në fakt, për një burrë, zakoni i të cilit ka dalë në dritë, që t'ia hedhë fajin bashkëshortes së tij për sjelljen e tij, duke përmendur veprime të ndryshme që ajo ka bërë ose nuk ka arritur t'i bëjë. Fatkeqësisht, gjithashtu nuk është e pazakontë për bashkëshorten që të fillojë t'i përvetësojë dhe madje t'i besojë këto akuzime.

Një çift i tillë u ul në zyrën time vetëm pak ditë pas njoftimit nga bashkëshorti se një zakon i pornografisë e kishte pushtuar atë që nga rinia e tij. Teksa e dëgjonte mësimin e Shoqatës së Ndhmës bazuar në bisedën e Motrës Linda S. Rivs në konferencën e përgjithshme të prillit 2014, “Mbrotja nga Pornografia – një Shtëpi e Përqendruar te Krishti”, bashkëshortja filloi të dallojë në sjelljen kritike të bashkëshortit të saj kundrejt saj shumë prej prirjeve që po përshkruante mësuësja. Pas mësimit, ajo ia drejtoi bashkëshortit të saj pyetjen dhe ai rrëfeu të fshehtë që e kishte mbajtur për kaq shumë kohë. Vetëvlerësimi i saj tashmë i dëmtuar u ndërthur tani me një pakënaqësi therëse. Gjatë mbledhjes së tyre të parë me mua, ata e kishin të vështirë të shihnin se si martesja e tyre mund të vazhdonte. I sigurova se kishte shpresë, u dhashë disa këshilla fillestare dhe më pas i ftova të vinin sërish e të takoheshin me mua në mënyrë individuale.



SI MUND TË NDIHMOJNË UDHËHEQËSIT E PRIFTËRISË

Ndërkohë që udhëheqësit punojnë së bashku me bashkëshortet e anëtarëve që po hasin vështirësi me pornografinë, përpjekjet e tyre për të siguruar që këto bashkëshorte ta ndiejnë se dëgjohen dhe kuptohen, mund të jenë po aq të rëndësishme sa çfarëdo këshille që ata mund të ofrojnë. Merrini parasysh sugjerimet vijuese nga Ministering Resources [Burimet për Shërbesë] (ministering.lds.org):

- Takohuni së bashku rregullisht dhe jepni mbështetje.
- Theksojeni aftësinë e Shpëtimtarit për të siguruar shërim vetjak për bashkëshorten e përdoruesit të pornografisë (shih Alma 7:11 dhe Mateu 11:28–30).
- Kur është e përshtatshme, ftojini individin që të marrë parasysh frekuentimin e një mbledhjeje të një grupi përkrahës nëpërmjet programit të shërimit nga varësia ose të një grupi të ngjashëm përkrahës.

- Ndhimoheni bashkëshortin/en të kuptojë se ai ose ajo mund të marrë frymëzimin e vet për të ditur se si të caktojë kufij të qartë në marrëdhënien e tyre dhe në shtëpi.
- Ndhimoheni bashkëshorten të gjejë një mikeshë të besuar ose një anëtar të familjes, që mund të sigurojë mbështetje domethënëse në mënyrë të vazhdueshme.
- Ndhimoheni individin që përdor pornografi, që të jetë përgjegjës për veprimet e veta dhe mbështeteni bashkëshorten e tij ose bashkëshortin e saj.
- Merrni parasysh ta drejtoni bashkëshorten e përdoruesit të pornografisë për ndihmë ose këshillim të specializuar. Përcaktoni burime vendore që sigurojnë shërbime në përputhje me parimet e ungjillit.



Poshtë: Keri ishte shumë e lënduar kur mësoi për problemin e bashkëshortit të saj me pornografinë, por ajo gjeti shpresë dhe shërim nëpërmjet Jezu Krishtit dhe Shlyerjes së Tij.

Së bashku me lutjet e zjarra që ofrova në përgatitje për ato mbledhje, unë shqyrtova edhe sugjerimet e dhëna të Ministering Resources [Burimet për Shërbesë] në LDS.org, veçanërisht në burimin për përkrahjen e bashkëshorteve të përdoruesve të pornografisë, ku lexova sa vijon: “Shpreheni dashurinë dhe shqetësimin tuaj për të individualisht, si edhe për bashkëshortin e saj. Sqaroheni që ajo nuk është përgjegjëse për përdorimin e pornografisë ose sjelljen e keqe nga ana e bashkëshortit të saj dhe nuk pritët që ajo ta durojë sjelljen keqtrajtuese”.

Kur u takova me këtë motër, ia vura veshin kësaj këshille dhe i shtova asaj sigurinë që veprimet e bashkëshortit të saj nuk kishin aspak të bënin me të, as me diçka që ajo e kishte bërë apo nuk e kishte bërë, por përkundrazi kishin të bënin me vetë shqetësimin e tij të brendshëm. Pashë një valë lehtësimi dhe ngushëllimi të vinte mbi të, ndërkohë që i rrokte këto fjalë dhe ndiente miratimin e Shpirtit se ato vërtet ishin të vërteta. Në fund të intervistës, ajo më pyeti nëse do t'i jepja një bekim priftërie. E kuptova që unë isha i vetmi njeri tek i cili ajo mund të shkonte për një bekim të tillë, pasi ajo dëshironte ta mbante situatën e saj të fshehtë nga familja dhe shoqëria.

Për të ndihmuar me procesin e shërimit, unë e ftova bashkëshortin e saj që të frekuentonte një grup vendor të shenjtorëve të ditëve të mëvonshme për shërimin nga varësia dhe e nxita bashkëshortin e tij që të frekuentonte grupin përkatës për bashkëshortet dhe anëtarët e familjes. Ajo më tregoi për ngushëllimin që ndjeu nga takimi me motra të tjera, të cilat e kuptonin atë që ajo po e vuante dhe shpresën që iu

dha asaj kur pa çifte që ishin endur përmes të njëjtës sprovë dhe ia kishin dalë mbanë të dilnin prej saj së bashku.

Disa muaj kanë kaluar tashmë që nga takimi im i parë me këtë çift dhe dashuria e përkujdesja ime për ta janë rritur si rrjedhojë e ndërveprimeve tona të shumta. Ndërkohë që e pranoj se shtegu i tyre i vazhdueshëm nuk do të jetë pa pengesa, është kënaqësi për mua të mësoj për secilin muaj të mëtejshëm që bashkëshorti i saj e ka mbajtur veten të paprekur nga epshi e pornografia dhe të shoh rritjen e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit të bashkëshortja e tij, gjë e cila është mjaft e dukshme.

Në intervistat e kohëve të fundit me ta, ankthi dhe lotët e takimeve tona të hershme janë zëvendësuar me buzëqeshje të shpeshta dhe madje të qeshura. Por ndoshta rezultati më i madh ka qenë shpresa – shpresa jo vetëm që martesë e tyre të mund të vazhdojë, por edhe që ajo ka mundësinë për t'u bërë diçka e bukur dhe ekzaltuese.

Unë e kuptoj se, për fat të keq, çdo çift nuk e përjeton këtë rezultat të njëjtë. Disa martesë mund të dështojnë kur përdoruesit e pornografisë nuk pranojnë të bëjnë përparim. Megjithatë, pavarësisht nga shtegu që bashkëshorti zgjedh të ndjekë, unë kam mësuar se këshilla për t'u shërbyer bashkëshorteve është e frymëzuar. Shpresoj që asnjë motër në këtë situatë nuk do ta ndiejë ndonjëherë që ajo është lënë pas dore, është keqgjykuar apo keqkuptuar nga peshkopi i saj. Shërbesa e peshkopit është një drejtim kyç nëpërmjet të cilit Shpëtimtari shfaq fuqinë e Tij për ta shëruar tërësisht çdo zemër – edhe ato zemra të cilat janë “të shpuara me plagë të rënda” (Jakobi [LiM] 2:35). ■



KËSHILLË DHE NGUSHËLLIM PËR BASHKËSHORTET

“Ne si udhëheqës jemi gjithashtu shumë të shqetësuar për bashkëshortët dhe familjet e atyre që vuajnë nga varësia e pornografisë. Plaku Riçard G. Skot ka kërkuar: ‘Nëse ju vetë jeni të lirë nga një mëkat i rëndë, mos vuani në mënyrë të panevojshme pasojat e mëkatëve të tjetrit. . . . Ju mund të ndieni dhembshuri. . . . Prapëseprapë, ju nuk duhet të merrni mbi vete ndjenjën e përgjegjësisë për ato veprime.’ Dijeni se nuk jeni vetëm. Ka ndihmë. Janë të disponueshme mbledhjet e shërimit nga varësia për bashkëshortët, përfshirë mbledhjet me telefon, të cilat u mundësojnë bashkëshortëve të telefonojnë në një mbledhje dhe të marrin pjesë nga vetë shtëpitë e tyre.”

Linda S. Rivs, këshilltare e dytë në presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës, “Mbrotja nga Pornografia – një Shtëpi e Përqendruar te Krishti”, *Liahona*, maj 2014, f. 16.

Rojat NË KULLË

“Mbi muret e tua,
o Jeruzalem, kam
vënë roje që nuk do
të heshtin kurrë, as
ditën as natën. Ju që
i kujtoni Zotit premti-
met e tij, mos rri-
ni në heshtje.”

Isaia 62:6.

Rojat

Rojat ishin rojtarë të vendosur mbi një mur ose në një kullë me qëllim që të vëzhgonin ose paralajmëronin për rreziqe që afroreshin nga larg. Ata punësoheshin që të mbronin qytete si edhe vreshta, fusha ose kullota.

Llojet e Kullave

Kullat në muret e qyteteve ndërtoheshin zakonisht te portat ose në qoshet (shih 2 Kronikave 26:9). Si kullat e portave ashtu edhe të qosheve siguronin vendndodhje të ngritura nga të cilat të shiheshin rreziqet që afroreshin dhe të shmange-
shin sulmet e armiqve (shih 2 Kronikave 26:15).

Kullat e kalave ose të kështjellave zakonisht

ishin struktura që qëndronin të lira, të ndërtuara në një vend të lartë ose në vendndodhje të tjera strategjike. Ato nganjëherë ishin mjaft të mëdha aq sa të ishin një vendstrehim përfundimtar për popullsinë e një qyteti të tërë, kur ata të sulmoheshin (shih Gjyqtarëve 9:46–52).

Kullat në vreshta, fusha ose kullota ishin godina të vogla, të ndërtuara për të ndihmuar në mbrojtjen e të lashtave dhe të tufave nga vjedhësit dhe kafshët (shih 2 Kronikave 26:10; Isaia 5:2; 27:3). Shpesh, niveli më i ulët ishte një dhomë ku ruheshin veglat.





DETYRA PËR TË VËZHGUAR

“Përmes shekujve, profetët e kanë përmbushur detyrën e tyre

kur ata i paralajmëruan njerëzit për rreziqet që ishin përpara tyre. Apostujt e Zotit janë në detyrë të vazhdueshme që të vëzhgojnë, paralajmërojnë dhe të kujdesen për të ndihmuar ata që kërkojnë përgjigje për pyetjet e jetës.”

Plaku M. Rusëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Perëndia Është në Timon”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 25.

FAKTE NGA BIBLA



Në Dhiatën e Vjetër, Zoti nganjëherë krahasohet me një kullë kalaje ose kështjelle për strehim (shih Psalmeve 18:2; 61:3; Fjalët e Urta 18:10;

2 Samuel 22:3) dhe profetët nganjëherë krahasohen me rojat (shih Isaia 62:6; Jeremia 6:17; Ezekiel 3:17; 33:7; Osea 9:8; Mikea 7:4).

“Bir njeriu, të kam caktuar si roje për shtëpinë e Izraelit; kur të dëgjosh ndonjë fjalë nga goja ime, do t’i lajmërosh nga ana ime” (Ezekiel 3:17; shih edhe Ezekiel 33:1–7).

Rojat në kullë:

Kanë një largpamje më të madhe. Si shërbëtorët e thirrur dhe të autorizuar të Perëndisë, profetët veçohen nga bota, vijnë më pranë Tij dhe lejohen t’i shohin gjërat nga një këndvështrim më qiellor.

Shohin gjëra që të tjerët nuk mund t’i shohin. “Një shikues mund të dijë për gjërat që janë të shkuara dhe gjithashtu për gjërat që do të ndodhin; dhe nëpërmjet tyre të gjitha gjërat do të zbulohen, ose më mirë, gjërat sekrete do të tregohen dhe gjërat e fshehta do të dalin në dritë dhe gjërat që nuk dihen do të bëhen të ditura nga ata dhe gjithashtu gjërat do të bëhen të njohura nga ata, që përndryshe nuk do të mund të diheshin” (Mosia 8:17).

Janë vigjilentë. Profetët kanë një përgjegjësi solemne për të na paralajmëruar për rreziqet që po vijnë, dhe ata do të vazhdojnë ta bëjnë këtë gjë pavarësisht nga opinioni publik apo prirjet në shoqëri.

Paralajmërojnë për gjërat ndërsa ato janë ende larg. “Një profet e denoncon mëkatin dhe paratregon pasojat e tij. Ai është një predikues i drejtësisë. Me raste, profetët mund të frymëzohen për të parashikuar të ardhmen për të mirën e njerëzimit” (Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Profet”, lds.org/scriptures/gs).

Ofrojnë siguri dhe mbrojtje. Duke ua vënë veshin paralajmërimeve të profetëve, ne mund të gjejmë siguri dhe t’i shmangim fatkeqësitë që mund të bien mbi ne, në mënyrë individuale ose kolektive, në qoftë se nuk bindemi. ■



NJË MUNDËSI E DYTË

Herën e parë që e takova atë, unë po mbaja violinën time.

Duke zvarritur këmbët erdhi pranë meje, ndërsa po ecja për në sallën e drekës, me kutinë e violinës që më godiste këmbën.

“Violina”, tha ai teksa afrohej.

“Po”, thashë unë.


Me të vërtetë kurrë nuk kisha folur me dikë që kishte një paaftësi dhe nuk dija se çfarë tjetër të thoja. Ai më ndoqi deri te tavolina ime dhe u ul pranë meje, duke treguar te kutia e violinës sime.

“Violina”, tha ai përsëri.

Hapa kutinë dhe sytë e tij shndritën. Me shumë ashpërsi, ai i tërhoqi telat. Zemra më rrahu mbyturazi kur përfytyrova një tel duke u këputur nga violina ime dhe me ngadalë e mbylla kutinë. Ai më mbërtheu në një përqa-fim përpara se të largohej.

E pashë shpesh pas kësaj.

“Violina”, tha Uilliami teksa afrohej.



Sa herë që të më shihte, ai do të m'i rrethonte supet me krahët e tij teksa më puthte në majë të kokës.

Për pjesën e mbetur të shkollës së mesme, unë përpiqesha t'i shmangesha atij kur e shihja të vinte. Kur ai më gjente dhe më mbulonte me përqa-fimet dhe të puthurat e tij me pësh-tymë, unë do t'i duroja ato për pak çaste me një buzëqeshje të sforcuar dhe më pas do të largohesha me të shpejtë pa shqiptuar asnjë fjalë.

“O, jo”, pëshpërita kur e pashë atë në koncertin tim të fundit të orkestrës së shkollës së mesme. Pas koncertit, ai dredhoi drejt vendit ku qëndroja me shoqet e mia jashtë sallës së shfaqjeve.

Shoqet e mia qëndruan pas, ndërkohë që ai erdhi drejt meje me një buzëqeshje, me krahë të hapur për një përqa-fim.

“Uilliam!”

U ktheva dhe pashë një grua që vraponte drejt nesh.

“Më vjen keq”, tha ajo, duke i gërshe-tuar krahët e saj me krahët e tij. “Uilli- amit i pëlqen shumë violina. M'u lut shumë që ta sillja në këtë koncert sonte.

Le të shkojmë, zemër.”

Deri në atë çast, nuk e kisha kuptuar që kurrë nuk e kisha ditur as emrin e tij. Isha takuar me

Uilliamin para dy vjetësh, por ka- llova kaq shumë kohë duke iu shmangur atij sa

kurrë nuk e bëra përpjekjen për ta njohur atë vërtet. Teksa e pashë

Uilliamin dhe nënën e tij të largohe- shin, valët e turpit u derdhën mbi mua.

Vite më vonë, pasi isha martuar, unë linda një djalë të vogël, të bukur, me sin- dromën Daun, të cilin e quajtëm Spen- ser. Shpesh i gjeja mendimet e mia duke u kthyer tek Uilliami, ndërkohë që shihja birin tim dhe pyesja veten nëse Spenseri do të kishte përvoja të ngjashme. A do t'i shmangeshin njerëzit atij ngaqë ai puthte shumë ose përqafonte me shumë forcë? A do të ndiheshin të bezdisur bashkë- moshatarët e tij me kufizimet e tij?

Kur Spenseri ishte katër muajsh, e çova te spitali ynë vendor për një vizitë mjekësore. Kur e nxora nga makina, pashë dy njerëz duke dalë nga spitali. Pa u besuar syve, e kuptova se ishte Uilliami me nënën e tij.

“Uilliam!” Thirra kur u afrova më pranë, me zemrën që më rrihte.

“Përsëndetje!” Ai eci me qetësi për- mes vendparkimit, me një buzëqeshje të madhe duke ia ndriçuar fytyrën. E shtriu dorën e tij dhe mbërtheu dorën time në një shtrëngim entuziast të duarve.

“Si je?” E pyeta.

“Violina”, tha ai, me ngazëllimin duke shkëlqyer në sytë e tij.

Violina. Ai më mbante mend gjith- ashtu. “Po”, mezi fola përmes një të qeshure me lot, “unë i bija violinës”.

Teksa flisnim, zemra ime u lartësua në lutje për mëshirat e dhembshura të një Ati të dashur në Qiell, i cili e dinte se sa shumë kisha dëshiruar ta takoja sërish Uilliamin. Jam mirënjohëse që Perëndia më pa mua – një nënë të re në vështirësi, të gjithëpushtuar nga problemet shëndetësore të birit tim dhe e shqetësuar për të ardhmen e tij – dhe më dha një përvojë që më kujtoi se Ai është i vetëdijshëm për ne. ■ Kejli Bollduin, Arizonë, SHBA



Dëgjova që gruaja po vendoste mbi banak atë që dukej si një numër pa mbarim monedhash për të paguar faturën e saj.

SHKO NDIHMOJE ATË

Unë qëndroja në radhë te një stacion karburanti. Përpara meje, një nënë me dy fëmijë të vegjël kërkoi 3 dollarë karburant dhe dy akullore me vanilje.

Që në vështrimin e parë mund ta shihja se ata kishin fare pak. Fëmijët ishin këmbëzbathur dhe të veshur me rroba të rreckosura.

Dëgjova që gruaja po vendoste mbi banak atë që dukej si një numër pa mbarim monedhash për të paguar faturën e saj.

Pasi pagova për benzinën time, dola jashtë dhe i hodha një sy të shpejtë makinës së nënës. Ishte një model i vjetër që kishte mundësi të harxhonte shumë benzinë.

Ndjeva një sëmbim dhembshurie për këtë nënë me dy fëmijë, por e

ndeza motorin tim dhe vazhdova me planin tim.

Fill pas një minute udhëtimi në autostradë, një zë më erdhi: “Shko ndihmoje atë”. Nxitja erdhi dy herë.

E tunda kokën, duke menduar se ndoshta tashmë ajo ishte larguar. Çfarë do t’i thoja asaj në fund të fundit?

Zëri erdhi qartësisht një herë të tretë: “Shko ndihmoje atë!”

U ktheva sërish drejt stacionit të karburantit, duke u përpjekur të mendoja se çfarë do t’i thoja nëse ajo ishte ende atje.

Me të mbërritur, pashë që dyert e makinës së saj ishin të hapura. Ishte e ulur në vendin e shoferit dhe dy fëmijët e saj të vegjël po kënaqeshin me akulloret e tyre në ndenjëset e pasme.

Bëra një lutje të vogël, duke i kërkuar Atit Qiellor se çfarë duhej të thoja. I njëjti zë më tha: “Prezantohu dhe pyete nëse ka nevojë për ndihmë”. Iu afrova makinës së saj dhe u prezantova. I thashë asaj që ndjeva mbresë për ta pyetur nëse kishte nevojë për ndihmë.

Ajo filloi të qante dhe tha: “Sapo mbarova së luturi Jezusit, duke i kërkuar Atij që të dërgonte dikë për të më ndihmuar”.

Ati Qiellor i ishte përgjigjur lutjes së saj. Pagova që ta mbushja me benzinë makinën e saj dhe i dhashë numrin e telefonit të dikujt në kuorumin tonë të pleqve, i cili po merrte njerëz në punë në atë kohë. Nuk e di se çfarë ndodhi me këtë nënë të re më pas, por jam mirënjohës që e ndoqa nxitjen për ta ndihmuar atë. ■

Tomas Robins, Kaliforni, SHBA

MOS QËLLO!

Bobi dhe unë ishim të ulur në makinën tonë të policisë, duke pritur për një shenjë lëvizjeje në rrugë. E kishim filluar vëzhgimin tonë dy orë më parë, pasi kishim parë makinën e përmendur në një paralajmërim në radion e policisë.

“Grabitje me armë”, kishte thënë paralajmërimi. “Dy meshkuj, që të


dy të armatosur. Sapo u panë në një makinë ngjyrë portokalli. Dëshmitarët thonë që burrat janë të vrazhdë dhe të gatshëm për të qëlluar.”

Një shtim i grabitjeve me armë kishite ndodhur kohët e fundit në atë zonë, prapëseprapë, pavarësisht nga përpjekjet tona më të mira, grabitësit kishin shpëtuar në mënyrë të përsëritur.

Këto mendime më vërsuan në kokë sapo i pashë dy hije të dilnin nga një shtëpi në rrugën e errët dhe të hipnin në makinën bojë portokalli. Tani ishin duke ardhur në drejtimin tonë.

“Kërkojmë një patrullë mbështetëse”, thashë unë. “Të dyshuarit po shkojnë drejt veriut nga vendndodhja jonë.”

Pavarësisht nga tensioni i çastit, dëgjova një zë. Ishte i qetë, por autoritar dhe i fuqishëm: “Mos qëllo!”



Patrulla jonë mbështetëse, dy detektivë të veshur si civilë, me një makinë pa shenja policie, dolën përpara makinës ndërkohë që Bobi dhe unë i ndoqëm. Pasi tri makinat tona kishin hyrë në një urë, detektivët papritur ndaluan në vijë diagonale në urë përpara makinës bojë portokalli dhe ne ndalum pas saj, duke i futur në mes njerëzit e dyshuar. Pothuajse papritur, makina ndaloi dhe që të dy figurat u zhdukën nga sytë.

“Dilni jashtë nga makina me duart mbi kokë!” Urdhërova unë pasi dola nga makina. Askush s’u përgjigj.

I përqendruar dhe gati për të qëlluar, urdhërova sërish: “Dilni jashtë nga makina me duart mbi kokë. Dilni tani!”

Papritur shoferi u ngrit dhe u kthye drejt meje. Mund të shihja një objekt metalik të shkëlqente në duart e tij.

Trajnimi im policor dhe intuita praktike më diktuan që ta tërhiqja këmbëzën për të shpëtuar jetën time. Por pavarësisht nga tensioni i çastit, dëgjova një zë. Ishte i qetë, por autoritar dhe i fuqishëm: “Mos qëlllo!”

Prisja që të goditesha nga çasti në çast, por prita që dikush brenda në makinë të qëllonte i pari. Përkundrazi, shoferi i çoi duart lart, ngriti mbi kokën e tij atë që dukej si një revole dhe i lëshoi duart në prehrin e tij.

“Ndal!” Thashë teksa u vërsula drejt makinës. “Mos lëviz!”

Çasti u duk si një shfaqje televizive – derisa e kuptova që kriminelët e ashpër në makinë ishin në të vërtetë dy vajza të reja, të frikësuar. Ajo që pata menduar se ishte një revole,

s’ishte veçse një mbërthyes e rripit të sigurimit.

Vajzat, siç e mësuam shpejt, ua kishin dhënë për ta përdorur makinën të dashurve të tyre. Ato nuk e kishin idenë se çfarë lloj njerëzish ishin ata.

“Mendova se ishe i vdekur, Kell!” Bobi më tha më vonë. “Gati sa nuk hapa zjarr. S’e di përse nuk e bëra.”

Dy detektivët në makinën pa shenjë policore thanë të njëjtën gjë, edhe pse askush përveç meje nuk e dëgjoi zërin. E di që vetëm fuqitë e qiellit mund t’i kishin shpëtuar ato dy vajza nga vdekja dhe katër oficerë policie nga bërja e një gabimi tragjik. Kjo përvojë më dha një dituri të sigurt se Ati ynë Qiellor mund dhe do të ndërhyjë për të mirën tonë. ■

Nuk jepet emri

MËSOJUNI ATYRE TË LEXOJNË LIBRIN E MORMONIT

Gjatë shërbimit tonë në Misionin e Gjenevës në Zvicër, unë u thirra dhe u veçova për të qenë presidenti i degës dhe gruaja ime u thirr si presidentja e Shoqatës së Ndihmës. Së bashku, ne punuam me gjithë forcën tonë për ta rigjallëruar degën që po haste vështirësi. Megjithëse e organizuar në vitet 1960, dega nuk

kishite parë asnjë pagëzim për shumë vite dhe nuk kishte dërguar asnjë misionar në fushën e misionit për 15 vjet.

Ishte e qartë se ne kishim nevojë për ndihmën e Zotit, me qëllim që të gjenim zgjidhje për vështirësitë e shumta që po haste dega. Pasi isha lutur për sfidat e degës, Shpirti i Zotit më tha: “Mësojuni anëtarëve të lexojnë Librin e Mormonit dhe ju do të jeni të suksesshëm”.

Menjëherë, ne bëmë plane për t’i zotuar të gjithë anëtarët të fillonin të lexonin Librin e Mormonit.

Pasuan rrjedhoja të jashtëzakonshme. Paqja dhe Shpirti u kthyen në degë. Familje të reja u bashkuan me Kishën. I nxitur nga dëshira e tij për të shërbyer, një i ri u nis për në mision. Disa martesë të trazuar u forcuan dhe familjet u afruan. Kjo degë vazhdon të përparojë edhe sot.

Ne dhe anëtarët e degës dëshmuam personalisht fuqinë mrekullibërëse të Librit të Mormonit. Ai është me të vërtetë gurthemeli i besimit tonë dhe i dëshmisë sonë për ungjillin dhe Jezu Krishtin. Ne e duam atë me gjithë zemrën tonë. Ai është një burim njohurie i pambarueshëm dhe i pandryshueshëm.

Kjo përvojë na mësoi se Libri i Mormonit është mjeti më i sigurt për t’i ndihmuar vëllezërit dhe motrat tona të dalin nga hijet e errësirës shpirtërore që mbulojnë tokën. Ky libër sjell paqe, gëzim, lumturi dhe një dëshirë të fortë për ta ndjekur Shpëtimtarin, Jezu Krishtin. ■

Emilien Riouks, Kebek, Kanada

Dallimi i Falsifikimeve të Satanit

Nga Denis C. Gaunt

Po vija disa kartëmonedha dollaresh amerikanë në kuletë në një dyqan ushqimesh, kur më zuri syri një nga kartëmonedhat. Mendova se ngjyra e blertë ishte më e hapur se të tjerat, kështu që e pashë më me hollësi. Më pas vura re se figura e Presidentit Xhorxh Uashington nuk dukej aq qartë. Edhe letra nuk ndihej njësoj. Ishte e falsifikuar! Nëpunësi e shkëmbeu atë me një kartëmonedhë dollari të vërtetë dhe më pas ia dha kartëmonedhën e falsifikuar përgjegjësit të dyqanit.

Qysh atëherë kam menduar shumë për atë kartëmonedhë dollari të falsifikuar. Pyesja veten se për sa kohë kishte qenë në qarkullim dhe sa shumë njerëz kishte mashtruar përgjatë viteve. Në fakt, po të mos i kisha kushtuar vëmendje, edhe unë mund të isha mashtruar. Por, duke e krahasuar me gjënë e vërtetë dhe duke u përqendruar tek ndryshimet në vend të ngjashmërive, unë mund ta dalloja që ishte e falsifikuar.

Libri i Mormonit është i mbushur me shembuj të falsifikuesve shpirtërorë, të cilët i ndoqën metodat e Satanit duke i gënjer dhe duke i mashtruar të tjerët për vetë përfitimin e tyre. Nëpërmjet studimit të marifeteve dhe taktikave të tyre, ne fillojmë t'i vërejmë gabimet dhe pasaktësitë e tyre në të njëjtën mënyrë siç një sy i stërvitur fillon të vërejë ndryshimin midis monedhave të vërteta dhe të falsifikuara. Sa më shumë që ta stërvitim syrin tonë për të dalluar ndryshimet, aq më të përgatitur do të jemi ne për të vënë në dukje falsifikimet e së sotmes dhe për t'u bërë ballë gënjeshtrove të tyre.

Mbledhja e Inteligjencës për Falsifikimet e Satanit

Satani kërkon që të na largojë nëpërmjet vetë markës së tij të falsifikimit shpirtëror dhe, nëse nuk jemi të kujdesshëm, ne do të mashtrohemi. Presidenti Jozef F. Smith (1838–1918) paralajmëroi: “Satani është një imitues i zoti dhe ashtu si e vërteta autentike

Kur ne përballemi me falsifikime shpirtërore, Libri i Mormonit mund të na ndihmojë të përcaktojmë atë që është e vërtetë ose jo.

e ungjillit i jepet botës me një bollëk përherë e më të madh, po ashtu ai përhap monedhat e falsifikuara të doktrinës së rreme. Ruhuni nga monedhat e tij të rreme, nuk do t'ju japin veçse zhgënjim, mjerim dhe vdekje shpirtërore.”¹

Mbrojtja më e mirë që kemi ndaj të qenit të mashtruar nga falsifikimet e Satanit, është të njihemi aq sa është e mundur me të vërtetat e ungjillit. Sa më thellë ta njohim të vërtetën,



aq më e lehtë do të jetë të dallojmë ndryshimet kur Satani na paraqet falsifikimet e tij. Pra, kur ai e bën këtë, ne duhet të kërkojmë ndryshimet dhe jo ngjashmëritë, ashtu siç bëra unë me kartëmonedhat e dollarit, sepse është atje që gënjeshttrat gjithmonë do të zbulohen.

Presidenti Ezra Taft Benson (1899–1994) dha mësim: “Libri i Mormonit nxjerr në pah armiqtë e Krishtit. . . . Perëndia, me njohurinë

e tij paraprake të pafundme, i dha formë në mënyrë të tillë Librit të Mormonit që ne të mund ta kuptojmë gabimin dhe të dimë se si t’i luftojmë konceptet e rreme arsimore, politike, fetare dhe filozofike të kohës sonë.”²

Sot ne jemi në luftë me Satanin. Ne, ashtu si çdo ushtri, kemi nevojë të dimë atë që po bën armiku. Njohuria se kur dhe ku do të sulmojë armiku, për shembull, mund të jetë një informacion i paçmueshëm. Kjo

është arsyeja përse termi për marrjen e një informacioni të tillë quhet “mbledhje e inteligjencës”. Të njohim armikun tonë do të thotë të bëhemi më të zgjuar se armiku ynë. Libri i Mormonit mund të na ndihmojë të “mbledhim inteligjencë” mbi metodat falsifikuese të Satanit.

Fjalët Lajkatore Janë Falsifikim

Më shumë se gjysma e falsifikuesve në Librin e Mormonit përdorin

fjalë lajkatare dhe një personalitet tërheqës për të arritur synimet e tyre. Për shembull, Sheremi “kishte njohuri të përkryer të gjuhës së popullit; prandaj ai mundi të përdorte shumë lajka dhe shumë fuqi të fjalës, sipas fuqisë së djallit” (Jakobi [LiM] 7:4). Priftërinjtë e ligj të mbretit Noe thanë “fjalë [të] kota dhe lajkatuese” (Mosia 11:7), duke e bërë kështu popullin që të përfshihej në idhujtari dhe ligësi të tjera. Korihori arriti rezultate të ngjashme në kohën e tij, “duke [i] nxjerrë zemrat e shumë prej tyre nga udha e drejtë” (Alma 30:18). Amalikia dhe Gadiantoni, të dy, e përdorën prirjen e tyre për lajka që të formonin ushtri me pasues të ligj (shih Alma 46:10; Helamani 2:4).

Kjo nuk është e rastësishme. Lajkati- mi është i cekët, i pasinqertë, bosh dhe i tepruar. Nefi i paralajmëroi ata që “do të mësojnë sipas kësaj mënyre doktrina të rreme dhe të kota dhe të marra, dhe do të fryhen në zemrat e tyre dhe ata do të përpiqen t’i fshehin thellë planet e tyre nga Zoti; dhe punët e tyre do të jenë në errësirë” (2 Nefi 28:9).

Lajkat shpesh përdoren për të mashtruar; ato zakonisht kanë një motiv të mëtejshëm ose një plan të fshehtë. Lajkat kanë të bëjnë më shumë me stilin sesa thelbin dhe joshin kotësinë dhe krenarinë e njeriut natyror që është brenda tij. Megjithatë, profetët e Zotit, na thonë të vërtetat e thjeshta, por ende të rëndësishme, që ne kemi *nevojë* të dëgjojmë.

Lajkatimi është gjuha që flet Satani. Presidenti Xhejms E. Faust



“[Zëri i Satanit] është një zë tërheqës dhe intrigues. . . . Askush nuk do ta dëgjonte zërin e Satanit nëse ai do të tingëllonte i ashpër ose i lig.”

(1920–2007), Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, shpjegoi: “Zëri [i Satanit] shpesh duket kaq i arsyeshëm dhe mesazhi i tij kaq i lehtë për t’u justifikuar. Është një zë tërheqës, intrigues me tone të ëmbla. Ai nuk është as i fortë as i vrazhdë. Askush nuk do ta dëgjonte zërin e Satanit nëse ai do të tingëllonte i ashpër ose i lig.”³

Kur bota na paraqet një ide, filozofi ose opinion që duket se josh vetëm kotësinë ose krenarinë tonë apo që thjesht tingëllon shumë i mirë për të qenë i vërtetë, ky duhet të jetë menjëherë një paralajmërim për ne. Trajtojini ato ide si falsifikime. Krahasojini ato me të vërtetat e dhëna mësim nga profetët e Zotit. Kërkoni ndryshimet, jo ngjashmëritë, dhe idetë falsifikuese do të bëhen të dukshme.

Nehori – një Falsifikues i Njohur!

Nehori e përdori lirisht metodën e Satanit për të bërë lajka. Le ta analizojmë atë si një rast studimi të një falsifikimi shpirtëror. Nehori, doktrina e të cilit dukej se e përqaftonte idenë e një shëlbuesi, ishte një predikues i njohur dhe tërheqës midis neftëve. Nehori bëri shumë pasues duke dhënë mësim se “i gjithë njerëzimi duhet të shpëtohet ditën e fundit” dhe “do të k[etë] jetë të përjetshme” (Alma 1:4).

A mund ta shohim përse mesazhi i Nehorit do të ishte kaq tërheqës? Ai po jepte mësim rreth një Perëndie të shoqërueshëm dhe tolerant – një Perëndie, i cili, për shkak se e do gjithsecilin, do ta shpëtojë gjithsecilin, pavarësisht gjithçkaje. Prandaj,

vazhdoni dhe bëni atë që doni, sepse gjithçka është në rregull. Kjo është një filozofi joshëse që u përqaftua nga po aq njerëz në kohën e Nehorit (shih Alma 1:5) ashtu siç përqafohet edhe nga shumë njerëz sot. Një biletë falas për në qiell është diçka që njerëzit me sa duket e duan.

Pra, çfarë problemi kishte mesazhi i Nehorit? Le të shohim sërish pikat kryesore të argumentit të tij:

- Perëndia i krijoi të gjithë njerëzit – e vërtetë.
- Perëndia i do të gjithë njerëzit – e vërtetë.
- Ne nuk duhet të kemi frikë nga Perëndia – e vërtetë.
- Ne duhet të gëzohemi në idenë e shpëtimit – e vërtetë.

Deri tani, ka shumë ngjashmëri midis asaj që dha mësim Nehori dhe të vërtetave të ungjillit. Por mbani mend – ashtu siç ishte me paranë e falsifikuar, ne duhet të kërkojmë ndryshimet, jo ngjashmëritë. Prandaj, le të shohim pikën e fundit të Nehorit:

- Perëndia do t'i jap çdokujt jetë të përjetshme – e rreme!

Tani, ja ku është ndryshimi i rëndësishëm që na tregon se Nehori është një falsifikues shpirtëror. Shpëtimi nga vdekja fizike u jepet falas të gjithëve, por shpëtimi nga vdekja shpirtërore varet nga gatishmëria për t'u penduar. Nëse pendohemi, atëherë ne mund të marrim jetë të përjetshme (shih Jakobi [LiM] 6:11). Por nuk ka udhëtim falas.

Gideoni dhe Alma e Dalluan Falsifikuesin

E liga e Nehorit u vu në pah ditën që ai takoi Gideonin, një mësues i drejtë në Kishën e Perëndisë. Gideoni i kishte bërë ballë mbretit Noe vite më parë dhe si rrjedhojë kishte përvojë me falsifikuesit shpirtërorë (shih Mosia 19:4–8). Nehori “filloi të grindej rreptë me të, kështu që ai të mund të largonte njerëzit nga kisha; por [Gideoni] i bëri ballë atij duke e qortuar me fjalët e Perëndisë” (Alma 1:7). Gideoni e dalloj Nehorin si një falsifikues. Sapo u nxor në pah, Nehori iu drejtua një metode tjetër të Satanit – vrasjes. Por vdekja e Gideonit nuk ishte e kotë. Njerëzit e sollën Nehor falsifikuesin përpara Almës që të gjykohej.

Alma kuptoi që Nehori ishte fajtor jo vetëm për intrigat e priftërinjve dhe vrasje, por edhe që, nëse e linte të padënuar, intriga e priftërinjve midis njerëzve “do të ç[onte] në shkatërrimin e [tyre] të plotë” (Alma 1:12). Prandaj Nehori u dënua me vdekje dhe vuajti “një vdekje të turpshme” (Alma 1:15).

Gideoni dhe Alma janë shembuj për ne. Kur e kemi Shpirtin me vete, ne do t'i shohim dhe dëgjojmë “gjëra[t] ashtu siç janë në të vërtetë” (Jakobi [LiM] 4:13). Ne do t'i kuptojmë planet dhe skemat e falsifikuara të Satanit “me [një] njohuri të përkryer, . . . sa është të dallojmë dritën e ditës nga errësira” (Moroni 7:15).

Armiku ynë “falsifikues” është i zgjuar, por ashtu si Gideoni dhe Alma, ne mund të jemi më të zgjuar. Ashtu siç unë fillova t'i dalloj gradualisht



SATANI PËRHAP GËNJESHTRA

“Satani, kundërshtari ynë, dëshiron që ne

të dështojmë. Ai përhap gënjeshtër si pjesë të përpjekjes së tij për ta shkatërruar besimin tonë. Ai tinëzisht sugjeron që dyshuesi, skeptiku, ciniku është i përparuar dhe inteligjent, ndërkohë që ata që kanë besim te Perëndia dhe mrekullitë e Tij, janë naivë, të verbuar ose të pamend. Satani do të rekomandojë se është e pranueshme të vësh në dyshim dhuratat shpirtërore dhe mësimet e profetëve të vërtetë.”

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, “Mos Ki frikë, Vetëm Ki Besim”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 78.

ndryshimet midis kartëmonedhave të mia në dollarë, ne mund t'i stërvitim gradualisht sytë tanë po aq mirë sa edhe mendjen e shpirtin tonë, për të dalluar ndryshimet midis së vërtetës dhe gënjeshtrave. Kur veprojmë kështu, ne do t'i dallojmë falsifikuesit dhe do t'u bëjmë ballë gënjeshtrave të tyre. ■

Autori jeton në Jutá, SHBA.

SHËNIME

1. Jozef F. Smith, *Gospel Doctrine*, botimi i 5-të (1939), f. 376.
2. *Mësime të Presidentëve të Kishës: Ezra Taft Benson* (2014), f. 139.
3. James E. Faust, “The Forces That Will Save Us”, *Liahona*, janar 2007, f. 4.

Matja e Bekimeve në Madagaskar

Nga Minda Eni Selu

Revistat e Kishës

Pasi gruaja e tij vuajti një abort që ia copëtoi zemrën gjatë shtatzënisë së saj të parë, Solofo Ravelojaona ndjeu se lutjet e tyre morën përgjigje një vit më vonë me shtatzëninë e tyre të dytë. Ai dhe gruaja e tij, Hari Martine, e konsideruan lindjen e vajzës së tyre si të ishte një nga bekimet e tyre më të mëdha. Solofo shpjegon: “Për shkak se ne i kërkuam Perëndisë dhe Ai na e dha atë, ne e quajmë me një emër që, në malagasisht, do të thotë ‘përgjigja e Perëndisë’”.

Solofo, një i ri në moshë madhore nga Madagaskari, mbështetet te njohuria se Perëndia u përgjigjet lutjeve dhe në kohën e duhur i bekon besnikët. “Jeta është e vështirë”, thotë Solofo, “dhe kur njerëzit nuk e marrin atë që dëshirojnë, disa fillojnë të pyesin: ‘Përse më ndodhi kjo mua?’ Ata mund të largohen nga Kisha ose të vënë në dyshim besimin e tyre në Perëndi. Por kur ne e jetojmë ungjillin dhe i lexojmë shkrimet e shenjta, është më e thjeshtë. Kur ju e jetoni me të vërtetë ungjillin, ju me të vërtetë mund t’i shihni bekimet.”

Duke jetuar në një vend me sfida të mëdha, të tilla si varfëri e madhe, paqëndrueshmëri brenda qeverisë, një infrastrukturë e dobët dhe shkatërrime natyrore, është e qartë përse Solofo thotë se jeta është e vështirë. Por për të, bekimet që sjell të jetuarit e ungjillit ia tejkalojnë çdo vështirësi. “Nuk mundem madje t’i numëroj bekimet që marr, për aq kohë sa e jetoj ungjillin”, thotë ai.

Për shkak se Kisha është pak a shumë e re në Madagaskar (dega e parë u organizua në vitin 1990), Solofo thotë se pjesa më e vështirë e të qenit një anëtar janë thashethemet dhe idetë e gabuara për Kishën. Solofo komenton se, ashtu si në vegimin e Lehit për pemën e jetës, “njerëzit mund të mos e përqafojnë plotësisht ungjillin sepse ndihen të turpëruar përpara miqve të tyre dhe kanë frikë se nuk do të pranohen nga familja e tyre”. Ajo çka e bën Solofon të ndryshëm, sugjeron ai, është se, “mua kurrë nuk më ka ardhur turp. E jetoj ungjillin dhe dua që ta ndaj atë gjithmonë me kolegët e mi, edhe pse disa prej tyre nuk janë me të vërtetë të interesuar.” Ai e ndan

Pavarësisht nga trazirat politike dhe vështirësitë ekonomike të këtij vendi, Solofo mbështetet te bekimet që vijin nga të jetuarit e ungjillit.

dëshminë e tij të thjeshtë aq shpesh sa shumë prej bashkëpunëtorëve të tij i kanë vënë nofkën “pastori”.

Në mes të trazirave ekonomike dhe politike, Solofo dhe Hari Martine mbështeten te bekimet e besëlidhjeve të tyre në tempull (ata u martuan në Tempullin e Johannesburgut në Afrikën e Jugut, një vit pas misionëve të tyre – i tiji në Uganda, i saji në Madagaskar), si edhe te mirëbesimi i tyre në Zot. “Unë kam ungjillin dhe thjeshtë e lë jetën time në duart e Perëndisë”, shpjegon Solofo. Ai mund të mbështetet në dëshminë e tij të fortë për shkak se ai tashmë ka besim në “përgjigjet e Perëndisë”. ■



MË SHUMË PËR SOLOFON

Çfarë ushqimesh ju pëlqen të hani?

Ushqimi që ne hamë është orizi – shumë oriz. Një nga gjërat që mua më pëlqen, quhet *ravtoto*. Ne përdorim një mjet të veçantë për t'i shtypur gjethet e kasavës në copa të vogla dhe i shërbejmë me oriz e mish derri.

Çfarë ju pëlqen të bëni në kohën tuaj të lirë?

Më pëlqen të luaj në tastierë elektronike, të këndoj dhe lexoj. Për shkak se presidenti i degës e dinte se mua më pëlqente shumë të këndoja dhe se mund të luaja në tastierë elektronike, kur unë erdha në degë, ai tha: "Ah, [tani] ne kemi dikë që mund ta drejtojë korin", dhe i ofrova kohën time. Ata nuk kishin një kor më parë, por unë fillova t'i mësoja dhe tani ata kënaqen me të.

FAKTE RRETH MADAGASKARIT

Gjuhët: frëngjisht, malagasisht
Kryeqyteti: Antananarivo

SIPAS SHIFRAVE

22.005.222 njerëz (e llogaritur deri në 2012-ën)
80 përqind e kafshëve të gjetura në Madagaskar nuk ekzistojnë në ndonjë vend tjetër në tokë
Ishulli i 4-ërt më i madh në botë
60 përqind e vaniljes në botë eksportohet nga Madagaskari

KISHA NË MADAGASKAR

9.190 shenjtore të ditëve të mëvonshme
37 lagje dhe degë
2 kunjë
1 mision







**Nga Plaku
Dejl G. Renland,**
i Kuorumit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

QËNDRUESHMËRIA SHPIRTËRORE: NDËRTIMI I NJË ANIJEJE QË NUK FUNDOSËT

Ne kemi nevojë për qëndrueshmëri të mjaftueshme shpirtërore që të lundrojmë me sukses në jetën tonë në vdekshmëri dhe të kthehemi të sigurt në shtëpinë tonë qiellore.

Në fillim të shekullit të 17-të, mbreti suedez, Gustav Adolfi II, porositi një anije lufte, të cilës do t'i vihej emri *Vasa*. Anija përfaqësonte një shpenzim të konsiderueshëm burimesh, veçanërisht të lisit nga i cili do të ndërtohej anija. Gustav Adolfi mbikqyri nga afër procesin e ndërtimit, duke u përpjekur të siguronte se *Vasa* do t'i realizonte plotësisht pritshmëritë e tij.

Pasi filloi ndërtimi, Gustav Adolfi urdhëroi që *Vasa* të bëhej më e gjatë. Për shkak se mbështetëset e gjerësisë ishte ndërtuar tashmë nga një lis i çmuar, mbreti i urdhëroi ndërtuesit që ta shtonin gjatësinë e anijes pa e shtuar gjerësinë e saj. Megjithëse ndërtuesit e anijes e dinin se, duke e bërë këtë, do ta prishnin qëndrueshmërinë në det të *Vasës*, ata ngurruan t'i tregonin mbretit diçka që ata e dinin se ai nuk donte ta dëgjonte. Ata ranë dakord. Gustav Adolfi gjithashtu këmbënguli që kjo anije të mos kishte thjesht vetëm një kuvertë të zakonshme për pushkët, por të kishte topa në tre kuverta, [duke i vendosur] topat më të rëndë në kuvertën e sipërme. Sërish, në kundërshtim me gjykimin e tyre më të mirë, ndërtuesit e anijes ranë dakord.

Më 10 gusht 1628, *Vasa* filloi udhëtimin e saj të parë. Pasi *Vasa* u largua nga limani, një erë e fortë i shtyu velat e saj dhe anija filloi të lëkundej. Fill pas kësaj, “ajo u anua dhe uji vërshoi përmes dritareve të topave, derisa ajo me ngadalë shkoi në fund, me gjithë velat, flamurin dhe gjithçka tjetër”¹. Udhëtimi i parë i *Vasës* ishte rreth 1.280 m.

Dëshira e Gustav Adolfit për një simbol të tepërt të fuqisë e shkatërroi qëllimin e asaj që do të kishte qenë një anije lundrimi madhështore, anija më e madhe e luftës e asaj kohe. Ngurrimi i ndërtuesve të anijes për të folur – frika e tyre nga pakënaqësia e mbretit – i hoqi mbretit njohurinë dhe këndvështrimin e tyre. Të gjithë ata që u përfshinë, i lanë në harresë synimet e sipërmarrjes: të mbronin Suedinë dhe të nxitnin interesat e saj jashtë vendit. Një anije që përpiket të sfidojë ligjet e fizikës, është thjesht një barkë që nuk do të pluskojë.

Që të lundrojmë me sukses në jetën tonë në vdekshmëri, ne kemi nevojë për qëndrueshmëri të mjaftueshme shpirtërore që t'u bëjmë ballë erërave të kundërta dhe kundërrymave, të bëjmë kthesat e nevojshme dhe të kthehemi të sigurt në shtëpinë tonë qiellore. Ka disa gjëra që ne mund të bëjmë për ta rritur qëndrueshmërinë tonë shpirtërore. Unë do të trajtoj katër prej tyre.

Bindja ndaj Urdhërimeve të Perëndisë

E para, është bindja ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Ashtu si *Vasa* iu nënshtrua ligjeve fizike, ne të gjithë u nënshtrohemi ligjeve shpirtërore. Askush nuk përjashtohet. Ne kemi nevojë t'u bindemi këtyre ligjeve shpirtërore, të cilave ne u referohemi si urdhërime të Perëndisë.

Të punuarit me ligjet fizike për ndërtimin e anijes mund të jetë dukur kufizuese për Gustav Adolfin, por *Vasa* nuk do të ishte fundosur përpara se misioni i saj të fillonte, nëse do të ishte në përputhje me këto ligje. Përkundrazi, ajo do të kishte pasur lirinë dhe përshtatshmërinë për të përmbushur atë që kishte për qëllim të bënte.

Prandaj, edhe bindja ndaj ligjeve të Perëndisë e ruan lirinë, përshtatshmërinë dhe aftësinë tonë për të përmbushur potencialin tonë. Urdhërimet nuk kanë për qëllim që të na kufizojnë. Përkundrazi, bindja çon në qëndrueshmëri të shtuar shpirtërore dhe lumturi afatgjatë.

Bindja është zgjedhja jonë. Jezusi udhëzoi: "Vini re, unë jua kam dhënë urdhërimet; prandaj zbatoni urdhërimet e mia" (3 Nefi 15:10). Është kaq e thjeshtë. Merrni

një vendim. Vendosi tani që të bindeni me saktësi. Asgjë tjetër nuk do ta rritë më shumë qëndrueshmërinë shpirtërore. Asgjë tjetër nuk do të na japë liri më të madhe për të përmbushur misionin tonë në jetë.

Vënia Vesh e Këshillave dhe të Bërit Nxënës për Tërë Jetën

Së dyti, ne kemi nevojë që t'i kushtojmë vëmendje dhe t'ua vëmë veshin këshillave prej burimeve të besuara, dhe ta zotojmë veten tonë që të bëhemi nxënës për tërë jetën.

Një nga grackat kur fitojmë njohuri, është kryelartësia që mund të vijë kur ne mendojmë se dimë kaq shumë, sa nuk ka ngelur gjë për të mësuar. Të gjithë ne e kemi parë këtë tek individët që janë shumë të sigurt për vetë gjenialitetin e tyre. Është me të vërtetë e vështirë t'i japësh mësim dikujt që mendon se di gjithçka.

Duke qenë i ndërgjegjshëm për këtë dhe duke pasur dëshirën për të qenë një nxënës për tërë jetën, Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, ka thënë: "Jam ende një fëmijë që ka shumë për të mësuar. Shumica e njerëzve mund të më mësojnë diçka."² Kur Presidenti Ajring më dha thirrjen për të qenë një Autoritet i Përgjithshëm, ai më dha një mësim të rëndësishëm. Ai tha se, kur e dëgjon dikë që tregon një histori, të cilën ai e ka dëgjuar më parë, apo të përdorë një shkrim të shenjtë të cilin ai e njuh shumë mirë, ai e pyet veten: "Përse Zoti po e thekson këtë për mua?" dhe "Çfarë kam ende për të mësuar nga ajo histori apo nga ai shkrim i shenjtë?" Nëse duam që ta rritim qëndrueshmërinë tonë shpirtërore, ne do të jemi të gatshëm që të mësojmë dhe do të jemi mjaftueshëm të përlulur për ta pranuar udhërrëfimin, pavarësisht nga moshën dhe përvoja jonë.

Është me të vërtetë zgjedhja jonë. Ne mund t'i dëgjojmë dhe t'ua vëmë veshin këshillave të dhëna për ne nga udhëheqësit e Kishës, veçanërisht nga ata që ne i mbështetim si profetë, shikues dhe zbulues; nga prindërit dhe nga miqtë e besuar – ose jo. Ne mund të kërkojmë të jemi nxënës për tërë jetën – ose jo. Ne mund ta rritim qëndrueshmërinë





tonë shpirtërore – ose jo. Nëse ne dështojmë që ta rritim qëndrueshmërinë tonë shpirtërore, ne do të bëhemi si *Vasa* – një barkë që nuk do të pluskojë.

✦ *Shërbimi ndaj të Tjerëve*

Së treti, të qenit të drejtuar ndaj nevojave të të tjerëve, përkujdesja ndaj të tjerëve dhe shërbimi ndaj të tjerëve e rritin qëndrueshmërinë tonë shpirtërore.

Përrjetësia mbahet si një synim më i qartë kur ne përqendrohemi tek të tjerët, ndërsa kërkojmë të ndihmojmë fëmijët e Atit Qiellor. Kam zbuluar se është shumë më e lehtë të marr frymëzim kur jam duke u lutur për të gjetur se si mund ta ndihmoj dikë tjetër, sesa kur jam duke u lutur thjesht për veten time.

Ne mund të besojmë se diku në të ardhmen, ne do të jemi në një gjendje më të mirë për të ndihmuar. Në të vërtetë, koha është tani. E kemi gabim nëse mendojmë se ajo do të jetë më e përshtatshme kur të kemi më shumë kohë, më shumë para ose më shumë gjëra të tjera për t'u shërbyer të tjerëve. Pavarësisht nga rrethanat, ne e kemi një zgjedhje. Do t'i ndihmojmë apo jo të tjerët? Ne ngelim në një provim të rëndësishëm të vdeqshmërisë nëse nuk zgjedhim t'i ndihmojmë ata që janë në nevojë. Dhe, nëse

vërtet e japim ndihmën, ne po rritim vetë qëndrueshmërinë tonë shpirtërore.

✦ *Të Bërit e Jezu Krishtit Themeli Ynë*

Së katërti, përfundimisht, dhe më e rëndësishmja, qëndrueshmëria jonë shpirtërore rritet në përpjesëtim me shkallën në të cilën ne e kemi vendosur Jezu Krishtin si themelin tonë.

Pa Krishtin, ne shtyhem si anija që hidhet andej-këndej mbi dallgë. Ne nuk kemi fuqi sepse nuk kemi vela. Ne nuk kemi qëndrueshmëri, veçanërisht në kohë stuhie, sepse nuk kemi spirancë. Ne nuk kemi drejtim ose synim sepse nuk kemi asgjë me të cilën të orientohemi. Ne duhet ta bëjmë Krishtin themelin tonë.

Me qëllim që t'i përballojmë, mposhtim dhe të jemi të përgatitur për erërat e kundërta dhe kundërrimat e jetës, ne duhet t'u bindemi urdhërimeve të Perëndisë; të bëhemi të përlulur, të gatshëm dhe të vendosur për të qenë nxënës për tërë jetën; t'u shërbejmë të tjerëve dhe ta vendosim Jezu Krishtin si themelin e jetës sonë. Kur e bëjmë këtë, ne e rritim qëndrueshmërinë tonë shpirtërore. Ndryshe nga *Vasa*, ne do të jemi në gjendje të kthehemi të sigurt në liman, duke e përmbushur fatin tonë. ■

Nga një takim shpirtëror në Universitetin "Brigam Jang", 16 shtator 2014. Për tekstin e plotë në anglisht, vizitoni speeches.byu.edu.

SHËNIME

1. Letër nga Këshilli i Suedisë të Mbretërisë së Mbretit Gustav Adolfi II; përkthimi i cituar te Richard O. Mason, "The *Vasa* Capsizes", virtualschool.edu/mon/CaseStudies/Vasa/vasa.html. Ekzistojnë shumë rrëfime për *Vasën*; shih, për shembull, vasamuseet.se/en për histori dhe hallka të tjera lidhëse.
2. Henry B. Eyring, në Robert I. Eaton and Henry J. Eyring, *I Will Lead You Along: The Life of Henry B. Eyring* (2013), f. 409.

MËSONI TË LUANI NJË HIMN *për 10 Minuta!*

Hartuar dhe Përshtatur nga Daniel Karter

Sektori i Kishës për Muzikën dhe Artet Kulturore


Nëse nuk keni luajtur ndonjëherë në piano më parë por gjithmonë keni dashur të mësoni, ja ku është mundësia juaj. Gjithçka që ju nevojitet, është një tastierë muzike. Edhe nëse nuk e keni një në shtëpi, ju mund ta merrni këtë artikull me vete në një vend ku ka piano ose tastierë që të filloni të mësoni.


Ky mësim është kaq i thjeshtë dhe i lehtë sa që ju do të jeni në gjendje të luani një himn në fund të tij. Në fakt, është e mundur që ju mund ta luani melodinë e himnit në këtë mësim për rreth 10 minuta!

Gati? Le të fillojmë!

Përgatitja për të Luajtur në Piano

1. Ndërsa uleni në piano dhe i mbështetni gishtat mbi tastierë, lëvizeni stolin prapa në një largësi të mjaftueshme kështu që bërrylat tuaj të jenë disi të përtxyer.
2. Uluni në qendër të stolit, pikërisht përballë qendrës së tastierës.
3. Uluni në drejtim të pjesës së përparme të stolit me shpinën drejt dhe duke peshuar përpara.
4. Mbështetini këmbët tuaja në dysheme.
5. Uluni rehatshëm, duke mbajtur një qëndrim të mirë.
6. Sigurohuni që të ketë ndriçim të mirë që ta shihni partiturën dhe tastierën.





7. Ngrihuni në këmbë. Ulini duart anash dhe çlodhini. Dallojeni përkuljen e tyre të natyrshme, sikur të ishin duke mbajtur një top. Ndërsa uleni përsëri, vendosini gishtat mbi tastierë, duke e ruajtur të njëjtën përkulje të natyrshme.
8. Vendosini duart mbi tastierë, duke i lënë gishtat tuaja të prekin pranë

- qendrës së zonës së madhe mbi tastet e bardhë. Mbajini pëllëmbët mbi tastierë, por mos i mbështetni ato te tastet ose në drurin poshtë tasteve.
9. Shtypeni tastin me mollëzën e gishtit pikërisht nën majën e gishtit. Mbajeni çdo gisht të përkulur, duke e ngritur nga nyja prapa dorës suaj. Ndërsa e goditni tastin, mbajini kyçet e gishtave tuaj të përkulur.




Të Luash me Numra për Gishtat

Për t'iu ndihmuar të vendosni gishtin e saktë në çdo tast, gishtave u janë vendosur numra siç tregohet këtu. Numrat e

gishtave janë shkruar pranë notave në faqe.

Vendoseni dorën tuaj mbi çdo grup me pesë taste, duke e mbajtur çdo gisht mbi një tast. Ushtroni numrat e gishtave

duke u rënë tasteve me gishtin përkatës siç tregohet. Notat me bishtat lart janë për dorën e djathtë. Notat me bishtat poshtë janë për dorën e majtë.



Si ta Luani Himnin “Një Kod’r e Blert’ Ësht’ Atje Larg”

Vendosini duart tuaja mbi tastierë siç tregohet më poshtë.

Përdorini grupet me dy dhe tre taste të zinj që t’ju ndihmojnë të gjeni pozicionin e saktë.

Luajeni këtë himn, duke ndjekur numrat e gishtave siç tregohet. Notat me bishtat lart janë për dorën e djathtë dhe notat me bishtat poshtë janë për të majtën. Ushtroni himnin derisa të mësoheni me të. Përdorini parimet e teknikës së mirë të vendosjes së gishtave të renditura në listën me nëntë pika.


Tani jeni njohur me lojën në piano dhe keni mësuar një melodi himni të thjeshtë. Për të luajtur himne të tjera, keni nevojë të mësoni disa parime bazë rreth goditjeve, ritmit dhe notave.

Ja ku është pjesa më e mirë: mësimi që sapo mësuar, është mësimi i parë në Kursin e Tastierës së Kishës, në dispozicion në gjashtë gjuhë nga shpërndarësi i Kishës.¹ Plani i udhëzimeve të lehta për t’u ndjekur ju ndihmon të mësoni vetë ose në grupe. Ju mund të përfshini edhe të gjithë familjen tuaj në mësimin e pianos së bashku si një

veprimtari për mbrëmjen familjare. Kursi mund të përfundojë në vetëm gjashtë javë.

Studime të shumta tregojnë që mësimet private të muzikës ndihmojnë të përmirësohet përqendrimi i studentit, shkëlqimi akademik dhe aftësitë e arsyetimit.²

Duke mësuar aftësi muzikore, ne i zhvillojmë talentet që Zoti na ka dhënë, shtojmë njohurinë tonë dhe mësojmë shumë mënyra të ndryshme në të cilat mund ta përdorim njohurinë tonë dhe talentet tona për të ndërtuar mbretërinë e Tij. ■



SHËNIME

1. Për të porositur Kompletin e Kursit të Tastierës, shkoni te store.lids.org.
2. Shih Laura Lewis Brown, “The Benefits of Music Education”, pbs.org; Jessica Velasco, “How the Arts Can Help Students Excel”, the Science of Learning Blog, 11 dhjetor 2012, scilearn.com/blog/how-arts-help-students-excel; “Music Helps Children Learn Maths”, *The Telegraph*, 22 mars 2012, telegraph.co.uk.

E ZOTUAR PËR TË Hequr Dorë

Aftësitë e mia në piano nuk po përmirësoheshin, madje edhe pas vitesh ushtrimi. Prindërit më thanë se mund të hiqja dorë me një kusht: Duhej të mësoja 50 himne.

Nga Gretçen Blekbërn

Hyra në shtëpinë time me furi, me lot rrëke në sy pas një mësimi tjetër zhgënjyes në piano. Ishte viti im i katërt që merrja mësimë pianoje, dhe mezi isha përmirësuar te kënga “Twinkle, Twinkle, Little Star” [“Ndrin, Ndrin, Ylli Vogël”]. Mësuesja ime ishte përpjekur të gjente diçka pozitive për të thënë rreth lojës sime të tmerrshme, por unë veç ndihesha më keq. Prindërit e mi po paguanin para për mësimë pianoje që unë nuk i doja dhe nuk kisha fare shpresa.

Doja që prindërit të më lejonin të hiqja dorë. “Ju lutem”, iu përgjetrova. “Do të bëj çdo gjë. Si mund t’ju bind?”

Pasi e diskutuan midis tyre, ata thanë: “Nëse ti mëson 50 himne, ne do të lejojmë të heqësh dorë vetë”.

Fillova të ushtrohesh menjëherë. Doja të hiqja dorë kaq shumë, sa që isha e gatshme të kaloja kohë shtesë në piano. Himni i parë, “T’Falemi, Per’ndi, për Profetin” (*Himne*, nr.13), më mori afërsisht një muaj për ta zotëruar. Kisha akoma për qëllim të hiqja dorë, kështu që vazhdova të ushtrohesh.


Një gjë interesante ndodhi: himnet u bënë më të lehta për t’u përvetësuar. U ndjeva më e gëzuar gjatë gjithë javës. E gjeta veten duke kënduar himne nën zë gjatë ditës dhe duke kënduar me zë më të lartë në mbledhjen e sakramentit.

Më së fundi, e ndalova mbajtjen shënim të numrit të himneve që dija. Ndërsa bëhesha më e aftë në piano, kuptova që mund të mësoja një himn të ri pothuajse në një mënyrë të përsosur në më pak se 30 minuta.

Kur më në fund i mbledha të gjitha, kisha mësuar shumë më tepër se 50 himne. Nuk kishte asnjë mundësi që unë të hiqja dorë nga loja në piano. Isha bërë shumë më e sigurt te vetja në aftësitë e mia për të luajtur dhe e kisha ndier fuqinë e himneve në jetën time.

Himnet janë si shkrimet e shenjta; ato thonë të vërtetën. Kur i luaj himnet, ndihem sikur po zhytem në shkrimet e shenjta. Të mësuarit se si t’i luaja himnet ka qenë një shtysë për të filluar ndërtimin e dëshmisë sime dhe për të mësuar të vërtetën. E gjej veten duke i përsëritur fjalët e himneve të ndryshme për të më ndihmuar përgjatë ditës. Loja në piano e ka forcuar dëshminë time dhe i ka hapur dyert për mua kudo që shkoj. ■

Autorja jeton në Nju-Jork, SHBA.



TRONDITJA, HIDHËRIMI DHE PLANI I PERËNDISË

Nëpërmjet **përvojës më shkatërruese** të jetës sime, kam ndier se **Ati Qiellor ishte me mua** gjatë gjithë udhëtimit tim.

Nga Paola Çajupi

Ishte një mëngjes herët në vitin 2008 kur nëna ime më zgjoi për të shkuar në shkollë. Isha vërtet e lumtur atë mëngjes, por nuk e dija që ajo do të kthehej në ditën më të keqe të jetës sime ose në herën e fundit që do të isha me të. Nuk i përfundova të gjitha orët e mësimin atë ditë sepse një mikeshë e familjes duhej të më merrte nga shkolla dhe të më thoshte që mamaja ime kishte vrarë veten. Isha vetëm 12 vjeçe.

Mendova: “Si mund të jetoj pa nënën time?” Ajo ishte mikja ime më e mirë.

Qava për muaj të tërë. Nuk më pëlqente të shkoja në shkollë sepse fëmijët e tjerë më trajtonin ndryshe dhe ndienin keqardhje për mua. Nuk ia kisha idenë se çfarë hamendësohej të bëja; vetëm dija që duhej të bëhesha e fortë për çdokënd tjetër.

Një ditë, pesë ose gjashtë muaj pas vdekjes së nënës sime, isha vetëm në dhomën time pranë dritares, duke qarë, duke u përpjekur të kuptoja se për çfarë isha këtu. Papritur dëgjova një zë në kokën time: “Ti je bija ime; nuk do të të lë të vuash”. E dija që ishte Perëndia. Por më befasoi sepse nuk besoja më në Të, veçanërisht që kur ndjeva se ishte Perëndia që e kishte marrë nënën time nga unë. Edhe pse nuk e dija çfarë donte të thoshte Ai, u ndjeva e sigurt.

Tri vite më vonë vajta në Romë, Itali, për të vizituar dajën tim. Ai vazhdoi të më tregonte rreth kishës ku ai

shkonte. Një të diel, ai më mori me vete. Gjithmonë do ta mbaj mend tek ecja drejt dyerve të kishës për herë të parë dhe tek ndieja dashurinë e Atit Qiellor kur hyra brenda. U ndjeva si në shtëpi.

Fillova të shkoja në kishë çdo të diel dhe në çdo veprimtari gjatë javës. Më pëlqente të isha me rininë e Kishës. Ata më bënë më të lumtur. Ata mendonin dhe besonin të njëjtat gjëra si unë. Pastaj, pas tre muajsh, pushimet e mia të verës mbaruan dhe duhej të kthehesha në Shqipëri.

Kur u ktheva në shtëpi, i tregova babit tim rreth ndjenjave që kisha pasur dhe sa e lumtur isha ndier gjatë gjithë asaj kohe. Atij nuk i pëlqeu. Ai më tha se nuk do më lejonte të vazhdoja të shkoja në kishë ose të mësoja më shumë rreth saj. Kështu që do më duhej të isha e duruar për tri vitet e ardhshme derisa të mbushja 18 vjeçe. Pastaj mund të vendosja për veten time dhe të pagëzohesha.

Gjatë kësaj kohe u bekova me kaq shumë njerëz të cilët më tregonin se çfarë mësonin çdo të diel në kishë. Një prej atyre njerëzve ishte Stefëni. Ajo kishte jetuar në Itali kur daja im u bashkua me Kishën, por ajo ishte kthyer në shtëpinë e saj në Shtetet e Bashkuara. Daja im mendoi se do të ishte mirë për ne që t'i shkruanim njëra-tjetrës, kështu që unë e shtova atë si një mike në Facebook.


Edhe pse asnjëherë nuk ishim takuar ballë për ballë, do t'i jem gjithmonë mirënjohëse asaj që më ndihmoi të

ndërtoja besimin tim dhe të mësoja më shumë rreth ungjillit të Jezu Krishtit. Ajo më shkroi pothuajse çdo të diel dhe më tregoi gjithçka që kishte mësuar në kishë dhe pastaj do t'u përgjigjej pyetjeve të mia. Ajo ishte një shoqe e mrekullueshme për mua.

Më në fund, pas vitesh durimi, unë u pagëzova vetëm dy ditë pas ditëlindjes sime të 18-të. Dhe së shpejti do të ndaj me nënën time lumturinë që unë ndjeva atë ditë, sepse do të pagëzohem për të. Unë e di se ajo do të jetë krenare për jetën që kam zgjedhur.

Ndihem e bekuar nga Ati Qiellor sepse Ai ishte me mua përgjatë gjithë udhëtimit tim në kaq shumë mënyra. Thjesht duhej të prisja dhe të isha e duruar sepse Ai kishte një plan për mua. Ishte Ai i cili më dha forcë për t'i kaluar të gjitha sfidat me të cilat u përballa. Ai ishte gjithmonë aty, duke më ndihmuar të jem më e lumtur. ■

Autorja jeton në Shqipëri.





Nga Plaku
Zhozé A. Teisheira,
i Të Shtatëdhjetëve

EDHE NËSE

JE I NDROJTUR

*Mirëbesojini Perëndisë, dhe Ai do t'ju bekojë
në përpjekjet tuaja për ta ndarë ungjillin.*

Kur isha president i ri misioni në Brazil, po intervistoja disa pleq. I kërkova njërit të më tregonte rreth vetes.

“Jam shumë i ndrojtur”, tha ai. Ai u shqetësua se ndrojtja e tij po e pengonte atë që të ishte i aftë për të shërbyer.

Unë e pyeta: “A mendon se Zoti mund të të ndihmojë gjithsesi që të jesh një misionar i mirë?”

“Unë besoj se Zoti mund të bëjë çdo gjë.”

“Atëherë lëre Atë të të ndihmojë. A mendon se mund ta bësh këtë?”

“Unë mundem”, tha ai.

Më duhet të rrëfej që, ndërsa ai u largua, unë mendova: “Epo, shpresoj të funksionojë”.

Javët kaluan dhe shpejt të njëjtët misionarë erdhën për intervista përsëri. Kësaj here shoku i plakut të ndrojtur tha: “President, unë nuk e di çfarë i thatë atij, por me siguri bëri një ndryshim. Ai është bërë shumë i zoti për të folur me njerëzit”. Dhe kështu unë po prisja me padurim të takohesha me të përsëri.

Kur erdhi në zyrën time, ai uli kokën.

“Kam disa lajme të mira”, tha ai. “Jam ende i ndrojtur, por i kërkova Zotit të më ndihmonte. Pastaj hapa gojën dhe fillova



të flas. Dhe a e dini çfarë? E bëj gjatë gjithë kohës tani. Madje nuk mbaj mend se çfarë them. Gjëja e pabesueshme është se njerëzve u pëlqen. Ata e ndiejnë Shpirtin. Ata janë dakord me mua dhe me atë çfarë kam për t'ju treguar.”

U mahnita kur pashë se si ky misionar ishte shndërruar kur vendosi mirëbesimin e tij te Zoti. Ai u bë një mjet i madh në sjelljen e lumturisë të shumë njerëz.

**“Jam ende i ndrojtur,
por i kërkova Zotit të
më ndihmonte.”**

Mposhtja e Frikës

Kur e ndajmë ungjillin, nganjëherë ndihemi në siklet. Por ashtu si ky misionar i ndrojtur e tregoi në praktikë, Zoti do të na udhërrëfjë nëse ne i mirëbesojmë Atij. Fryma e Shenjtë do të na ndihmojë të dimë se çfarë të themi (shih 2 Nefi 32:2–3) dhe, kur njerëzit e ndiejnë Shpirtin, ata shpesh përgjigjen në një mënyrë pozitive. Shumë njerëzve u ngjallet kureshtja nga ajo që ne besojmë, dhe dëshirojnë të dinë më shumë.

Gëzim i Madh

Kam një dëshmi se Ati Qiellor do të na udhërrëfjë në përpjekjet tona për ta ndarë ungjillin dhe, në atë proces, ne do të ndiejmë gëzim të madh. Në fakt, ai gëzim do të jetë me ne jo vetëm tani por gjithashtu në botën që do të vijë. (Shih DeB 18:16.) Kjo është një arsye e mirë për të dalë nga zona juaj e rehatisë dhe për të bërë diçka, edhe nëse jeni i ndrojtur. ■

TRI GJËRAT FRIKËSUERE QË MUND TË MPOSHTNI

Përveç druajtjes, unë di tri gjëra të tjera frikësuese që i bëjnë disa prej nesh të thonë: “Kam frikë se, nëse flas rreth ungjillit, do t'i humbas miqtë e mi”. Sa mirë që, me besim, ato gjëra frikësuese mund të mposhten.

1. NUK DI MJAFTUESHËM.

Në qoftë se ju mungon njohuria rreth ungjillit, misionarët kohëplotë mund të ndihmojnë. Ata mund të na mësojnë mesazhin e Rivendosjes, të na ndihmojnë të forcojmë besimin tonë në Zotin Jezu Krisht dhe të na ndihmojnë të kuptojmë pendimin dhe si ta vëmë atë në zbatim në jetën tonë, dhe përse pagëzimi dhe dhurata e Frymës së Shenjtë janë të rëndësishme. Një tjetër burim i shkëlqyer njohurie është manuali *Predikoni Ungjillin Tim*. Do ta nxitja çdo të ri dhe të re të ketë një kopje dhe ta bëjë pjesë të studimit të vet të përditshëm me shkrimet e veta të shenjta.

2. KURRË MË PARË NUK E KAM BËRË KËTË.

Nëse ju mungon përvoja, ushtrohuni me misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë për të ditur çfarë të thoni ose të mos thoni në një situatë të caktuar. Ndërsa kaloni kohë me misionarët, ju do ta ndieni dashurinë që ata kanë për ungjillin dhe për bashkëqeniet e tyre. Ata kanë gjetur guximin për ta ndarë ungjillin; ata mund t'ju ndihmojnë ju të bëni të njëjtën gjë.

3. KAM FRIKË TË JAP [DËSHMI].

Kur e ndajmë dëshminë tonë, ne i ndihmojmë miqtë tanë të shohin gjëra më lartësuese dhe ata fillojnë të na respektojnë e të na duan në një anë të ndryshme. Kjo ndodh pothuajse çdo herë. Shumë njerëz të rinj thonë: “Isha i/e frikësuar, por kur fola sinqerisht, miku im filloi të më besonte dhe të bënte më shumë pyetje”. Ne nuk duhet të kemi frikë ta japim atë që kemi. Është e çmuar sepse vjen nga Perëndia. Dhe çfarë mënyre tjetër më të mirë ka për të treguar dashuri për miqtë tanë sesa të ndajmë me ta atë që e dimë se është e vërtetë?

HAPËSIRA JONË

E NDERSHME NË TË GJITHA GJËRAT

Alivsi H., Halisko, Meksikë

Në fillim të çdo semestri në shkollë, ne marrim një grup produkte falas që përmban një fletore shënimesh, një rend ditor dhe një mostër të një produkti të rastësishëm. Për një vit unë u futa në radhë për të marrë grupin tim të produkteve dhe vura re që mostra që mora ishte veçanërisht e dobishme për mua.

Në fund të ditës, pashë që ata po jepnin dy mostra për të njëjtin produkt. Do të ishte e lehtë të hyja në radhë përsëri dhe të merrja një grup të dytë, dhe vendosa ta bëja atë gjë. Në fund të fundit, ato ishin falas dhe unë kisha nevojë për atë produkt.

Bëra një ndalesë të shpejtë në tualet, ku pashë një telefon celular që një

vajzë e kishte lënë rastësisht. Ishte një nga modelet më të fundit dhe unë sapo kisha humbur telefonin tim para një jave. Por as që mendova ta mbaja. “Kjo është vjedhje”, thashë me vete.

Pastaj, gjatë rrugës për të marrë grupin e dytë të produkteve me gjëra falas, kuptova që do ishte po aq e pandershme sa mbajtja e telefonit sepse do të më duhej të gënjeja dhe të thoja që nuk kisha marrë një të tillë më parë.

Isha mirënjohëse për këtë përvojë të vogël që më dha një mësim të madh. E ktheva telefonin dhe shkova

në shtëpi me vetëm një fletore shënimesh, një rend ditor dhe një mostër produkti, por me një ndjenjë të mirë që isha e vërtetë në të gjitha gjërat, pavarësisht se sa të vogla. ■



E BEKUAR NGA BINDJA E LIGJIT TË SË DHJETËS

Sabrina T., San-Paolo, Brazil

Kur isha e vogël, familja ime dhe unë kaluam shumë sprova financiare që zgjatën derisa unë isha rreth 10 vjeçe. Babai im nuk mundi të gjente punë tjetër, kështu që punonte si shitës në rrugë dhe fitonte shumë pak. Nëna ime qëndroi në shtëpi për t'u kujdesur për mua dhe vëllanë tim më të vogël.

Por ndonëse kaluam kaq shumë vështirësi, ne kishim një dëshmi për pagimin e së dhjetës dhe dhënien e ofertave të tjera. Ne me besnikëri e paguam të dhjetën tonë çdo muaj dhe kurrë nuk na mungoi gjë. Ne e dimë me siguri se u bekuam vazhdimisht për shkak të mirësisë së pafundme

të Zotit dhe sepse Ai i mban premtimet e Tij kur ne jemi të bindur ndaj urdhërimeve të Tij.

Ditëve tona të sprovës financiare më në fund u erdhi fundi. Bekimet që Zoti na ka dhënë në këto pak vite të fundit, kanë qenë të mrekullueshme.

E di se për ata të cilët e paguajnë besnikërisht të dhjetën dhe i paguajnë ofertat e tyre me dashuri me qëllimin që të bekojnë jetën e të tjerëve, asgjë nuk do të mungojë dhe diçka edhe më e mirë mund të ndodhë, ashtu si me mua dhe me familjen time. Bekimet do të shtohen. Unë e di këtë. E jetova këtë. ■

A DUKET E MIRË?

Shihni përsëri. Satani dëshiron që ne ta shkëmbejmë gëzimin e vërtetë me thjesht një iluzion lumturie që kurrë nuk do të na kënaqë. Mos hani as edhe një kafshatë.

(Shih Diter F. Uhtdorf, "Ti Mund t'ia Dalësh Tani", Lichona, nëntor 2013, f. 56.)



“Në shkollë më tallin ngaqë jam shdm. E di se duhet t’i mbroj bindjet e mia, por është kaq e vështirë! Si mund të bëhem mjaft i guximshëm?”

Keni të drejtë që ju duhet guxim për t’i bërë ballë kësaj situatë. Megjithatë, Jezu Krishti ka urdhëruar: “Ngrihuni e shkëlqeni, që drita juaj të mund të jetë një flamur për kombet” (DeB 115:5). Por të keni kurajën për ta lënë dritën tuaj të shkëlqejë mund ose mund të mos nënkuptojë të flisni kundër atyre që ju përqeshin.

Në secilin rast, ju mund ta lini palën kundërshtare t’ju frymëzojë për të qenë më i mirë. Ndërsa punoni fort për ta forcuar dëshminë tuaj, ju mund të zhvilloni llojin e kurajës së heshtur që do t’ju ndihmojë ta thoni mendimin tuaj ose thjesht të vazhdoni të bëni atë që është e drejtë, edhe kur të tjerët ju përqeshin.

Të qenit i tallur mund të jetë trishtuese, por mbani mend që ju mund të luteni për t’u mbushur me dashuri hyjnore, në mënyrë që të tjerët të mund ta ndiejnë dashurinë e Krishtit nëpërmjet jush (shih Moroni 7:48). Për shkak se çdo situatë është e veçantë, kërkoni udhërrëfimin e Shpirtit për të ditur se si të reagoni në një mënyrë si të Krishtit në secilin rast.

Në varësi të situatës, do të ishte më mirë që të flisni veçan me ata që ju kanë tallur ose thjesht t’i shpërfillni përqeshjet armiqësore ndërsa vazhdoni t’i jetoni bindet tuaja. Nëse të tjerët nuk janë të interesuar ta dëgjojnë atë që ju keni për të thënë, shembulli juaj i dashamirësisë, faljes dhe sinqeritetit mund të jetë mesazhi më i mirë që mund të dërgoni.

Tregoni Kurajë të Vërtetë

Ata që tallen me ju, mund të mos ndalojnë thjesht sepse ju bëheni mjaft të guximshëm që t’u kërkoni atyre të ndalojnë, por ata mund të ndalojnë kur ju shfaqni kurajën tuaj duke e jetuar atë që jeni – një shenjtor i ditëve të mëvonshme. Pa e kuptuar, shkëlqimi i miratimit të Atit tonë Qiellor do të ndriçojë mbi ju, me shpresën se do t’i hapë sytë e tyre ndaj ungjillit të rivendosur në jetën tuaj.

Brajt U., moshë 17 vjeç, Shteti i Imos, Nigeri

Gjeni Forcë në Gjërat Bazë

Lutja dhe agjërimi janë të rëndësishme sepse ato do t’ju ndihmojnë që të jeni në gjendje të përballeni me shakatë dhe sfidat në shkollë, ashtu si Jezu Krishti u përball me shumë tallje kur Ai ishte këtu në tokë. Ato do t’ju ndihmojnë që të zhvilloni më shumë dashuri dhe durim ndaj njerëzve.

Uolter C., moshë 15 vjeç, Jaén, Peru



Udhëhiquini nëpërmjet Lutjes

Për një kohë të gjatë, unë isha e vetmja anëtare në shkollën time. Miqtë e mi më të afërt dukeshin se më kuptonin, por shokët e tjerë në shkollë talleshin me mua. Një ditë u luta dhe ndieva nevojën për të biseduar me njërin prej tyre, i cili i nxiste të tjerët të talleshin me mua. I shpjegova se nuk isha e zemëruar me të, por i kërkova atij të tregonte

respektin që ai do të donte të kishte. Pasi e dëgjoji bisedën tonë, një nga mësuesit e mi gjithmonë më mbronte kur e shikonte se diçka po ndodhte. E di se Zoti do të jetë me ju kur të bisedoni me këta njerëz.

Shanela S., moshë 14 vjeçe, Pangasinan, Filipine

Ndërtoni Dëshminë Tuaj

Së pari, fitoni një dëshmi të vërtetë për të vërtetat që ju doni t'u tregoni të tjerëve. Më pas, kini dashuri për njerëzit që ju tallin dhe mos debatoni, sepse grindja nuk përkrahet kurrë nga Perëndia (shih 3 Nefi 11:29). Më e rëndësishmja, përpiquni ta keni gjithmonë Shpirtin me vete. Shpirti do t'ju ndihmojë të keni më shumë dashuri dhe më shumë kurajë dhe Ai do t'i bëjë të fuqishme fjalët tuaja.

Julia F., moshë 19 vjeçe, Hese, Gjermani



Duajini Armiqtë Tuaj

Unë kam qenë në situata të ngjashme. Nëse keni besim dhe e përlini veten tuaj, ju

do të bekoheni me forcën dhe besimin që ju nevojiten për t'i "d[ashur] armiqtë tuaj, [për t'i] bek[uar] ata që ju mallkojnë, . . . dhe [për t'u] lutu[r] për ata" (Mateu 5:44). Do t'ju nxitja që të kërkonte në shkrimet e shenjta përgjigjet lidhur me mënyrën se si të jeni të fortë. Lutuni kur ndiheni vetëm në besimin tuaj. Romakëve 8:31 thotë: "Çfarë të themi, pra, për këto gjëra? Në qoftë se Perëndia është me ne, kush

mund të jetë kundër nesh?" Ju keni Perëndinë në anën tuaj! Çdo gjë është e mundur.

Regan T., moshë 15 vjeçe, Juta, SHBA



Mos u Frikësoni

Flisni për fenë tuaj më shpesh ose me qëllim bëni gjëra që ta nxirrni atë në pah. Unë isha në

një situatë të ngjashme dhe shkrova në çantën time të shpinës: "Më Pëlqen Shumë që Jam SHDM". Duke e bërë këtë, unë hapa derën për disa mundësi misionare dhe u tregova njerëzve se nuk kisha frikë për t'u bërë të ditur se jam shdm. Çfarëdo që ju të bëni, mos i lini t'ju mërzhitin. Lutuni për ta dhe për veten tuaj. Shpejt ju do të zbuloni se, nëse përqendrohemi në shpëtimin dhe shpirtit të të tjerëve, ju nuk do të keni aq frikë për t'ua bërë atyre të ditur të vërtetën e ungjillit të Atit tonë.

Savana P., moshë 14 vjeçe, Teksas, SHBA



KURAJA E BINDJEVE TONA

"Është shpesh e vështirë të jemi të ndryshëm dhe të qëndrojmë të vetëm në mes të një turme. Është e natyrshme të kemi frikë se çfarë mund të mendojnë ose thonë të tjerët. Ngushëlluese janë fjalët e psalmit: 'Zoti është drita ime dhe shpëtimi im; nga kush do të kem frikë? Zoti është kështjella e jetës sime; nga kush do të kem frikë?' [Psalmi 27:1]. Kur e bëjmë Krishtin thelbin e jetës sonë, frika jonë do të zëvendësohet nga kuraja e bindjeve tona."

Presidenti Tomas S. Monson, "Jini një Shembull dhe një Dritë", Liahona, nëntor 2015, f. 88.

PYETJA PASUESE

"Si mund ta di se Perëndia po i dëgjon lutjet e mia?"

Dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë deri më 1 maj 2016 te liahona@ldschurch.org, nëpërmjet postës elektronike te liahona@ldschurch.org, ose nëpërmjet postës së thjeshtë (shih adresën në faqen 3).

Informacioni dhe leja e mëposhtme duhet të përfshihen në postën tuaj elektronike ose në letrën tuaj: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjia ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18-vjeçare, leja me shkrim e prindit tuaj (postimi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.



Nga Plaku
Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të
Dymbëdhjetë
Apostujve

Çfarë bëjnë Apostujt?

Apostujt janë shërbëtorë të Zotit. Ata udhëtojnë që të vizitojnë anëtarë të Kishës nëpër botë.

Herën e parë që udhëtova si një Apostull, takova një burrë që gjendej në një moment të vështirë me të jetuarin e Fjalës së Urtësisë. I thashë: “Zoti më dërgoi këtu për të të dhënë një mesazh fare të thjeshtë: “Ti mund ta bësh atë. Unë të premtoj se ti do ta kesh ndihmën e Tij ndërsa përballesh me këtë sfidë.”

A do ta dërgojë Zoti një nga Dymbëdhjetë Apostujt që t’i bjerë qark gjysmës së botës thjesht për të ndihmuar një person? Përgjigjja është *po*. Ai e bën këtë gjatë gjithë kohës. ■

Nga transmetimi mbarëbotëror Ballë për Ballë me Plakun dhe Motrën Bednar.



Nga Karol F. Mek-Konki,
Këshilltare e Parë
në Presidencën e
Përgjithshme të
Të Rejave

Paqe në Zemrën Time



Kur isha tetë vjeçe, pashë profetin, Presidentin Dejvid O. Mek-Kei (1873–1970). Ai erdhi për të përkushtuar një godinë të re të Kishës në Palmira, Nju-Jork, SHBA. Familja ime shkoi për përkushtimin. Erdhën edhe shumë njerëz të tjerë. Ne ishim të gjithë të entuziazmuar që do ta shihnim profetin!

Isha tepër e vogël, ndaj ishte e vështirë për mua të shihja përrreth të gjithë njerëzve. Por prapëseprapë munda ta ndieja dashurinë e Presidentit Mek-Kei. Për vetëm një çast, pashë flokët e tij të bardhë dhe fytyrën e tij të dashur. Mendova: “Ja çfarë pamje ka një

profet i Perëndisë”. Kam lexuar për profetët në shkrimet e shenjta, por kjo ishte hera ime e parë që shihja një profet ose ndonjë Autoritet të Përgjithshëm personalisht. E kuptova se profetët janë njerëz të vërtetë. Dhe ata na duan ne! Do ta kujtoj përherë dashurinë dhe paqen që ndjeva atë ditë.

Kur isha 11 vjeçe, pata një tjetër përvojë që më ndihmoi të ndieja paqe në zemrën time. Po afrohej konferenca e kunjit dhe unë do të këndoja në korin e kunjit. Isha kaq e emocionuar! Vesha një këmishë të bardhë të bukur dhe u ndjeva shumë e veçantë. Kënga që kënduam,

kishte fjalët nga Gjoni 14:27: “Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po ua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë”.

Ato fjalë vërtet më prekën në zemër dhe i kam kujtuar ato qysh atëherë. Kur i këndoja ato fjalë, e dija se ishin të vërteta. E ndjeva Frymën e Shenjtë të më thoshte se ndjekja e Jezu Krishtit na ndihmon të ndiejmë paqe. Që nga ajo kohë, kurdoherë që kam sfida, ky shkrim i shenjtë më vjen në mendje dhe më jep paqe. E vërteta që mësova kur isha e re, e ka bekuar gjithë jetën time. ■

DËSHMIA e Ithënit

Nga Leri Hillër

Bazuar në një ndodhi të vërtetë

“Dëgjo, dëgjo. Fryma e Shenjtë do të të pëshpëritë. Dëgjoje, dëgjoje zërin e qetë dhe të ulët” (Children’s Songbook, f. 106).

Ithëni u ul në orën e kohës së për-bashkët dhe vështroi ndërsa shoku i tij të ngushtë, Semi, dha dëshminë e tij. Shoqja e tij, Sara, po priste radhën. Semi foli për një projekt shërbimi që bëri. Ai tha se kishte dëshmi për shërbimin. Sara dha dëshminë e saj për familjet. Mësuesi i Ithënit gjithashtu dha dëshminë e tij. Ai foli për punën në tempull. Të gjithë ata dëshmuuan se Kisha është e vërtetë. Dukej sikur të gjithë përveç Ithënit kishin një dëshmi.

“Për çfarë kam dëshmi unë?” pyeti veten Ithëni.

Ai u kthye disa vite pas, në kohën kur ai dhe shokët e tij u pagëzuan. Mësuesja e tij e Fillores, motra Keldër, kishte dhënë një bisedë për Frymën e Shenjtë.

“Fryma e Shenjtë mund të të japë një ndjenjë përvëluese në zemër. Ai mund të të ndihmojë të dish se çfarë është e vërtetë”, kishte thënë ajo. “Dhe kjo është mënyra se si ti merr një dëshmi për atë që beson.”

Ithëni u përpoq të bënte atë që ishte e drejtë në mënyrë që të mund ta ndiente Frymën e Shenjtë. Ai i lexoi

Dukej sikur të gjithë përveç Ithënit kishin një dëshmi.





shkrimet e shenjta dhe u lut. Por ai nuk e kishte pasur asnjëherë atë ndjenjë përvëluese për të cilën folën njerëzit. Mos kjo do të thoshte se ai nuk kishte një dëshmi?

Kjo pyetje qëndroi në mendjen e Ithënit tërë ditën e nesërme. Ai ende po mendonte për të kur ai dhe Semi po rrëshqitnin me dërrasa me rrota pas shkolle. Ai pyeti veten se si mund ta pyeste Semin për këtë.

“Ej, Sem”, e pyeti Ithëni më në fund, “a ishe i frikësuar kur dhe dëshminë tënde dje?”

Semi kërcëu nga dërrasa e tij dhe eci drejt barit. “Në të vërtetë, jo”, tha ai, duke u ulur. “E kam dhënë dëshminë time në mbrëmje familjare më parë.”

Ithëni u bashkua me të dhe e vendosi në prehër dërrasën e tij me rrota. “Por nga e dije që kishe një dëshmi?”

“Epo, u luta dhe u ndjeva mirë rreth saj.”

Ithëni me ngadalë tundi kokën dhe rrotulloi me dorë njërën rrotë. Ai dëshironte disi të ndihej po ashtu.

Atë natë, kur shtëpia ishte e errët dhe e qetë, Ithëni u gjunjëzua në shtratin e tij për t’u lutur.

“Atë Qiellor”, tha ai, “të lutem më ndihmo të kem një dëshmi. Më ndihmo të di se Kisha është e vërtetë. Se Jozef Smithi ishte një profet. Dhe se Libri i Mormonit është i vërtetë.”

Në mes të lutjes së tij, Ithëni ndaloi. Ai u mendua një çast. Më pas pyeti veten: “Epo, a di unë ndonjë gjë deri tani?”

Dhe atëherë një ndjenjë e qetë, e paqte erdhi mbi të. Nuk ishte një ndjenjë e fuqishme përvëluese. Por Ithëni e dinte se ishte Fryma e Shenjtë.

Një mendim erdhi në mendjen e Ithënit: “Unë e di se e di”. Ndërsa u mendua rreth saj, ai e kuptoi se e kishte ndier këtë ndjenjë të paqte më parë.

Kurdoherë që ai e lexonte Librin e Mormonit, ndiente se kjo ishte e mirë dhe e drejtë. Tani ai e dinte se ajo ndjenjë ishte Fryma e Shenjtë duke i dëshmuar atij. Kur shkante në kishë dhe ndiente se ishte e mirë dhe e drejtë që ishte atje, ishte papë Fryma e Shenjtë. Ai tashmë po mernte një dëshmi!

Ai nuk kishte nevojë të dinte çdo gjë pikërisht tani. Por ai e dinte vërtet se Fryma e Shenjtë ishte i vërtetë dhe mund ta ndihmonte atë të ndërtonte dëshminë e tij.

Ithëni filloi të lutej sërish. Por këtë herë për të thënë faleminderit. ■

Autori jeton në Juta, SHBA.

Pezot për Atin Qiellor

Nga Anhela Peña Deihl

“Zbatojini urdhërimet. Në këtë gjë ka siguri dhe paqe” (Children’s Songbook, f. 146).

Ana përtypi kafshatën e fundit të pites së saj meksikane. Ishte e butë dhe e shijshme. Ana i pëlqente shumë pitet meksikane të gjyshes së saj. Ato ishin pjesa më e mirë e mëngjesit.

Ana e vështroi gjyshen e saj, Abuelën, tek lante enët.

Ishte si çdo mëngjes tjetër. Por një gjë nuk ishte njësoj.

Abuela zakonisht shkante në dyqan për të blerë ushqime. Por jo sot. Sot nuk kishte para për të blerë ushqime.

“Çfarë do të hamë nesër?” pyeti veten Ana.

Më pas Ana kujtoi. Ajo e dinte se ku ishin disa para! Mbrëmjen e djeshme ajo pa Abuelën të vendoste disa pezo [monedha meksikane] në një cohë të vogël të bardhë.

“Abuela, harrove? Ti ke para për të blerë ushqime.”

“Çfarë parash?” pyeti Abuela.

Ana vrapoi për të marrë paratë. Ajo e shkundi çantën e vogël me monedha. *Ting! Ting!*

Abuela buzëqeshi. “Kjo është e dhjeta jonë, Ana. Këto janë paratë e *Tij*.”

“Por çfarë do të hamë nesër?” pyeti Ana.

“Mos u shqetëso”, tha Abuela. “Kam besim se Ati Qiellor do të na ndihmojë.”

Mëngjesin tjetër Abuela i dha Anës piten e fundit me miell gruri.



Pastaj u ul në karrigen e saj. Ajo qepi lule të kuqe te një fustan dhe i tregoi histori rreth kohës kur ajo ishte vajzë e vogël. Ajo nuk dukej e shqetësuar.

Më pas Ana dëgjoi një trokitje. Ajo vrapoi për të hapur derën.

“Dajë Pedro!”

“Pata një ndjenjë se duhej t’ju vizitoja ju të dyjave”, tha dajë Pedro. Ai vendosi tri thasë mbi tavolinë. Njëri kishte miell gruri për pite. Tjetri kishte mish. Tjetri kishte perime të freskëta nga dyqani.

“Oh, djali im i ëmbël”, tha Abuela. “Do t’ju bëj supën time më të mirë me qoftel!”

“Supa jote është më e mira në botë”, tha dajë Pedro.


Ana qeshi dhe përplasi duart.

Pastaj ndaloi. Kishte një gjë që ajo donte ta dinte. “Abuela, a e dije se dajë Pedro do të vinte sot? Kjo ishte arsyeja që nuk ishe e shqetësuar?”

“Jo”, tha Abuela. “Kur unë e paguaj të dhjetën, kam besim se Ati Qiellor do të më bekojë. Dhe Ai e bëri!”

Ana e përqafoi Abuelën. Ajo u ndje si vajza më e lumtur në Meksikë. Ajo dhe Abuela patën besim tek Ati Qiellor. Tani ajo mezi po priste të hante supën e shijshme të Abuelës! ■

Autorja jeton në Karolinën e Veriut, SHBA.





Ndjekja e Profetëve dhe e Apostujve

Nga Xhena Koford



Perëndia i thërret profetët dhe apostujt që të na mësojnë atë që Perëndia dëshiron që ne të dimë. Në shkrimet e shenjta ne mund të lexojmë për profetë si Noeu, Nefi dhe Jozef Smithi dhe apostuj si Pjetri dhe Pali. Ne kemi profetë dhe apostuj sot!



DETAJ NGA ZOTI I PËRMBUSH TË GJITHA FIALET E TËJ, NGA CLARK K. PRICE; DETAJ NGA JOZEF SMITHI I RIUT, NGA DANQUART A. WEGGELAND; DETAJ NGA HISTORI NGA DHJATA E RE, NGA PAUL MANN; DETAJ NGA NËNË DHE LEHIDRETOINË NDRËTIMIN E ANIJES NGA JERRY THOMPSON; ILUSTRIMET NGA GARTH BRUNER

Çfarë është një “profet, shikues dhe zbulues”?



Një **profet** flet për Perëndinë.

Një **shikues** mund të shoh të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Një **zbulues** na zbulon (ose tregon) vullnetin e Perëndisë.

- Anëtarët e Presidencës së Parë janë që të gjithë profetë, shikues dhe zbulues. Po ashtu edhe të gjithë Apostujt.
- Vetëm Presidenti i Kishës ka autoritetin nga Perëndia për ta drejtuar të gjithë Kishën.
- Sa profetë, shikues dhe zbulues të gjallë kemi ne gjithsej?

12 15 3 1

Perëndia. 15

Përse është e rëndësishme ta ndjekim profetin?

Profeti është si dikush që ruan nga një kullë (shih edhe faqen 38). Ai mund ta shohë rrezikun që po kanoset dhe na tregon se si të jemi të sigurt. Ai na ndihmon të ndjekim Jezu Krishtin.



Çfarë na ka kërkuar profeti ynë për të bërë?



Profeti ynë sot është Presidenti Tomas S. Monson. Ja tek janë disa gjëra që ai na ka kërkuar të bëjmë.

- Ndiqe shembullin e Jezusit dhe duaje këdo.
- Paguaje të dhjetën dhe dhuro për fondin e misionarëve.
- Qëndroju larg filmave, TV-së dhe mjeteve të tjera argëtuese jo të mira.
- Vendose një fotografi të tempullit në çdo dhomë gjumi.
- Studioji bisedat e konferencave të përgjithshme.
- Vizitoji të moshuarit dhe ji një fqinj i mirë.

Zgjidh një gjë nga lista që mund ta bësh këtë muaj. Çfarë do të bësh? ■

Alma u Pendua

Alma ishte një prift i mbretit të lig Noe. Ai dëgjoji profetin Abinadi të jepte mësim për urdhërimet. Alma e dinte se duhet të ndryshonte jetën e vet dhe të ndiqte Perëndinë në vend që të bënte gjëra të liga. Ai e shkroi atë që dha mësim Abinadi. Ai filloi t'ua mësonte të tjerëve ungjillin. Më vonë ai pati një familje dhe e quajti Alma njërin nga bijtë e tij.



Unë po luaja si portier dhe po ia dilja mirë. Më pas u kujtova që duhej të pendohesha ngaqë thashë diçka të keqe dje. Duhej ta bëja atë, por isha në mes të lojës.

Atëherë m'u kujtua diçka. Ti mund të lutesh kudo ku ke nevojë! Pasi u luta, u ndjeva mirë që u pendova.

Pitër G., 8 vjeç, Juta, SHBA



Dejmën B., 8 vjeç, Juta, SHBA



Prite, palose dhe mbaje këtë letër sfide.

Unë Mund të Pendohem!


- Mësoje përmendsh Mosian 18:9.
- Shkruaje ose vizatoje diçka që tha profeti në konferencën e përgjithshme.
- Zgjidh një mënyrë se si mund të ndryshosh për mirë. Përpiku ta bësh atë këtë muaj.
- Unë e sfidoj veten që të . . .

ALMA

Shkrimet e Shenjta të Këtij Muaji

Pasi të lexosh një fragment të shkrimit të shenjtë, ngjyrosi zonat sipas numrave me të cilët përkojnë tek Ujërat e Mormonit!


- 1 Mosia 21:14–16, 32–35
- 2 Mosia 22:2, 10–16
- 3 Mosia 24:8, 10–14
- 4 Mosia 27:8, 11, 18–24
- 5 Mosia 27:30–37
- 6 Mosia 28:3, 5–15, 20
- 7 Alma 8:11–16, 18–27
- 8 Alma 11:38–46



Ujërat e Mormonit

Alma u fsheh nga mbreti i lig Noe pranë një vendi të paqtë të quajtur Ujërat e Mormonit. Shumë njerëz erdhën për të dëgjuar Almën ta jepte mësim ungjillin. Ata dëshironin të pagëzoheshin. Kur Alma i pagëzoi ata, populli bëri të njëjtat premtime, ose besëlidhje, që bëjmë ne kur pagëzohemi. Mund të lexosh më tepër rreth këtyre premtimeve në faqen tjetër. ■


Alma Pagëzon Shumë Njerëz



Abinadi ishte një profet. Ai u mësoi njerëzve të besojnë te Jezusi dhe të ndalojnë së bëri gjëra të këqija. Një mbret i lig, i quajtur Noe, u zemërua me Abinadin. Noeu nuk dëshironte të pendohej.




Një njeri i quajtur Alma i besoi Abinadit. Ai u largua dhe u fsheh nga mbreti i zemëruar. Ai ndjeu keqardhje që bëri gjëra të gabuara dhe u pendua, ashtu siç kishte dhënë mësim Abinadi.



Shumë njerëz erdhën që ta dëgjonin Almën të jepte mësim për Jezu Krishtin. Alma dha mësim se, nëse ata pendohen dhe e ndjekin Jezusin, ata mund të pagëzohen.

Njerëzit duartrokitën me gëzim. Ata premtuan që do t'i ngushëllonin të tjerët. Ata premtuan që do ta donin Perëndinë dhe do t'u tregonin njerëzve të tjerë për Të. Ata ishin gati për t'u pagëzuar.





Një e nga një, Alma i pagëzoi njerëzit. Ata ishin shumë të lumtur që ishin pjesë e Kishës së Jezusit.

Kur ne pagëzohemi, ne bëjmë po ato premtime që bëri populli i Almës. Edhe ne bëhemi pjesë e Kishës së Jezusit! ■

Shabati Është një Ditë e Veçantë





**Nga Presidenti
Xhorxh Q. Kenon
(1827–1901),**

Këshilltar i Parë në
Presidencën e Parë

KËRKIMI I DHURATAVE SHPIRTËRORE

*Sa prej jush janë duke i kërkuar këto
dhurata që Perëndia ka premtuar t'i japë?*

Çdo burrë dhe grua në Kishën e Krishtit mund t'i ketë dhuratat e Shpirtit të Perëndisë të ndara mes tyre sipas besimit të tyre dhe siç dëshiron Perëndia. . . .

Sa prej jush . . . janë duke i kërkuar këto dhurata që Perëndia ka premtuar t'i japë? Sa prej jush, kur përkuleni përpara Atit tuaj Qiellor në rrethin tuaj familjar ose në vendet tuaja të fshehta, kërkonin që këto dhurata t'ju jepen juve? Sa prej jush i kërkonin Atit, në emrin e Jezusit, ta shpalosë Vetën e Tij për ju nëpërmjet këtyre fuqive dhe këtyre dhuratave? Apo vazhdoni ditë pas dite, si një derë e kapur në menteshat e saj, pa pasur ndonjë ndjenjë për temën, pa ushtruar aspak besim, të kënaqur që jeni pagëzuar dhe që jeni anëtarë të Kishës dhe që çlodheni atje, duke menduar se shpëtimi juaj është i sigurt pasi ta keni bërë atë? . . .

. . . Unë e di se Perëndia është i gatshëm ta shërojë të sëmurin,



se Ai është i gatshëm të japë dhuratën e dallimit të shpirtave, dhuratën e urtësisë, të njohurisë e të profecisë dhe dhurata të tjera që mund të jenë të nevojshme. Nëse çdonjëri prej nesh është i papërkryer, është detyra jonë që të lutemi për dhuratën që do të na bëjë të përkryer. A kam unë papërsosuri? Jam plot e përplot me to. Cila është detyra ime? T'i lutem Perëndisë të më japë dhuratat që do t'i korrigjojnë këto papërsosuri. Nëse jam një njeri i zemëruar, është detyra ime të lutem për dashuri hyjnore, e cila është e durueshme dhe plot mirësi. A jam unë një njeri ziliqar? Është detyra ime të kërkoj dashuri hyjnore, e cila nuk ka smirë. E njëjta gjë me

të gjitha dhuratat e ungjillit. Ato janë synuar për këtë qëllim. Askush nuk duhet të thotë: “Oh, nuk mund të rresht së bëri këtë; është natyra ime”. Atë nuk e shfaqëson kjo, për arsyen se Perëndia ka premtuar që të japë forcë për t'i korrigjuar këto gjëra dhe që të japë dhurata që do t'i çrrënjosin ato. Nëse një njeriu i mungon urtësia, është detyra e tij t'i kërkojë Perëndisë urtësi. E njëjta gjë me çdo gjë tjetër. Ky është plani i Perëndisë lidhur me Kishën e Tij. Ai dëshiron që shenjtorët e Tij të përsosen tek e vërteta. Për këtë qëllim Ai i jep këto dhurata dhe i derdh mbi ata njerëz që i kërkojnë ato, me qëllim që të jetë një popull i përsosur në faqen e tokës, pavarësisht nga dobësitë e tyre të shumta, sepse Perëndia ka premtuar t'i japë dhuratat që janë të nevojshme për përsosjen e tyre. ■

Nga The Latter-day Saints Millennial Star, 23 prill 1894, f. 258–261; pikësimi dhe përdorimi i gërmaeve të mëdha janë standardizuar.

IDE



Si rritet besimi i hershëm në një njohuri dhe një dëshmi?

“Nuk mbaj mend që të mos kem besuar tek Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. I kam dashur Ata që kur mësova për Ta i ulur te gjunjët e nënës sime engjëllore, duke lexuar historitë nga shkrimet e shenjta dhe historitë e ungjillit. Ai besim i hershëm tani është rritur në një njohuri dhe një dëshmi për një Atë të dashur Qiellor, i cili i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve tona.”

Gjithashtu në Këtë Botim

PËR TË RINJTË NË MOSHË MADHORE



Dallimi i Falsifikimeve të Satanit

f.44

Ja tek është një mënyrë kyçe për të treguar ndryshimin midis gënjeshtreve të Satanit dhe të vërtetave të Zotit.

PËR RININË

EDHE NËSE

JE I NDROJTUR

f.60

A jeni ndier ndonjëherë tepër të ndrojtur ose të frikësuar për ta ndarë ungjillin? Ja tek janë tri sugjerime.



PËR FËMIJËT



Ndjekja e Profetëve dhe e Apostujve

f.72

Cila është një gjë që ti mund ta bësh këtë muaj për ta ndjekur profetin, Presidentin Tomas S. Monson?



KISHA E
Jezu Krishtit
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME